



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 12

Tiranë – E hënë, 25 janar 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1153, datë 24.12.2020	Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese përkatëse, flamurit dhe stemës së Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin..... 1815
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1155, datë 24.12.2020	Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, të numrit thelbësor dhe të kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare për t'u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare 1846
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1163, datë 24.12.2020	Për ngritjen e sekretariatit në kuadër të veprimtarisë së mbajtjes së sekretariatit të “ <i>Bologna Follow up Group</i> ” nga Republika e Shqipërisë. 1846
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1164, datë 30.12.2020	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të fëmijës Edna Zeinati..... 1848
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 13, datë 20.1.2021	Për emërim në detyrë..... 1849
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 14, datë 20.1.2021	Për transferimin, në pronësi të Bashkisë Vau-Dejës, të Njesisë Administrative Vau i Dejës, të pasurisë 125/35, zona kadastrale 2015..... 1849
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 15, datë 20.1.2021	Për miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2021..... 1852
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 20.1.2021	Për miratimin e buxhetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, për vitin 2021..... 1853
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 17, datë 20.1.2021	Për transferimin, në pronësi të Bashkisë Tiranë, të Njesisë Administrative Tiranë, të pasurive me nr. 7/619, 7/620, 7/621, në zonën kadastrale 8230..... 1853
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 18, datë 20.1.2021	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2021, të miratuar për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë..... 1857

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 19, datë 20.1.2021	Për masën e fondit të veçantë për zonat e mbrojtura mjedisore, për burimet e krijimit dhe rregullat e përdorimit të tij.....	1857
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 21, datë 20.1.2021	Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rikonstruksionit/riparimit të njësive individuale të banimit/njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Tiranë.....	1858
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 22, datë 20.1.2021	Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/ përshtatëse të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore, në bashkitë Kamzë dhe Kurbin.....	1859
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 23, datë 20.1.2021	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Tiranë, Shijak, Vorë dhe Kurbin	1859
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 24, datë 20.1.2021	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat) në bashkitë Tiranë dhe Durrës.....	1860
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 25, datë 20.1.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 5, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, të ndryshuar.....	1861
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 26, datë 20.1.2021	Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore në bashkitë Kamzë dhe Kavajë dhe caktimin e tyre si njësi zbatuese.....	1861
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 20.1.2021	Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rirforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë dhe Kurbin.....	1862
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 20.1.2021	Për miratimin e marrëveshjes së grantit të investimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përfituesi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e infrastrukturës bashkiake V, në shumën 6 000 000 euro.....	1863
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 29, datë 20.1.2021	Për miratimin e marrëveshjes së grantit të Bashkimit Evropian, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përfituesi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për Bashkimin Evropian, për një mjedis më të pastër – mbështetje për trajtimin e kanalizimeve të ujërave të zeza, në shumën 23 300 000 euro.....	1871
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 30, datë 20.1.2021	Për miratimin e marrëveshjes së grantit shoqërues ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përfituesi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për masat shoqëruese për programin e infrastrukturës bashkiake V, në shumën 3 000 000 euro	1882

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2021	Për miratimin e marrëveshjes së Grantit SECO ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përfituesi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e infrastrukturës bashkiake V, në shumën 13 300 000 euro.....	1888
Udhëzim i ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë nr. 1, datë 19.1.2021	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 30, datë 12.9.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”	1896
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 24, datë 14.1.2021	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetet e Polonisë, Sllovakisë, Hungarisë, Gjermanisë, Ukrainës, Izraelit, Çekisë, Rumanisë, Bullgarisë, Belgjikës, Kroacisë, Danimarkës, Francës, Holandës dhe Lituanisë.....	1897
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 25, datë 18.1.2021	Për delegimin dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Brendshme.....	1900



VENDIM
Nr. 1153, datë 24.12.2020

**PËR MIRATIMIN E UNIFORMËS,
SHENJAVE DALLUESE PÛRKATËSE,
FLAMURIT DHE STEMËS SË
SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA
ZJARRI DHE SHPËTIMIN**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës; dhe të nenit 5, të ligjit nr. 152/2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e uniformës së Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, shenjave dalluese përkatëse, flamurit dhe stemës, sipas lidhjeve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Llojet e uniformës, që kanë në përdorim punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin për nivelin e mesëm dhe të lartë janë sipas përcaktimit të bërë në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Llojet e uniformës, që kanë në përdorim punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin për nivelin bazë (operacional), janë sipas përcaktimit të bërë në lidhjen nr. 2, që i

bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Llojet e uniformës zjarrduruese, që kanë në përdorim punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, (personeli operacional) janë sipas përcaktimit të bërë në lidhjen nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Flamuri dhe stema janë simbolet e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, sipas përcaktimeve të bëra në lidhjen nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Shenjat dalluese të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin përbëhen nga shenja e mbiemrit, shenja e kapelës, logoja e bashkisë përkatëse dhe shirita ceremoniale, sipas përcaktimit të bërë në lidhjen nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Vendimi nr. 78, datë 6.2.2003, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e stemës, të uniformës dhe të normativave të veshmbathjes për Policinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, shfuqizohet.

8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe kryetari i bashkisë përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LIDHJA NR. 1

UNIFORMA E PUNONJËSVE DREJTUES TË NIVELIT TË MESËM, TË LARTË

Nr.	Artikujt	Sasia	Vite	Ngjyra
1	Xhup	1	3	Blu e errët
2	Kostum stofi me përzierje	1	3	Blu e errët
	Xhaketë	1	2	Blu e errët
	Pantallona stofi	2	1	Blu e errët
	Kapele	1	2	E bardhë
	Këmisha me mëngë të gjata	2	1	Blu e errët
	Pulovër e trikotuar me jakë “V”	1	2	
3	Bluzë pambuku me mëngë të gjata	2	1	Blu e errët
4	Bluzë pambuku me mëngë të shkurtra	2	1	Blu e errët
5	Këmishë me mëngë të shkurtra	2	1	E bardhë
6	Pantallona vere	2	1	Blu e errët
7	Fund veror	2	1	Blu e errët
8	Rrip pantallonash	1	2	E zezë
9	Këpucë verore	1	1	E zezë
	Këpucë dimërore	1	1	E zezë



	Këpucë me qafa	1	1	E zezë
10	Çorape	5	1	Blu e errët
11	Kravatë	1	1	Blu e errët
12	Kostum doku stërvitje	1	2	Blu e errët
13	Grada të mëdha spaleti; të vogla gjoksi.	2 2	3 3	Sipas specifikimeve të VKM-së nr. 895, datë 21.12.2016, “Për kriteret e ecursisë dhe fitimit të gradave, njësimit e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

SPECIFIKIMET E ARTIKUJVE SIPAS LIDHJES NR. 1

Përmasat do të jenë sipas standardeve, klasifikuar me masat S, M, L, XL, XXL.

Ngjyra e uniformës do të jetë sipas përcaktimit në lidhjen nr. 1, të këtij vendimi:

ARTIKUJT:

1. XHUP TREÇEREKSH DIMËROR

Xhupi ka shtresë të brendshme dhe është me ngjyrë blu të errët. Është konfeksionuar në 8 prerje (XS–S–M–L–XL–XXL–XXXL–4XL).

Prej pjesës së krahavorit deri te lartësia e gjoksit dhe përmes shpinës është e përforcuar dhe ka shtresën e brendshme që arrin deri te fundi i mëngës.

Në pjesën e poshtme të xhupit nga të dy anët janë të vendosura dy xhepa të thellë me kapakë.

Xhupi është me gjatësinë e duhur/të përshtatshme dhe arrin deri mbi gjunjët.

MASAT E PRODHIMIT TË XHUPIT

TABELA E PËRMASAVE

(dimensionet e shprehura në cm – tolerancë +/- 3%)

MASAT	XS	S	M	L	XL	2XL	3XL	4XL
1/2 e gjerësisë së krahavorit (e matur në pjesën e poshtme të sektorit)	60	60	64	70	73	79	81	84
Gjerësi shpatullash	47	47	51	53	55	57	59	62
Gjatësia totale (e matur nga tegeli qepës i linjës së supeve në afërsi të jakës deri në fund)	64	67	71	74	77	79	81	83
Gjatësia e mëngës (e matur duke ndjekur formën e modelimit të bërrylit)	59	59	65	67	69	70	73	73



PËRSHKRIMI - KONSTRUKTIMI

Xhupi treçereksh është realizuar me tekstil, me ngjyrë blu dhe përbëhet nga këto elemente:

- përpara (me dy pjesë, gjokset);
- shpina (pjesa pas);
- jaka;
- dy spaleta;
- dy mëngë;
- një shtresë e brendshme.



Jaka	Realizuar model korean me lartësi rreth 7,5 cm. Mbyllja dhe hapja e saj kryhet me anë të zinxhirit me ngjyrë blu në tonalitet me tekstin e xhupit.
Përpara	Dy pjesët përpara bashkohen ndërmjet tyre përgjatë linjës qendrore në të gjithë gjatësinë e tij me anë të një zinxhiri tip 8 dhëmbësh, anët e të cilit mbulohen nga jashtë me anë të një mostre të realizuar me tekstil dopio me gjerësi rreth 5 cm. Linja fundore e xhupit përpara, përfundon me një kthim pale (tegel njëgjilpërësh).
Xhepat	Xhupi ka katër xhepa me kapakë, të pozicionuar përkatësisht: dy xhepa në lartësinë e gjoksit dhe xhepat e poshtëm të pozicionuar përgjatë linjës së belit. Kapakët janë realizuar me tekstil dopio të përforcuar me frazelinë ndërmjet dy shtresave të tekstit në brendësi dhe përfundojnë me kulme. Hapja dhe mbyllja e xhepave me kapakët realizohet me anë të velkrofëve “mashkull” – “femër”, të aplikuar në pjesën e brendshme të kapakëve, në korrespondencë me velkrofët e montuar në xhepa.
Shpina	Është realizuar me një pjesë. Bashkohet me pjesët e tjera në gavaturë (rreth mëngë) me anë të syzatorit, ndërsa në pjesët përpara në anësor me tegel linear. Linja fundore e xhupit pas përfundon me një kthim pale (tegel njëgjilpërësh).
Mëngët	Mëngët janë realizuar me dy pjesë: një mëngë e sipërme dhe një mëngë e poshtme. Mëngët bashkohen me trupin e xhupit me anë të syzatorit dhe tegelit linear njëgjilpërësh. Dy mëngët përfundojnë në linjën fundore me një palosje të brendshme me lartësi rreth 2 cm. Pjesa fundore e mëngës paraqet, në tegelin qepës të poshtëm në të dy pjesët përbërëse të saj, një gjuhëz, baza e të cilës është montuar në tegelin qepës. Tre drejtimet e tjera janë përshkuar me tegel linear perimetral njëgjilpërësh nga bordet. Në pjesën e poshtme të gjuhëzës është aplikuar një velkrof “mashkull”, në korrespondencë me të, në fund të mëngës, është montuar në drejtim horizontal një shirit velkrofi “femër”. Gjuhëza bën të mundur rregullimin e linjës fundore të mëngës për përshtatje të perimetrit të kyticit të dorës.
Spaletat	Spaletat janë montuar në linjën e supeve. Janë realizuar me dy shtresa tekstili, në formë drejtkëndore fundi i lirë i të cilave përfundon me kulm me majë. Baza (ana drejtkëndore e spaletave) montohet në rrethin e mëngës. Në skajin e lirë, me kulm me majë, të pjesës së poshtme të spaletës, është aplikuar një shirit velkrofi “femër” në formë drejtkëndor. Në korrespondencë me të është aplikuar një velkrof “mashkull”, të cilat bëjnë të mundur fiksimin e spaletës.
Pjesa e brendshme	Në brendësi të xhupit është aplikuar një “xhup” i brendshëm i realizuar me një shtresë me mbushje me vatinë, e cila është aplikuar ndërmjet dy shtresave të tekstit 100% poliestër (astar) të realizuar me tegela në formë romboidale. Pjesa e brendshme përbëhet nga: jaka, dy pjesët përpara, shpina, mëngët.
Etiketa	Në pjesën e brendshme të xhupit treçereksh në lartësinë e jakës në pjesën e prapme janë aplikuar etiketat e mëposhtme: • etiketa me demonstrimin e firmës furnizuese; • etiketa me udhëzimet e prerjes; • treguesi i përbërjes së tekstit me vitin e fabrikimit, si dhe instruksionet e larjes; • mirëmbajtja.

1. KOSTUM STOFI ME PËRZIERJE (XHAKETË, PANTALLONA, KAPELE)

Kostumi i uniformës është realizuar me tekstil me ngjyrë blu të errët dhe është konfeksionuar në prerje: 42, 44, 46, 48, 50, 52, 54, 56, 58, 60, 62, 64.

Kostumi përbëhet nga xhaketa, pantallonat dhe kapela.

A) XHAKETA

I. KONSTRUKTIMI - MODELIMI

Xhaketa duhet të jetë me tekstil stof me përzierje, ngjyra blu e errët, ku pjesët janë montuar me anë të tegelave qepës me ngjyrë në tonalitete me tekstilin.

Xhaketa përbëhet nga këto elementë:

- jaka;
- gjokset (përpara me dy pjesë);
- shpina;
- mëngët;
- xhepa me kapakë në linjën e gjokseve;
- xhepa të poshtëm me kapak;
- spaleta;
- astari;
- velkrofët.



Jaka	Model sportiv, me hapje.
Gjokset (përpara)	Përpara xhaketa është ndërtuar me dy pjesë, të cilat bashkohen ndërmjet tyre me anë të katër butonave me ngjyrë të artë.
Xhepat në linjën e gjokseve, me kapak	Në secilën pjesë përpara në linjën e gjokseve është montuar një xhep me kapak. Xhepat kanë dimensione 15x14 cm. Përgjatë qendrës së xhepit, në drejtim vertikal është realizuar një palë. Kapaku është realizuar me tekstil dopio, të njëjtë me xhaketën me kulme me majë. Hapja dhe mbyllja e xhepit me kapak realizohet me anë të montimit në xhep të butonit metalik me ngjyrë të artë, në korrespondencë me vrimën e aplikuar në kapak.
Xhepa të poshtëm me kapakë	Në secilën pjesë përpara në linjën e gjokseve është montuar një xhep me kapak. Xhepat e poshtëm kanë përmasa: 23x18 cm. Përgjatë qendrës së xhepit, në drejtim vertikal, është realizuar një palë. Kapaku është realizuar me tekstil dopio, të njëjtë me xhaketën me kulme me majë. Hapja dhe mbyllja e xhepit me kapak realizohet me anë të montimit në xhep të butonit metalik me ngjyrë të artë, në korrespondencë me vrimën e aplikuar në kapak.
Shpina	Shpina e xhaketës është realizuar me dy pjesë përgjatë qendrës në drejtim vertikal. Bashkimi i pjesëve realizohet me anë të tegelave qepës dhe përfundon me një çarje me lartësi rreth 23 cm, e cila është variabël, në varësi të masave.
Mëngët	Janë me dy pjesë. Bashkohen në anësore dhe në pjesën e poshtme me anë të tegelave qepës. Linja fundore e mëngëve përfundon me kthim pale rreth 2 cm.
Spaletat përgjatë linjës së supeve	Spaletat janë modeluar në formë drejtkëndore dhe përfundojnë me kulm me majë. Janë realizuar me tekstil dopio. Baza e secilës spaletë montohet në rrethin e mëngës ndërsa anët e tjera janë të lira e fiksohen me trupin e xhaketës në linjën e fillimit të supit në qafë me anë të velkroëve. Spaletat kanë gjatësi 13,7 cm dhe gjerësi 5 cm. Në distancë rreth 5 mm larg buzëve të spaletës është realizuar tegel dekorativ.
Astari i brendshëm	Është modeluar njësoj si xhaketa dhe është montuar në të gjitha pjesët e xhaketës në brendësi të saj. Astari duhet të jetë material saten. Astari nuk duhet të dalë poshtë xhaketës dhe duhet të jetë i lirshëm për të krijuar rehati në përdorim.
Velkrofët	Mbi xhepin e djathtë vendoset një shirit velkroft “femër” në formë drejtkëndëshi me ngjitje për vendosjen e emrit në përmasat 3.0x9.8 cm. Mbi xhepin e majtë vendoset velkroft “femër” për ngjitjen e gradës. Në qendër të mëngës së majtë, me ulje 12 cm nga maja e supit, qepet me tegel dysh velkroft “femër” hark në ngjyrë blu të zezë në të cilën do të vendoset stema me shkronjat kapitale “MZSH”.

- a) gjatësia e xhaketës e matur nga bashkimi i jakës me supanjën deri në fund;
 b) gjatësia e mëngës e matur nga pika më e lartë e tegelit të supit deri në fund.
 - Xhaketa duhet të jetë simetrike në të gjithë elementet e saj.

II. MATERIALET NDIHMËSE DHE AKSESORËT E PËRDORUR NË XHAKETË

Materialet ndihmëse që duhet të përdoren për prodhimin e artikullit “Xhakete” janë:

- kopsa të vogla me konfiguracion në ngjyrë të artë të shndritshme;
- penj për qepje me ngjyrë blu e errët, me ngjyrën e stofit;
- velkrofe “femër” me ngjyrë blu të errët.

B) PANTALLONA STOFI

Pantallonat duhet të jenë me tekstil të njëjtë me xhaketën me ngjyrë blu të errët.

Pantallonat përbëhen nga këto elemente:

- qemeri;
- këmbët;
- xhepa oblig (klasikë), të pjerrët përpara;
- xhepa fileto në pjesën e pasme.



Qemeri	Qemeri duhet të jetë realizuar me tekstil dopio dhe i përforcuar në brendësi me anë të frazelinës me termofiksion për qëndrim forme. Hapja dhe mbyllja e qemerit realizohet me anë të butonit metalik dhe vrimës së aplikuar në dy skajet e tij, si dhe kapëseve metalike “mashkull” – “femër” të aplikuara në pjesën e poshtme të qemerit në të dy skajet e tij. Në qemer janë montuar 6 ylyqe të realizuara me tekstil dopio.
Këmbët	Pantallonat janë realizuar me këmbët në pjesët përpara dhe pas, të cilat bashkohen me njëri-tjetrin me anë të tegelave anësore dhe tegelave nga brenda këmbëve. Pjesët përpara janë realizuar me penca. Hapja dhe mbyllja e pantallonave realizohet me anë të zinxhirit me lartësi rreth 22–24 cm, në varësi të masës, me ngjyrë blu në tonalitete me tekstilin, të montuar në sallki. Linja fundore e këmbëve përfundon me kthim pale me lartësi rreth 2.5–3 cm.
Xhepat e pjerrët, përpara	Në secilën këmbë përpara, nën linjën e qemerit, janë aplikuar xhepat klasikë të pjerrët me hapje rreth 3 cm, dhe thellësi rreth 17 cm, e filetuar me rreth 3 mm.
Xhep fileto pas	Xhepi fileto pas, duhet të jetë me kapak, me filetimit rreth 3 mm dhe me thellësi rreth 17 cm. Kapaku i xhepit të pasme është me majë në formë trekëndëshi. Kapaku është realizuar me tekstil dopio dhe përbëhet nga pjesa e sipërme dhe e poshtme. Në distancë rreth 1 mm larg buzës i kalohet një tegel zbukurimi. Gjatë kthimit duhet bërë kujdes që cepat dhe majat e kapakut të mos dalin të rrumbullakët. Hapja-mbyllja e xhepit me kapakun realizohet me kopsën në ngjyrë të zezë dhe vrimën.
Astari	Është aplikuar në këmbët e pantallonave deri në linjën e gjurit.

II. MATERIALET NDIHMËSE DHE AKSESORËT E PËRDORUR NË ARTIKULLIN PANTALLONA

- Qemeri i përgatitur;
- Kopsa të zeza;
- Astar xhepi në ngjyrë të errët material tekstili;
- Penj qepje në ngjyrë blu të errët;
- Kapëse metalike “mashkull” – “femër” për mbylljen në bel;
- Zinxhir me dhëmbëza plastike 22–24 cm për pantallona.

III. MASAT

TABELA E PËRMASAVE PËR MESHKUJ

(përmasat e shprehura në cm – tolerancë +/- 3%)



PANTALLONA PRERJE (DROP) 2

XHAKETË PRERJE (DROP) 2

PRERJA	LARTËSIA E PËRGJITHSH ME	1/2 PERIMETRIT TË BELIT	GJERËSIA E PANTALLONIT NË LINJËN FUNDORË	GJATËSIA E KËMBËS NGA JASHTË (PA QEMERIN)	GJATËSIA E KËMBËS NGA BRENDA
44	160,5	42	22	109	87
46	163,5	44	22	109	87
48	166,5	46	22,5	110	88
50	167,5	48	22,5	110	88
52	173	50	22,5	110	88
54	176	52	22,5	111	89
56	179	54	23	111	89
58	182	56	23	111	89
60	182	58	23	111	89
62	182	60	23	111	89
64	182	62	23	111	89

TABELA E PËRMASAVE PËR MESHKUJ
(përmasat e shprehura në cm – tolerancë +/- 3%)

PRERJA	LARTËSIA E PËRGJITHSH ME	GJATËSIA E XHAKETËS (nga tegeli bashkues i jakës deri në linjën fundore)	1/2 E GJERËSISË SË SHPATULLAVE	GJATËSI MËNGJE	PJERRËSIA E SUPEVE	1/2 E PERIMETRIT TË KRAHARORIT
44	160,5	75	20,5	60	12,5	47
46	163,5	75	21,5	61	12,5	49
48	166,5	76	22,5	62	13	51
50	167,5	77	23,5	63	13	53
52	173	78	24,5	64	13	55
54	176	79	25,5	65	13,5	57
56	179	80	26,5	66	13,5	59
58	182	80	27,5	67	13,5	61
60	182	80	28,5	68	14	63
62	182	80	29,5	69	14	65
64	182	80	30,5	70	14	67



XHAKETË PRERJE (DROP) 4

PRERJA	LARTËSIA E PËRGJITHSHME	GJATËSIA E XHAKETËS (nga tegeli bashkues i jakës deri në linjën fundore)	1/2 E GJERËSISË SË SHPATULLAVE	GJATËSI MËNGE	PJERRËSIA E SUPEVE	1/2 E PERIMETRIT TË KRAHARORIT
44	165	75	20,5	60	12,5	49
46	168	75	21,5	61	12,5	51
48	171,5	76	22,5	62	13	53
50	174,5	77	23,5	63	13	55
52	177	78	24,5	64	13	57
54	179	79	25,5	65	13,5	59
56	181,5	80	26,5	66	13,5	61
58	183,5	80	27,5	67	13,5	63
60	183,5	80	28,5	68	14	65
62	183,5	80	29,5	69	14	67
64	183,5	80	30,5	70	14	69

PANTALLONA PRERJE (DROP) 4

PRERJA	LARTËSIA E PËRGJITHSHME	1/2 E PERIMETRIT TË BELIT	GJERËSIA E PANTALLONIT NË LINJËN FUNDORE	GJATËSIA E KËMBËS NGA JASHTË (PA QEMERIN)	GJATËSIA E KËMBËS NGA BRENDA
44	165	40	22	109	87
46	168	42	22	109	87
48	171,5	44	22,5	110	88
50	174,5	46	22,5	110	88
52	177	48	22,5	110	88
54	179	50	22,5	111	89
56	181,5	52	23	111	89
58	183,5	54	23	111	89
60	183,5	56	23	111	89
62	183,5	58	23	111	89
64	183,5	60	23	111	89



TABELA E PËRMASAVE PËR MESHKUJ
(përmasat e shprehura në cm – tolerancë +/- 3%)

XHAKETË PRERJE (DROP) 6

PRERJA	LARTËSIA E PËRGJITHSHME	GJATËSIA E XHAKETËS (nga tegeli bashkues i jakës pas deri në linjën fundore)	1/2 E GJERËSISË SË SHPATULLAVE	GJATËSI MËNJE	PJERRËSIA E SUPEVE	1/2 E PERIMETRIT TË KRAHARORIT
44	166,5	75	20,5	60	12,5	51
46	169,5	75	21,5	61	12,5	53
48	173	76	22,5	62	13	55
50	176,5	77	23,5	63	13	57
52	178,5	78	24,5	64	13	59
54	180,5	79	25,5	65	13,5	61
56	183,5	80	26,5	66	13,5	63
58	185	80	27,5	67	13,5	65
60	186,5	80	28,5	68	14	67
62	187,5	80	29,5	69	14	69
64	187,5	80	30,5	70	14	71

PANTALLONA PRERJE (DROP) 6

PRERJA	LARTËSIA E PËRGJITHSHME	1/2 E PERIMETRIT TË BELIT	GJERËSIA E PANTALLONIT NË LINJËN FUNDORË	GJATËSIA E KËMBËS NGA JASHTË (PA QEMERIN)	GJATËSIA E KËMBËS NGA BRENDË
44	166,5	38	21,5	109	87
46	169,5	40	21,5	109	87
48	173	42	21,5	110	88
50	176,5	44	21,5	110	88
52	178,5	46	22	110	88
54	180,5	48	22	111	89
56	183	50	22,5	111	89
58	185	52	22,5	111	89
60	186,5	54	22,5	111	89
62	187,5	56	23	111	89
64	187,5	58	23	111	89

3. ARTIKULLI - KAPELE

Kapela duhet të jetë blu e errët me material trikotazh (ku të dyja palët të jenë të qepura me pe, blu të errët).

Materialet të cilat duhen të përdoren për ndërtimin e kapelës janë:

- stof i njëjtë me atë të pantallonave;
- material plastik i pathyeshëm, për fortesë ku do të vendoset emblema;
- forma e kapelës është rrumbullake;

- kapela është me strehë dhe duhet të përbëhet nga material plastik i shndritshëm ku streha në qendër ka përmasat 6 cm dhe vjen duke u zvogëluar në formë harku të brendshëm;

- mbi strehën e kapelës në pjesën ballore, ose urën ballore vendoset stema e Republikës së Shqipërisë e dizajnuar me material plastik dhe në ngjyrat e stemës.



Niveli madhor



Niveli lartë



Niveli mesëm

4. KËMISHË ME MËNGË TË GJATA

Këmisha me mëngë të gjata duhet të realizohet me tekstil puplin (përzierje pambuk + poliestër) me ngjyrë të bardhë.

I. KONSTRUKTIMI I KËMISHËS

Këmisha me mëngë të gjata përbëhet nga:

- jaka;
- gjokset (pjesët përpara);
- shpina;
- mëngët e gjata me kapakë;
- xhepat pllakë me mbyllje me kapak;
- spaleta (spalina);
- velkroffë.



Jaka	Është model klasik, i përbërë nga dy pjesë: jaka dhe kama. Jaka është realizuar me tekstil dopio. Jaka është realizuar me kollarisje ku në brendësi është vendosur frazelinë me termofiksion në të nxehtë për qëndrimin e formës. Jaka përfundon me kulme me majë ku në brendësi të majës është vendosur stekë plastike për qëndrimin e formës. Në skajin e kamës është montuar kopsë në korrespondencë me vrimën e aplikuar në skajin tjetër për hapjen dhe mbylljen e jakës së këmishës.
Gjokset	Përpara këmisha është realizuar me dy pjesë me prerje përgjatë qendrës në drejtim vertikal. Dy pjesët mbyllen me anë të 6 kopsave plastike me ngjyrë të bardhë, në korrespondencë me vrimat, të aplikuara në bordet përpara. Pjesët bashkohen në anësor me shpinën me anë të tegelave, ndërsa në mëngë me tegel syzator dhe tegel linear. Në anësore përfundojnë të harkuara me një kthim pale.
Shpina	Shpina është realizuar me dy pjesë: supanja me tekstil dopio dhe pjesa e poshtme me tekstil tek. Në anësore përfundojnë të harkuara me vazhdimësi me pjesët përpara dhe me një kthim pale.
Mëngë të gjata me kapak	Mëngët e gjata përbëhen nga pjesa kryesore e mëngës, cika (hapja) dhe kapaku i mëngës. E hapura e mëngës mbyllet me kopsë me katër vrima. Në qendër të mëngës së majtë, me ulje 12 cm nga maja e supit, qepet me tegel dysh velkrof “femër” hark, në ngjyrë blu të errët, në të cilën do të fiksohet stema me shkronja kapitale “MZSH”.
Xhepa me kapak në linjën e gjoksit	Xhepat me kapakë në linjën e gjoksit, janë pllakë me përmasa 14x16 cm. Në secilin xhep, në drejtim vertikal përgjatë qendrës është aplikuar një palë rreth 3 cm. Xhepat në të dy anët poshtë janë me cepa me formë të prerë. Në bordurën e secilit xhep lart, në mes të tyre vendoset një kopsë plastike në ngjyrë të artë të shndritshme që shërben për mbylljen e xhepit. Xhepat u kalohet një tegel zbukurimi 1 mm larg buzëve. Xhepat mbyllen me kapak.



	Kapakët janë realizuar me tekstil dopio, me harqe të harkuara nga brenda dhe me një vrimë në mes. Kapakët përbëhen nga pjesa e sipërme dhe e poshtme. Pjesës së sipërme të kapakut për përforsim i vendoset kollarisje. Mbi kapakun e xhepit të djathtë në qendër vendoset velkrof “femër” në ngjyrë blu të errët në formë drejtkëndëshi që do të shërbejë për vendosjen e mbiemrit.
Spaleta	Spaletat janë modeluar në formë drejtkëndore dhe përfundojnë me kulm me majë. Janë realizuar me tekstil dopio. Baza e secilës spaletë montohet në rrethin e mëngës ndërsa anët e tjera janë të lira e fiksohen me trupin e këmbës, në linjën e fillimit të supit në qafë me anë të velkrofeve. Në distancë, rreth 5 mm larg buzëve të spaletës, është realizuar tegel dekorativ.
Velkrofe	Në krahun e majtë dhe në të djathtë të veshur, në këmbës vendosen velkrofet “femër” në ngjyrë të bardhë. Në gjoksin e djathtë të veshur, mbi xhep, vendoset velkrof “femër” në formë drejtkëndëshi me ngjyrë të bardhë.

Këmisha duhet të jetë simetrike në të gjithë elementet e saj.

II. MATERIALET NDIHMËSE QË DUHET TË PËRDOREN PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT “KËMISHË ME MËNGË TË GJATA” JANË:

- Kollarisje që është material tekstili ngjytës me fortesë të plotë për të përforsuar jakën si për spalinat dhe kapakët e xhepave;
- Kopsa të vogla me ngjyrë të artë të shndritshme;
- Kopsa të vogla me ngjyrë të bardhë;
- Velkrofe “femër” me ngjyrë të bardhë;
- Maja plastike (steka) për përforsim të majave të jakës, 2 copë;
- Filli qepës: 100 % poliester, ngjyrë e bardhë.

III. TABELA E PËRMASAVE PËR MESHKUJ

[Përmasat e shprehura në cm (1/2 e përmasave reale)]

PRERJA	XS	S	M	L	XL	XXL	XXXL	4XL	5XL
Gjatësia e jakës	37	39	41	43	45	47	49	51	53
Gjatësia e kamës së jakës	41	43	45	47	49	51	53	55	57
Gjatësia pas e këmbës nisur nga jaka (bashkimi jakë/linjë fundore)	74	76	78	80	82	84	86	86	86
Gjerësia e shpatullave	44	46	48	50	52	54	56	58	60
1/2 e perimetrit të krahavorit	53	56	59	62	65	68	71	74	76
1/2 e perimetrit të belit	48	52	56	59	63	68	71	74	76
1/2 e perimetrit të vitheve (1/2 e linjës fundore të këmbës)	49	53	57	60	64	68	71	74	76
Gjatësia e mëngës (përfshirë manshetën/kapakun)	59	60	62	66	69	71,5	73	73	73
Gjerësia e kyçit të dorës	22	24	26	27	28	29	30	30	30

5. PULOVËR JAKË “V”

Pulovra duhet të realizohet me tekstil trikotazh, me ngjyrë blu të errët, me material, me jakë “V”.

I. KONSTRUKTIMI I PULOVËRËS JAKË “V”

- Pulovra përbëhet nga jaka në formë V-je, mëngët, shpina, gjoksi, spalinat dhe fortesat dok trikoton në ngjyrë blu të errët në sup dhe në bërryl;

- Linja fundore e mëngëve dhe e pulovrës përfundon me bordurë me thurje llastik për përshtatje dhe qëndrim të formës sipas perimetrave;

- Në krahun e majtë lart vendoset stema e rrumbullakët me shkronja kapitale “MZSH”;

- Sipër në gjoksin e djathtë vendoset velkrof “femër” në formë drejtkëndëshi me ngjyrë blu të errët;

- Jaka në formë V-je, mëngët, shpina dhe gjoksi janë të përgatitura me anë të procesit të trikotimit;

- Spalinat janë me maja të harkuara dhe vendosen në të dy supet;

- Spalina përbëhet nga pjesa e sipërme dhe e poshtme. Pjesës së sipërme të spalines për përforsim i vendoset kollaritje (material tekstili ngjytës);

- Spalina ka gjatësia 13,7 cm dhe gjerësi 5 cm; spalines 5 mm larg buzëve i kalohet një tegel zbkurimi;

- Spalinat duhen të shohin lart, si dhe spalinave sipër në majë iu vendoset velkrof “femër” në ngjyrë blu të errët dhe nga poshtë velkrof “mashkull” në ngjyrë blu të errët për fiksime te supi me velkrofin “femër” korrespondues të vendosur në sup.



II. MATERIALET NDIHMËSE QË DUHET TË PËRDOREN PËR NDËRTIMIN E ARTIKULLIT “PULOVËR” JANË:

- Dok trikoton me ngjyrë blu të errët;

- Fill qepës me ngjyrë blu të errët;

- Velkrofe femër me ngjyrë blu të errët;

III. TABELA E MASAVE

(përmasat e shprehura në cm – tolerancë +/- 3%)

PËRMASAT E VESHJES SË PËRFUNDUAR	XS	S	M	L	XL	2XL	3XL	4XL
Gjatësia totale (nga kulmi i supit deri në linjën fundore)	63	65	67	68	70	71	72	73
1/2 e gjerësisë së gjoksit (e matur 2 cm nën linjën e sektorit)	50	52	54	56	58	60	62	64
1/2 e gjerësisë së shpatullave	38	40	42	44	46	48	50	52
Gjatësia e mëngës	59	60	61	62	63	64	65	66
Gjerësia e katurës së mëngës	22	23	24	25	26	27	27	27
Lartësia e mëngës, koka e mëngës	18	19	20	21	22	23	23	23
1/2 e gjerësisë së kyçit të dorës (pulsit)	10	10	10	10	11	11	11	11



PËRMASAT E PËRBASHKËTA PËR TË GJITHA PRERJET

- Lartësia e bordurës së linjës fundore 6,5 cm;
- Lartësia e pulsit (linjës së kyçit të dorës) 6,5 cm;
- Gjatësia e hapjes së jakës 19 cm.

6. KËMISHË ME MËNGË TË SHKURTRA

Këmisha me mëngë të shkurtra duhet të realizohet me tekstil puplin (përzierje pambuk + poliestër) me ngjyrë të bardhë.

I. KONSTRUKTIMI I KËMISHËS

Këmisha me mëngë të shkurtra përbëhet nga:

- jaka;
- gjokset (pjesët përpara);
- shpina;
- mëngët e shkurtra me kapakë;
- xhepat pllakë me mbyllje me kapak;
- spaleta (spalina);
- velkrofë.



Jaka	Është model klasik, i përbërë nga dy pjesë: jaka dhe kama. Jaka është realizuar me tekstil dopio. Jaka është realizuar me kollaritje ku në brendësi është vendosur frazelinë me termofiksim në të nxehtë për qëndrimin e formës; Jaka përfundon me kulme me majë ku në brendësi të majës është vendosur stekë plastike për qëndrimin e formës; Në skajin e kamës është montuar kopsë, në korrespondencë me vrimën e aplikuar në skajin tjetër, për hapjen dhe mbylljen e jakës së këmishës.
Gjokset	Përpara këmisha është realizuar me dy pjesë me prerje përgjatë qendrës në drejtim vertikal; Dy pjesët mbyllen me anë të 6 kopsave plastike me ngjyrë të bardhë, në korrespondencë me vrimat, të aplikuar në bordet përpara; Pjesët bashkohen në anësore me shpinën me anë të tegelave, ndërsa në mëngë me tegel syzator dhe tegel linear; Në anësore përfundojnë të harkuara me një kthim pale.
Shpina	Shpina është realizuar me dy pjesë: supanja me tekstil dopio dhe pjesa e poshtme me tekstil tek; Në anësore përfundojnë të harkuara me vazhdimësi me pjesët përpara dhe me një kthim pale.
Mëngë të shkurtra	Mëngët e shkurtra me një pjesë; Në qendër të mëngës së majtë, me ulje 12 cm nga maja e supit, qepet me tegel dysh velkrof “femër” hark në ngjyrë blu të errët në të cilën do të fiksohet stema me shkronja kapitale “MZSH”.
Xhepa me kapak në linjën e gjoksit	Xhepat me kapakë në linjën e gjoksit, janë pllakë me përmasa 14x16 cm; në secilin xhep, në drejtim vertikal përgjatë qendrës është aplikuar një palë rreth 3 cm. Xhepat në të dy anët poshtë janë me cepa me formë të prerë; Në bordurën e secilit xhep lart, në mes të tyre vendoset një kopsë plastike në ngjyrë të artë të shndritshme që shërben për mbylljen e xhepit; Xhepave u kalohet një tegel zbukurimi 1 mm larg buzëve. Xhepat mbyllen me kapak; Kapakët janë realizuar me tekstil dopio, me harqe të harkuara nga brenda dhe me një vrimë në mes. Kapakët përbëhen nga pjesa e sipërme dhe e poshtme. Pjesës së sipërme të kapakut për përforcim i vendoset kollarisje; Mbi kapakun e xhepit të djathtë në qendër vendoset velkrof “femër” në ngjyrë blu të errët në formë drejtkëndëshi që do të shërbejë për vendosjen e mbiemrit.



Spaleta	Spaletat janë modeluar në formë drejtkëndore dhe përfundojnë me kulm me majë; Janë realizuar me tekstil dopio; Baza e secilës spaletë montohet në rrethin e mëngës ndërsa anët e tjera janë të lira e fiksohen me trupin e këmbës, në linjën e fillimit të supit në qafë me anë të velkrofëve; Në distancë rreth 5 mm larg buzëve të spaletës është realizuar tegel dekorativ.
Velkrofë	Në krahun e majtë dhe në të djathtë të veshur, në këmbë vendosen velkrofet “femër” në ngjyrë të bardhë. Në gjoksin e djathtë të veshur, mbi xhep, vendoset velkrof “femër” në formë drejtkëndëshi me ngjyrë të bardhë.

Këmbisha duhet të jetë simetrike në të gjithë elementet e saj.

II. MATERIALET NDIHMËSE QË DUHET TË PËRDOREN PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT “KËMBISHË ME MËNGË TË GJATA” JANË:

- Kollaritje që është material tekstili ngjitës me fortesë të plotë për të përforcuar jakën, si dhe për spalinat dhe kapakët e xhepave;
- Kopsa të vogla me ngjyrë të artë të shndritshme;
- Kopsa të vogla me ngjyrë të bardhë;
- Velkrofe “femër” me ngjyrë të bardhë;
- Maja plastike (steka) për përforcim të majave të jakës, 2 copë;
- Filli qepës: 100 % poliestër, ngjyrë e bardhë.

III. TABELA E PËRMASAVE PËR MESHKUJ

[Përmasat e shprehura në cm (1/2 e përmasave reale)]

PRERJA	XS	S	M	L	XL	2XL	3XL	4XL	5XL
Gjatësia e jakës	37	39	41	43	45	47	49	51	53
Gjatësia e kamës së jakës	41	43	45	47	49	51	53	55	57
Gjatësia pas e këmbës nisur nga jaka (bashkimi jakë/linjë fundore)	74	76	78	80	82	84	86	86	86
Gjerësia e shpatullave	44	46	48	50	52	54	56	58	60
1/2 e perimetrit të kraharorit	53	56	59	62	65	68	71	74	76
1/2 e perimetrit të belit	48	52	56	59	63	68	71	74	76
1/2 e perimetrit të vitheve (1/2 e linjës fundore të këmbës)	49	53	57	60	64	68	71	74	76

7. T-SHIRT “BLUZË” ME MËNGË TË GJATA

Bluza me mëngë të gjata duhet të jetë modeluar me tekstil trikotazh *jersey*, me jakë të mbyllur të rrumbullakët, me ngjyrë blu të errët.

I. KONSTRUKTIMI (MODELIMI) I T-SHIRT-it “BLUZËS” ME MËNGË TË GJATA

T-shirt-i i modeluar me jakë të rrumbullakët është i përbërë nga:

- Jaka;
- përpara;
- shpina;
- mëngë të gjata në formë tubolare.



Jaka	Jakë e mbyllur e rrumbullakët, me bordurë e cila përfundon me një shirit me lartësi rreth 12 mm.
Përpara	Përpara me një pjesë, bashkohet në anësor (montuar) me pjesën pas me tegel makine.
Shpina	Shpina është realizuar me një pjesë. Linja fundore e t-shirt-it si në pjesën përpara ashtu dhe në pjesën pas përfundon me një kthim bordure rreth 2 cm.
Mëngë të gjata	Mëngët duhet të jenë të gjata me një pjesë, në formë tubolare. Mëngët përfundojnë me një bordurë me gjerësi 3,5 cm.
Velkrof	Në gjoksën e anës së majtë vendosen velkrofet “femër” në ngjyrë blu të errët, për fiksimin e stemës me shkronja kapitale “MZSH”.

III. TABELA E PËRMASAVE PËR MESHKUJ

	T-shirt me mëngë të gjata blu	XS	S	M	L	XL	2XL
A	Gjatësia totale e t-shirt-it	62	66	69	72	75	77
B	½ e gjerësisë (perimetrit) të gjoksit	41	45	49	53	57	61
C	Gjerësia e shpatullave	38	42	46	50	54	58
D	Lartësia e mëngës në montim	24	25	27	28	29	30
E	Gjatësia e mëngës	59	61	64	64,5	65	66
F	1/2 e perimetrit të kyçit të dorës	9	9	10	11	11,5	12
G	Gjerësia e jakës pas (1/2 e perimetrit të qafës)	15,5	16,5	17,5	18,5	19,5	20,5
K	½ e gjerësisë në fund (linjës fundore)	41	45	49	53	57	61
M	Gjerësia (perimetri) e krahut	18	20	22	23	24	25

PËRMASAT STANDARDE:

- I. Lartësia e jakës (hapja e jakës) përpara 8 cm;
- J. Lartësia e kthimit të palës së mëngës 2 cm;
- L. Gjerësia e jakës 1,2 cm.

II. MATERIALET NDIHMËSE QË DUHET TË PËRDOREN PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT “BLUZË ME MËNGË TË GJATA”

Tekstil *jersey* trikotazh me përbërje pambuku (*cotton*), me ngjyrë blu të errët;

Fill qepës 100 % poliester, me ngjyrën blu të errët në tonalitete me tekstilin trikotazh.



8. POLO - BLUZË ME MËNGË TË SHKURTRA

Bluza me mëngë të shkurtra është e realizuar me tekstil trikotazh, 100% pambuk me ngjyrë blu.

I. NDËRTIMI I POLOS

Bluza përbëhet nga jaka klasike me mëngë të shkurtra.

- Përpara;
- Shpina;
- Mëngë të shkurtra.



Jaka	Jaka është model klasik i realizuar me tekstil prej trikotazhi i lastik në drejtim vertikal me lartësi standarde (fikse) prej 7 cm.
Përpara	Përpara polo është ndërtuar vetëm nga një pjesë dhe përgjatë linjës qendrore në korrespondencë me hapjen e jakës paraqet një hapje me thellësi rreth 13.5 cm; Në anën e majtë të veshur në hapje (të quajtur dhe fileto) janë aplikuar dy vrima, një vrimë në drejtim horizontal, në distancë rreth 1 cm nga bordura e sipërme, dhe një vrimë në drejtim vertikal, në distancë rreth 6,5 cm nga vrima e parë; Ana e djathtë është e përbërë nga dy shtresa tekstili të qepura ndërmjet tyre ku në brendësi të tyre është aplikuar një shtresë tekstili termoadezive e pa deformueshme (frazelinë) e cila shërben si fortesë, në linjën qendrore përgjatë aksit të kësaj ane janë montuar dy kopsa të qepura me fill qepës prej poliesteri me katër vrima në korrespondencë me vrimat e aplikuara të anës tjetër.
Shpina	Shpina është realizuar me një pjesë; Linja fundore e polos si në pjesën përpara ashtu dhe në pjesën pas, përfundon me një kthim bordure rreth 2 cm.
Mëngë të shkurtra	Mëngët duhet të jenë të gjata me një pjesë në formë turbolare. Mëngët mbyllen me qepje të poshtme me tegel linear njëgjilpërësh dhe të rforcuar nga brenda me tegel syzator. Mëngët përfundojnë me një bordurë prej tekstili trikotazh i lastik me gjerësi rreth 3 cm.
Velkrof	Në gjoksin e anës së djathtë montohet velkrof “femër” në ngjyrë blu të errët, për fiksimin e stemës me shkronja kapitale “MZSH”; Në krahun e majtë dhe në të djathtë të veshur, në këmbë vendosen velkrofet “femër” në ngjyrë blu të errët.

II. MATERIALET NDIHMËSE QË DUHET TË PËRDOREN PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT “POLO - BLUZË ME MËNGË TË SHKURTRA”:

- Tekstil trikotazh, 100% pambuk, me ngjyrë blu të errët;
- Fill qepës 100% poliestër me ngjyrë e pambukut;
- Velkrofe “femër” me ngjyrë blu të errët.

9. PANTALLONA VERE

Pantallona vere, dok me ngjyrë blu të errët.

I. KONSTRUKTIMI I PANTALLONAVE VERORE

Pantallonat përbëhen nga këto elementë:

- qemeri;
- këmbët;
- xhepa oblig (klasikë), të pjerrët përpara;
- xhepa fileto në pjesën e pasme.





Qemeri	Qemeri duhet të jetë realizuar me tekstil dopio dhe i përforcuar në brendësi me anë të frazelinës me termofiksion për qëndrimin e formës; Hapja dhe mbyllja e qemerit realizohet me anë të kopsës plastike me ngjyrë të zezë dhe vrimës së aplikuar në të dy skajet e tij; Në qemer janë aplikuar 6 vlyqe (kalues) të realizuara me dopio tekstil.
Këmbët	Pantallonat janë realizuar më këmbët në pjesët përpara dhe pas, të cilat bashkohen me njëri-tjetrin me anë të tegelave anësore dhe tegelave nga brenda këmbëve; Pjesët përpara janë realizuar me penca; Hapja dhe mbyllja e pantallonave realizohet me anë të kopsave të montuara në sallki, në varësi të masës; Linja fundore e këmbëve përfundon me kthim pale me lartësi rreth 2.5–3 cm.
Xhepat e pjerrët, përpara	Në secilën këmbë përpara nën linjën e qemerit janë aplikuar xhepat klasikë të pjerrët.
Xhep fileto pas	Xhepi fileto pas, duhet të jetë me kapak; Kapaku është realizuar me tekstil dopio dhe përbëhet nga pjesa e sipërme dhe e poshtme; Në distancë rreth 1 mm larg buzës i kalohet një tegel zbukurimi; Hapja–mbyllja e xhepit me kapakun realizohet me kopsën në ngjyrë të zezë dhe vrimën.
Astari	Është aplikuar në xhepat e pantallonave para dhe pas.

5. FUND VEROR

Fundi për femra duhet të realizohet me tekstil ngjyrë blu të errët, me përbërje të njëjtë sikurse xhaketa. Fundi ka gjatësi deri 10 cm nën gjunjë.



I. KONSTRUKTIMI I FUNDIT

Fundi veror përfundon në fund me një palë të brendshme rreth 5 cm, të realizuar me tegel qepës syzator dhe është e përbërë nga elementet e mëposhtëm:

- qemeri;
- parsja;
- shpina (me dy pjesë).

Qemeri	Është realizuar me dy pjesë (pjesa e jashtme dhe pjesa e brendshme me përmasa të njëjta), me lartësi rreth 4 cm dhe është përshkuar me tegel linear perimetral 1 mm nga bordet. Në të djathtë të pjesës mbrapa, qemeri është më i gjatë se perimetri i belit të fundit pasi shërben për montimin e kopsës. Ekstremiteti i qemerit është me kulme dhe në distancë rreth 2 cm nga qendra e tij është aplikuar një vrimë horizontale rreth 20 mm në korrespondencë me të cilën në anën e majtë të veshur është aplikuar një kopsë plastike; Përgjatë qemerit janë montuar 4 kalues, me përmasa: lartësi 6 cm dhe gjerësi 18 mm, me hapësirë të brendshme 5 cm, të përforcuar (fillimi i qemerit) në pjesën e jashtme me tegel qepës dhe poshtë në pjesën e brendshme. Kaluesit janë realizuar me tekstil dopio; Kaluesit janë aplikuar: 2 përpara në një linjë me pencat (një në anën e djathtë përpara dhe një kalues në anën e majtë), 2 kalues janë montuar në pjesën prapa dhe këto janë montuar në një linjë me pencat (një djathtas dhe një majtas).
Parse	Përpara është realizuar vetëm me një pjesë (pa prerje) dhe bashkohet me pjesët e prapme me anë të tegelit linear njëgjilpërësh në linjën anësore. Në pjesën përpara janë aplikuar dy penca në një linjë me kaluesit e montuar në pjesën përpara. Gjatësia e pencave është rreth 8 cm.
Shpina	Shpina është realizuar me dy pjesë të cilët bashkohen nga linja fundore e qemerit deri në fillimin e të çarës përgjatë linjës qendrore me tegel qepës vertikal. Në pjesën prapa janë aplikuar dy penca të pozicionuara në një linjë me kaluesit e montuar me gjatësi rreth 9 cm secila. Përgjatë linjës qendrore në pjesën e sipërme është montuar një zinxhir me gjatësi rreth 18 cm, me ngjyrë në tonalitetit me tekstinin e fundit. Zinxhiri është mbuluar nga një mostër e aplikuar në anën e djathtë. E çara mbrapa është aplikuar në linjën qendrore me lartësi rreth 15 cm nga linja

fundore dhe është realizuar me tegel të fshehtë dhe ngjitje. Ana e djathtë e hapjes (e çara) ka një palë të brendshme me gjatësi rreth 5.5 cm afërsisht ndërsa anës së majtë i është vënë në dukje pala e anës së djathtë).
--

6. RRIP PANTALLONASH

Rripi për pantallona është i prodhuar me material lëkure me ngjyrë të zezë, me gjerësi 3 cm dhe me togëz metalike.

7. KËPUCE VERORE

Këpucët janë prodhuar me material lëkure rezistente në lagështi me trashësi prej 1,8–2,0 mm dhe material gome.

Këpucët përbehen nga këto elemente:

- faqe këpuce;
- maja;
- përforcues i brendshëm;
- astar i brendshëm;
- thembra;
- shtroja (mbështetësja);
- shollë gome TR.



1. FAQE KËPUCE

Faqet e këpucës janë realizuar me pjesë të cilat bashkohen ndërmjet tyre me anë të tegelit qepës. Lëkura e përdorur duhet të jetë e një cilësie të mirë, e marrë nga pjesët më të mira, e trajtuar me krom, me ngjyrë të zezë me trashësi rreth 1,8–2 mm. Faqet kambale janë përshkuar si nga tegela bashkues qepës perimetral, ashtu dhe me tegela për efekt estetik. Në dy faqet kambale, në lartësinë e qafës së këpucës, janë aplikuar katër vrima me veshje hekuri të cilat shërbejnë për mbylljen e këpucës nëpërmjet lidhëseve tubolare prej pambuku. Faqja e përparme bashkohet me trupin e faqeve me tegel qepës zburues dhe përfundon në afërsi të qafës së këpucës me aplikimin e një llape e cila është e përforcuar me anë të tegelit qepës syzator dhe montuar me anë të tegelit qepës perimetral.

Faqet bashkohen me shtrojen, xhiron rrethuese dhe shollën nëpërmjet procesit të ngjitjes.

2. MAJA

Është realizuar nga material prej pambuku të presuar me ngjitës me bazë laktike, me trashësi rreth 0,8 mm, aplikuar në pjesën e përparme nga brenda këpucës ndërmjet astarit dhe faqes së sipërme të këpucës.

3. PËRFORCUES I BRENDSHËM

I realizuar prej materiali sintetik në brendësi dhe në anën e pasme ndërmjet faqes së sipërme dhe astarit të brendshëm.

4. ASTARI I BRENDSHËM

Pjesa e brendshme e këpucës: llapa, faqet kambale dhe thembra janë realizuar me astar prej lëkure të butë.

5. THEMBRA

Është realizuar me material lëkurë me trashësi rreth 2 mm, e pozicionuar në pjesën mbështetëse të thembrës, në pjesën e poshtme të së cilës është aplikuar një shtresë sfungjeri amortizuese. Thembra bashkohet me shtrojen me anë të procesit të ngjitjes.



6. SHTROJA

Është e realizuar me material shumë shtresor me anë të procesit të ngjitjes dhe është e përbërë nga:

- texon (karton kompakt);
- lamin;
- kambrion (karton i presuar);

- taban prej lëkure;
- gjysmë shtroje prej lëkure derri e trajtuar me krom.

7. SHOLLA PREJ GOME

Është realizuar me material gome, dhe bashkohet me tabanin nëpërmjet ngjitjes. Pjesa fundore e këpucës përfundon me një dizenim me vijëzime me dimensione të ndryshme për funksion anti rrëshqitës.

AKSESORËT

Filli – për faqet e këpucës përdoret fill qepës me përbërje 100% poliamid;

Thumbat – prej hekuri të përdorur për montimin e thembrës;

Ngjitësit – duhet të jenë të llojit dhe të cilësisë nga më të mirët në treg, jo dëmtues dhe të përshtatshëm në përdorim;

Lidhëset – duhet të jenë prej pambuku të mercerizuar të tipit tub me ngjyrë të zezë, që nuk krijojnë nyje me ekstremet plastike.

8. KËPUCË DIMËRORE

Këpucët me qafa dimërore janë realizuar nga elemente prej lëkure dhe gome dhe përbëhen nga këto pjesë dhe aksesore:

- faqet e këpucës (faqe e përparme dhe faqet anësore);
- maja;
- përforcues i brendshëm;
- astar i brendshëm;
- thembra;
- shtroja (mbështetësja);
- shollë.

FAQET

Faqet e këpucës me qafa përbëhen nga pjesët (faqet e përparme, dy faqe kambale (faqe anësore) thembra, dhe llapa të cilat bashkohen me tegel qepës linear njëgjilpërësh dhe dygjilpërësh. Lëkura e përdorur është me trashësi 1.8–2,00 mm. Dy faqet anësore të këpucës përfundojnë me një mbivendosje bordure të sipërme të bashkuar me anë të tegelit linear dygjilpërësh perimetral. Gjithashtu, ky tegel është aplikuar dhe për efekt estetik.

Në faqet anësore janë montuar në lartësinë e qafës së këmbës (samarin e këmbës) katër vrima të veshura me hekur të cilat lejojnë shtrëngimin e këpucës nëpërmjet lidhëseve prej pambuku. Faqet bashkohen me shtrojen, xhiron rrethuese, dhe shollën nëpërmjet procesit të ngjitjes dhe tegelave qepës.



MAJA

Është realizuar me material prej pambuku të presuar me ngjitës me bazë laktike me trashësi rreth 0,8 mm, e aplikuar në pjesën e përparme nga brenda këpucës, ndërmjet astarit dhe faqes së sipërme të këpucës si te Kampioni Zyrtar.

PËRFORCUES I BRENDSHËM

I realizuar prej materiali plastik me trashësi rreth 1,4 mm është aplikuar në anën e pasme ndërmjet faqes së jashtme dhe astarit të brendshëm dhe është modeluar si te Kampioni Zyrtar.

ASTAR I BRENDSHËM

Pjesa e brendshme e këpucës: llapa, faqet (anësore dhe ballore) janë të realizuara me astar prej lëkure.

Astari prej lëkure është i aplikuar në tri pjesë, të gjitha të ekspozuara nga pjesa e sipërme e lëkurës. Astari prej lëkure: pjesa e jashtme e saj është aplikuar përgjatë anëve të këpucës dhe është fiksuar me faqen e përparme me gjysmë ngjitje; ndërsa është bashkuar me tegel qepës perimetral të brendshëm.

THEMBRA

Është realizuar me lëkurë të butë me trashësi rreth 0,8 mm e pozicionuar në pjesën e poshtme ku mbështetet thembra, poshtë së cilës është vendosur një shtresë sfungjeri amortizuese. Thembra bashkohet me gjysmë shtrojën nëpërmjet procesit të ngjitjes.

SHTROJA

Është e realizuar me material shumë shtresor të bashkuara ndërmjet tyre me ngjitës.

SHOLLA PREJ GOME

Është monoblok e realizuar prej materiali gome me takë të integruar dhe bashkohet me xhiron rrethuese, shtrojën, nëpërmjet procesit të ngjitjes. Sholla është prej gome dhe është e modeluar me vijëzime jo simetrike për të garantuar funksionin e mos rrëshqitjes.

9. ÇORAPE

Çorapet janë prodhuar me tekstil trikotazh me ngjyrë blu të errët. Nga brenda çorapet të jenë tip peshqir, materiali përbërës i çorapeve nuk lejohet të ketë tonacione ngjyrash e defekte të tjera në pamjen e jashtme;

Çdo palë çorape të jetë e pajisur me një etiketë ku të ketë të shënuar përbërjen dhe numrin e këmbës.



10. KRAVATA

Kravata është realizuar me tekstil 100% poliestër, me ngjyrë blu të errët dhe ka karakteristikat e mëposhtme:

- thurjen sarzh diagonale 100% poliestër;
- filli bazë 100 cm 20/22;
- indi 5 cm;
- indi 20/22;
- në brendësi tekstil lesh diagonal dopio;
- astari.



Gjerësia maksimale pra pjesa e përparme e kravatës është rreth 95 cm, ndërsa gjatësia totale e kravatës (si pjesa përpara e dukshme dhe ajo rreth qafës dhe e poshtme e padukshme) është rreth 138 cm.

- gjatësia e kravatës e matur nga fundi në fillim: 138 cm;
- gjatësia e pjesës së hollë të kravatës është 67 cm;
- gjatësia e pjesës së trashë të kravatës është 71 cm;
- gjerësia e pjesës së hollës është 4 cm dhe vazhdon gjatë gjithë gjatësisë;
- në pjesën e përparme të kravatës qëndiset shenja e flakës me tri kreshpa me distancë 30 cm nga fundi i kravatës që llogaritet pjesa që varet para gjoksit;
- qëndisja bëhet me pe ngjyrë blu si e kravatës;
- flakët brenda qëndisen me ngjyrë të kuqe. Fusha qëndiset me penj ngjyrë të verdhë.

MATERIALET NDIHMËSE QË DUHET TË PËRDOREN PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT “KRAVATË”

- Tekstili: poliestër 100% ngjyrë blu e errët;
- Filli qepës 100 % PES në ngjyrë në tonalitë me tekstilin;
- Stemë “Flakë”, e qëndisur me tri kreshpa.



LIDHJA NR. 2

UNIFORMË E PERSONELIT OPERUES (ZJARRFIKËS) TË STRUKTURAVE TË MZSH-së (SPECIFIKIMET)

Nr.	Artikujt	Sasia	Vite	Ngjyra
1.	Xhup	1	3	Blu e errët
2.	Kostum pune vere, dok	1	1	Blu e errët
	Xhaketë	1	2	Blu e errët
	Pantallona	2	1	Blu e errët
	Kapele	2	2	Blu e errët
	Bluzë me mëngë të gjata pambuku (jaka sportive)	4	1	Blu e errët
	Bluzë me mëngë të shkurtra pambuku	4	2	Blu e errët
3.	Kostum pune dimri	1	1	Blu e errët Blu e errët
	Xhaketë	1	1	Blu e errët
	Pantallona	2	1	Blu e errët
	Kapele	1	2	Blu e errët
4.	Rrip pantallonash	1	1	E zezë
5.	Këpucë verore dhe dimërore	1	1	E zezë
6.	Çorape	5	1	Blu e errët

SPECIFIKIMET

Artikujt e mësipërm për personelin e nivelit bazë (operues), sipas përcaktimeve të mësipërme, kanë këto specifike:

Përmasat do të jenë komfort standardeve, klasifikuar me ndarjet: S, M, L, XL, 2XL.

Ngjyra e uniformës do të jetë sipas përcaktimit në këtë vendim.

XHUP

Xhupi ka shtresë të brendshme, është me ngjyrë blu të errët. Prej pjesës së krahavorit deri te lartësia e gjoksit dhe përmes shpinës, është i përforcuar dhe ka shtresën e brendshme që arrin deri te fundi i mëngës.

Në pjesën e poshtme të xhupit nga të dy anët janë të vendosura dy xhepa të thella me kapakë.

Xhupi është me gjatësinë e duhur e përshtatshme dhe arrin deri mbi gjunjët.

1.XHUP SHËRBIMI ¾ (ME VESHJE TË NGROHTË)**KOSTUM PUNE VERE DOK TRIKOTON (XHAKETA, PANTALLONI, KAPELA)**

Kostum pune vere, materiali duhet të jetë dok, ngjyra blu e errët, e qepur me blu e cila përmban (xhaketë, pantallona dhe kapele).

XHAKETA

Materialet ndihmëse që duhet të përdoren për prodhimin e artikullit “Xhaketë” janë:

- Dok trikoton;
- Penj qepje, blu e errët me ngjyrën e dokut;
- Velkrofe “femër” me ngjyrë blu të errët.

Artikulli xhaketë “Kostum pune vere” prodhohet në bazë të gjatësive trupore dhe porositet nga përdoruesi në sasi të përkatëse sipas numrave të gjokseve, të cilat subjekti prodhues është i detyruar t'i respektojë saktësisht.

Përmasat e duhura të elementeve, të cilat bëjnë pjesë në ndërtimin e artikullit “Kostum pune vere”, janë:

- Xhaketa përbëhet nga jaka, shpina, mëngët, gjokset, dorezat e mëngëve, bordura përpara, xhepat e poshtëm anash, sipër në gjoksin e majtë vendoset velkrof “femër” në formë drejtkëndëshi me ngjyrë të zezë, bordura e poshtme dhe astari i brendshëm, shirita fosforeshente te krahu i majtë e i djathtë, shirit fosforeshent te gjoksi sipër dhe shiriti fosforeshent është te pjesa fundore e xhupit.

- Gjoksi i majtë dhe i djathtë përpara ka një shirit fosforeshent në ngjyrë gri metalizato me përmasa 6 cm të gjerë, të cilës në të dy anët gjatë gjithë gjatësisë i kalohen tegelat e zbuturimit 5 mm larg buzëve. Në anën e majtë të krahavorit vendoset xhepi i krahavorit për radio 15x3 cm. Sipër xhepit të radios vendoset velkrof në ngjyrë blu për vendosjen e shenjës së emrit.

- Shpina mbrapa në pjesën e sipërme do të vendoset një shirit me përmasa në lartësi 15 cm, dhe gjerësi sa ajo ndërmjet gavatave. Ngjyra e shiritit do të jetë gri metalizato, mbi të cilën do të shkruhet me shkronja shtypi “ZJARRFIKËS”. Shkrimi do të jetë ngjyrë blu e errët.

PANTALLONAT

Pantallonat janë me ngjyrë blu të errët, me prerje të gjerë, me përbërje të njëjtë si xhaketa;

Në pjesën e sipërme, në anën e majtë dhe të djathtë, kanë nga një xhep me prerje të pjerrtë;

Në anën e majtë dhe në anën e djathtë, në lartësinë mbi gjunjë, janë të qepur dy xhepa në formë harmonike me kapakë, të cilët mbërthehen me ngjitëse.

BLUZË ME MËNGË TË GJATA

Bluza me mëngë të gjata duhet të jetë pambuk, ngjyrë blu e errët, e qepur me pe blu të errët.

Materialet ndihmëse që duhet të përdoren për prodhimin e artikullit “Bluzë me mëngë të gjata” janë:

- Pambuk ngjyrë blu e errët;
- Penj qepje me ngjyrën blu të errët;
- Bluza përbëhet nga jaka e rrumbullakët, mëngët e gjata. Në gjoksin e anës së majtë vendosen velkrofet “femër” në ngjyrë blu të errët, për fiksimin e stemës “MZSH”;
- Jaka e bluzës ka formë të mbyllur të rrumbullakët. Jaka përbëhet nga një shirit i përforcuar;
- Shpina e bluzës është e drejtë në të gjithë sipërfaqen. Shpina në fund mbyllet me tegel 3–5 mm larg buzëve duke e palosur dy herë copën;
- Mëngët e gjata përbëhen nga pjesa kryesore e mëngës dhe pjesa e bordurës me gjerësi 3,5 cm.

BLUZA ME MËNGË TË SHKURTRA

- Bluza me mëngë të shkurta është me ngjyrë blu të errët, me mëngë të shkurta dhe e përbërë prej materialit 100 % të pambukut.

- Në pjesën e përparme në anë të majtë në lartësinë e gjoksit është qepur logo me shkronjat kapitale “MZSH”.

**KAPELA**

- Kapela duhet të jetë dok, blu e errët, e qepur me pe blu të errët;

- Materialet ndihmëse që duhen të përdoren për prodhimin e artikullit “kapelë” janë:

- dok, blu e errët;
- penj qepje, me ngjyrën e dokut;
- stema e kapelës.

RRIP PANTALLONASH

Rripi për pantallona është i punuar prej lëkurës së zezë, të gjerësisë 3 cm dhe me togës metalike.

KËPUCË VERORE DHE DIMËRORE

Këpucët janë të punuara prej lëkure me rezistencë në lagështi, dhe me trashësi prej 1,8–2,0 mm dhe përbëhet prej pjesës së përparme, pjesës së prapme, qafës, me gjuhëz të mbyllur të cilët janë të përbëra nga dy shtresa të stepit, pjesës së poshtme dhe gjonit.

Pjesa e përparme është e punuar prej shtresës së lëkurës me shtresë të përforcuar termo.

Qafa, përkatësisht pjesa e përparme e këpucës është e punuar me astarë të lëkurës.

Në lartësinë prej 5 cm nga pjesa e poshtme e këpucës janë të përforcuar skajet nga nyja me lëkurë të fortë ose me material tjetër ndërmjet astarit dhe fytyrës, ndërsa pjesa e sipërme e qafës, rreth nyjës në tërësi ndërmjet fytyrës dhe astarit me përforcues.

Shtresa e tabanit është formë anatomike.

**ÇORAPE PAMBUKU**

Çorapet e pambukut janë të punuara me përbërje 60 % pambuk dhe 40% akrilik në ngjyrë blu të errët. Nga brenda çorapet të jenë tip peshqir, materiali përbërës i çorapeve nuk lejohet të ketë tonacione ngjyrash e defekte të tjera në pamjen e jashtme. Çdo palë çorape të jetë e pajisur me një etiketë ku të ketë të shënuar përbërjen dhe numrin e këmbës.



LIDHJA NR. 3

UNIFORMA ZJARRDURUESE E PERSONELIT OPERUES (ZJARRFIKËS)

Nr.	Artikulli	Sasia	Ngjyra
1.	Helmeta zjarrduruese	1	E kuqe, e verdhë
2.	Kapuç mbrojtës poshtë helmetës	1	Blu e errët
3.	Uniforma zjarrduruese Xhakëtë zjarrduruese Pantallona zjarrduruese Çizme zjarrduruese Doreza zjarrduruese	1	Blu e errët

SPECIFIKIMET

HELMETA PËR ZJARRFIKËS & SISTEMI PËR NDRIÇIM

Helmeta për përdorim nga zjarrfikësit për mbrojtje kundër zjarrit e gjatë ndërhyrjeve operuese duhet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare EN 443:2008 dhe EN 14458.

Helmeta duhet të jetë e llojit A3B,**, E2C.

Helmeta duhet të jetë e pajisur me një xham transparent me ngjyrë lumineshence (nuanca të buta ngjyrë portokalli), të punuara nga materiali PESU (*polyethersulfone*), për të rezistuar në temperatura të ngritura.

Në pjesën e brendshme duhet të jetë e pajisur me syza, sipas EN 166.

Rezistenca ndaj ndikimeve të jashtme

Helmeta duhet të jetë e pajisur me një amortizues të punuar nga poliuretani, i cili duhet të jetë i integruar në gëzhhojën e helmetës e që nuk mund të hiqet.

Në mes të gëzhhojës, e cila duhet të jetë e punuar nga materiale kompozite (fibra karboni), dhe poliuretanit (e integruar në poliuretan) duhet të jetë e integruar një gëzhhojë e dytë dhe një shkumë izoluese.



Për zjarrfikësin operues



Për drejtuesin/komandantin e zjarrfikësit

Pjesa e brendshme e helmetës

- Duhet të jetë e punuar nga materiale kompozite SMC (nuk lejohen pjesë plastike për përforcime).
- Për t'iu përshtatur kokës, rregullimi i madhësisë së helmetës duhet të bëhet përmes një rregullatori i cili duhet të realizojë ndryshimin e madhësisë nga 52–64 cm.
- Gjerësia e jashtme e helmetës duhet të jetë në mes 236 mm–247 mm në zonën e veshëve, gjatësia nuk duhet të tejkalojë 316 mm dhe lartësia nuk duhet të tejkalojë 216 mm.
- Helmeta duhet të jetë ngjyrosur me ngjyrë lumineshence.
- Të dyja anët e helmetës duhet të pajisen me nga një shirit reflektues që shtrihen pothuajse përgjatë gjithë helmetës.
- Gjerësia e shiritit duhet të jetë në mes 24 mm–25 mm.
- Helmeta duhet të jetë e pajisur me një mbrojtës qafe të punuar prej fibrave karbonike dhe të trajtuara me alumin.
- Mbrojtësi duhet të lidhet me helmetën, përmes 3 pikave dhe duhet të jetë i lehtë për t'u hequr dhe instaluar.
- Helmeta duhet të mundësojë përdorimin e papenguar të maskës së aparatit të frymëmarrjes.
- Pesha totale së bashku me mbrojtësin e qafës nuk duhet të jetë më e madhe se 1,4 kg.
- Në pjesën ballore të helmetës duhet të jetë përcaktuar vendi për logo. Madhësia e vendit për logo duhet të jetë e gjerë rreth 65 mm–80 mm, kurse lartësia nga 65 mm–75 mm.

- Logoja e përdoruesit të fundit duhet të jetë e shtypur fabrikisht në anën e përparme të helmetës. Nuk lejohet ngjitja e etiketave të plastikës (*stickers*).
- Helmeta duhet të jetë rezistente në temperaturë deri në 1000°C për një periudhë kohore prej së paku prej 10 sec, në kontakt me fenomenin “Flash over”, si dhe i testuar në temperaturë 250°C në një kohëzgjatje prej 30 min.
- Helmeta duhet të ofrojë mbrojtje të plotë të kokës, duke përfshirë edhe qafën dhe fytyrën.
- Rripi i mjekrës duhet të jetë nga materiali nomex dhe i testuar për të mos shkaktuar irritime (alergji).
- Helmeta duhet të jetë e pajisur me llambë ndriçuese xenon dhe mbajtës përkatës, si dhe të mundësojë vendosjen e sistemit të komunikimit.

KAPUÇI MBROJTËS PËR ZJARRFIKËSIN

Kapuçi mbrojtës duhet të jetë i certifikuar në harmoni me standardet EN13911:2005 & EN 1149-3.

- Struktura/përbërja;
- Strukturë/ndërtim dyshtresor;
- Materiali 100% Aramid;
- Ngjyra: blu e errët.



Madhësia duhet të jetë universale, kapuç me shtresë dopio, shtresë teke që vjen përpara si grykashkë, me një rreth të hapur rreth fytyrës me fund të rrafshët dhe strukturë tegelash, me qepje me fill nomex. Të gjitha të jenë një masë.

Nënkapela duhet të mundësojë vendosjen e papenguar të maskës. Nënkapela duhet të mbulojë në pjesë të madhe gjoksin, supet dhe shpinën.

UNIFORMA MBROJTËSE NGA ZJARRI (XHAKETA & PANTALLONAT)

Xhaketa dhe pantallonat për mbrojtje nga zjarri, duhet të jenë të punuara dhe të certifikuar në përputhje me standardin EN 469:2005, niveli 2 i mbrojtjes.

Përveç kësaj, xhaketa për mbrojtje nga zjarri duhet të plotësojë edhe standardin EN 469:2005, shtojca B.

Prodhuesit ose subjekti që i trajton këto produkte është i detyruar të paraqesë certifikatat e vlefshme të produktit.

Në xhaketë, mbrapa, në pjesën e sipërme, do të vendoset një shirit me përmasa në lartësi 15 cm, dhe gjerësi sa ajo ndërmjet gavaturave. Ngjyra e shiritit do të jetë gri metalizato, mbi të cilën do të shkruhet me shkronja shtypi kapitale “MZSH”. Shkrimi do të jetë ngjyrë blu e errët. Përmasat e shkrimit do të jenë në lartësi 10 cm dhe gjerësi shkronje 1.8 cm, në përpjesëtim me masat trupore të uniformave;

Në pjesën e përparme të xhaketës duhet të jenë të qepura horizontalisht në pjesën e gjoksit. Një xhep për vendosjen e radiomarrësit duhet të vendoset në pjesën e përparme, afërsisht rreth 2 cm majtas nga shiriti i përparmë;

Rreth 9 cm mbi xhepin e radiolidhjes, duhet të jetë i vendosur një shirit me dimension 7.5x3 cm i cili do të shërbejë si mbajtës i mikrofonit dhe duhet të jetë nga materiali i sipërm;

Përveç kësaj, në anën e djathtë të pjesës së përparme nën tegelin e qepjes horizontale, duhet të jetë i vendosur mbajtësi i llambës ndriçuese;





- Dimensionet e përafërta të xhepit duhet të jenë 5.5 cm thellësi, gjerësia 8.5 cm dhe lartësia rreth 19 cm. Xhepi në pjesën e sipërme dhe të poshtme është i hapur. Në pjesën e sipërme është i fiksuar me ndihmën e një shiriti me dimension 5.5x11 cm, me shirit velcro.

Pjesa e pasme (shpina)

Pjesa e shpinës duhet të jetë e ndarë horizontalisht në dy seksione.

Mbishkrimet në shpinë duhet të jenë në një ose dy rreshta ku madhësia e shkronjave duhet të jetë rreth 6 cm. Ngjyra e sfondit duhet të jetë e verdhë flourishente, kurse e shkronjave e argjendtë:

Në shirit duhet të shkruhet “MZSH” apo ndonjë mbishkrim tjetër sipas marrëveshjes;

Ngjitja e mbishkrimit në shpinë duhet të bëhet me velcro ose e përhershme;

Xhakëtë e gjatë, minimumi i gjatësisë së xhakëtës do të jetë 92 cm.

Xhepat anësore

Xhepat anësore duhet të jenë të futur brenda dhe të mbuluar me kapakë (me dimension afërsisht 22x7,5 cm). Të dy kapakët në pjesën e poshtme duhet të mbyllën me shirit velcro. Një shirit me një karabinë me kokë rrotulluese duhet të jetë e vendosur në kapakun e xhepit (madhësia rreth 7,5 cm).

Xhaketa duhet të jetë në tërësi e pajisur me astar të përhershëm rezistent ndaj zjarrit. Astarin nuk duhet të jetë i fiksuar në asnjë pikë me tegelat e qepjes.

Në pjesën e përparme, në anën e djathtë të astarit duhet të jetë i vendosur një xhep nga materiali i sipërm (i jashtëm) me përmasa afërsisht 18x2 cm, me kapak i cili mbyllet me shirit velcro me përmasa 2x2 cm. Një hapje për riparim duhet të ndodhet në pjesën e shpinës me gjerësi rreth 54 cm, kurse hapja tjetër në anën e djathtë me gjerësi rreth 28 cm.

Përshkrimi i detajuar në skicë

Duhet të jetë rezistente në temperatura të larta sipas EN 469;

Penjtë të jenë prej materiali kundër lagështisë dhe rezistente ndaj zjarrit;

Gavaturre të gjerë të mëngëve, për veprime të rehatshme;

Me zinxhir të tipit të qëndrueshëm dhe rezistent ndaj zjarrit dhe i mbuluar me kapak;

Jaka dhe bërrylat të jenë me përforcues;

Të ketë xhep të kraharorit për radio, me kapak mbrojtës, si dhe dy xhepa anësorë me kapak.

MATERIALET

Përbërja e materialeve të shtresës së jashtme

Pesha e materialit të shtresës së jashtme duhet të jetë afro 195g/m², që përbën përzierje të fijeve aramidi 100% (me një përmbajtje prej se paku 23 % paraaramid dhe 2% fije karboni ngjyrë blu të errët e ngjashme me RAL 5004) ose ekuivalente.

Ngjyra: blu e errët.

Materiali për pengimin e depërtimit të fluideve.

Duhet të jetë membranë mikroporoze PTFE, me shtresa fine të polimereve të një performace të lartë në materialin bartës me përbërje 50% aramid dhe 50 % melamin të mbyllur, shkumëzime silikon për mbajtje distance ose ekuivalente.

Saldimi i qepjeve me shirit dyshtresor.

Materiali bartës për saldimin e qepjeve duhet të jetë membranë mikroporze dykomponentëshe nga politetrafluoretileni i ekspanduar.

Testimi i papërshkueshmërisë në mbikalime të qepjeve duhet të bëhet pas 10 trajtimeve (larjeve në temp. 60 °C në harmoni me standardin EN 26330/2A dhe 10 cikleve të pastrimit kimik në harmoni me standardin DIN EN ISO 3175:2000 mm, në kohëzgjatje prej 2 min dhe presion 0,2 bar).

Astari (angl.: *Lining*):

Nomex 50%/viskoze FR 50%, 110 g/m²

Pengesat absorbuese (angl.: *Absorption barriers*)

Duhet të jenë nga një membranë ajrosëse (angl.: *breathable*) PTFE, e mbështjellë në të dyja anët nga aramid i petëzuar, i qëndrueshëm në larje dhe pastrim kimik.

Mbrojtëset (mbushjet ose jastëkët mbrojtës):

Mbushjet mbrojtëse mbi supe shërbejnë si amortizues dhe duhet të jenë të punuara nga materiale përherë të qëndrueshme në flakë, nga plastike joabsorbues që nuk thithin lagështi gjatë gjithë jetës së tyre dhe të jenë të lehta sa më shumë që është e mundur.

Duhet të jenë të testuar sipas standardit EN 532 dhe pas testimit nuk duhet të ketë formim vrimesh, nuk duhet të ketë ndezje ose pika të shkrirjes, nuk duhet të ketë ndezje në krye apo në skajet. Rezistenca termike sipas EN 469; shtojca A: pa shkrirje, pa pikim apo ndezje.

Aksesorë të tjerë

Zinxhirët për mbyllje (*Zippers*)

Xhaketa: Zinxhiri i xhaketës duhet të jetë i pajisur me patentë paniku, si dhe dhëmbë metalik me madhësi prej 8mm.

Shiritat velcro për mbërthyerje (mbyllje)

Shiritat velcro duhet të jenë të rezistueshëm ndaj zjarrit, në larje dhe pastrim kimik.

Penjtë për qepje

Duhet të jenë rezistente ndaj flakës, 100% nga materiali meta aramid për të gjitha qepjet, kurse ngjyra duhet të jetë identike me ngjyrën e materialit të jashtëm.

Shiritat reflektues


Shiritat reflektues duhet të jenë një kombinim i ngjyrave verdhë/argjend/verdhë, kurse vetitë e tyre duhet të plotësojnë kërkesat e HuPF 09/99, pika 2.6, 2.5.1.1 dhe 2.6.1.2.

Jaka

Jaka, në pjesën e shpinës duhet të jetë e lartë afërsisht rreth 12 cm, kurse rreth 10 cm në pjesën e përparme. Mbyllja e jakës bëhet me ndihmën e shiritave (copëzave) nga materiali velcro të cilat janë të vendosura nën kapakët frontal për mbulimin e zinxhirit. Gjerësia e jakës duhet të rregullohet me ndihmën e një shiriti. Shiriti duhet të jetë i punuar nga materiali sikurse shtresa e jashtme e xhaketës, kurse në buzën e sipërme të brendshme të jakës duhet po ashtu të jetë i qepur një shirit që shërben për varjen e xhaketës.

Mëngët

Në mëngë duhet të jenë të qepura mansheta me gjerësi rreth 12 cm. Manshetat duhet të jenë të pajisura me struktura të papërshkueshme nga uji, në të cilat pjesa e brendshme e manshetës nga kyçi i dorës duhet të jetë nga një material i thurur dhe ndodhen brenda mëngës. Duhet të sigurohet pengimi i penetrimit të lagështisë në astarin e brendshëm, i cili duhet të bëhet përmes një inkorporimi funksional të pengesave të lagështisë, të punuara nga materiali sikur shtresa e jashtme e xhaketës.



Mansheta e brendshme nga materiali i thurur, duhet të jetë dyshtresor dhe ketë një hapje të rrumbullakët për vendosjen e gishtit të madh. Materiali i thurur duhet të jetë i punuar në atë mënyrë që të pengojë daljen e fijeve (shthurjen).

Gjatësia përfundimtare duhet të jetë përafërsisht rreth 18 cm, kurse diametri i përafërt rreth 6,5 cm. Materiali i përdorur duhet të jetë nga aramidi kualitativ (93% meta aramid, 5% para aramid, 2% fibra karboni ose të ngjashme). Ngjyra duhet të jetë blu e errët.

Pantallonat

Duhet të jenë të certifikuara në harmoni me standardet EN 469.

Pantallonat e mbrojtjes nga zjarri duhet të jenë me shtrat të lartë, penjtë të jenë prej materiali kundër lagështisë dhe rezistente ndaj zjarrit dhe qemerit të jetë i përshkruar nga brenda me llastik, i përshtatshëm të qëndrojnë mirë në bel.

Pantallonat në pjesën e përparme përfundojnë me një brez të gjerë rreth 6 cm, i cila në pjesën e pasme shkon duke u zgjeruar deri në 12 cm për të mbrojtur veshkat.

Brezi duhet të jetë i punuar në të dy anët nga materiali i sipërm (i jashtëm). Të dyja anët duhet të jenë të pajisura me shirita elastikë, 4 cm të gjerë dhe 12 cm të gjatë. Në pjesën e përparme të brezit, djathtas dhe majtas palëve, duhet të jetë i qepur nga një shirit (qepja duhet të bëhet në formë zarfi).

Në skajin e majtë të palës së brezit duhet të jetë i vendosur një shirit me një kopsë që shërben si zgjatje dhe përforsim shtese. Dy shirita me mbërthim velcro janë qepur në mesin e brezit në një distancë prej përafërsisht 7 cm, të qepura në formë zarfi. Mekanizmat për mbërthim (“katramat”) të gjera 5 cm, janë të fiksuara me kapëse plastike në shiritat e përparmë dhe të pasmë. Mekanizmat për mbërthim mbahen së bashku në anën e pasme me ndihmën e një kapëseje.

XHEPAT

Xhepat anësor


Pantallonat duhet të pajisen me xhepa (“të fryra”), majtas dhe djathtas mbi nivelin e gjurit. Xhepat janë të drejtë, thellësia e të cilëve arrin rreth 5 cm dhe mbyllen me kapakë me dimensione 6x18 cm dhe mbyllje velcro. Në xhepin e djathtë duhet të jetë shtesë e integruar edhe një xhep për thikë. Në të dy anët e pantallonave, xhepat duhet të jenë të pajisur me fileto në formë shiriti.

Pantallonat gjithashtu në pjesën e sipërme duhet të jenë të pajisur me xhepa.

Këmbët e pantallonave

Pjesa e përparme, e poshtme, e pantallonave, në zonën e gjunjëve duhet të jetë e pajisur me përforsime nga materiali me përbërje silikon/karbon.

Nën këtë material të përforsuar duhet të vendosen “jastëkë” të cilët duhet të kenë formë ergonomike dhe të jenë punuar nga material rezistent në flakë, jo thithës dhe të papërshkueshëm nga uji. Formësimi i jastëkut duhet të jetë në formë ergonomike dhe të mundësojë lëvizje të lehtë dhe të papenguar në të gjitha drejtimet. Diametri afërsisht 14 cm të larta, 22 cm të gjera dhe trashësia rreth 1 cm.



Shiritat reflektues (fosforeshent)

Pantallonat duhet të jenë të pajisura me nga një shirit të vazhdueshëm fosforeshent me gjerësi rreth 7,5 cm të cilët duhet të vendosen horizontalisht nën përforsimin e pjesës së gjurit dhe me nga një shirit të trefishtë reflektues me gjerësi 5 cm, të cilët vendosen anash këmbëve duke filluar nga buza e sipërme e shiritit horizontal që përfundon në pjesën e poshtme të xhepave anësorë.

Rripat mbajtës të pantallonave

Rripat e pantallonave duhet të jenë të prodhuara nga material gomë elastike e gjerë. Mbërthimi i pantallonave duhet të bëhet përmes mbërthyesve të posaçme nga një plastike rezistente në temperatura.

ÇIZMET MBROJTËSE NGA ZJARRI

Duhet të jenë të certifikuara sipas standardeve EN ISO 15090:2012 F2A HI3 P T CI AN SRC EN ISO.

Çizmet duhet të jenë të prodhuara nga materiali lëkurë e zezë me kualitet të lartë, si dhe duhet të jenë të pajisura me veqe anash për veshje më të lehtë dhe të shpejtë.

Në mes të astarit dhe të lëkurës së jashtme çizmet duhet të jenë të pajisura me një membranë të papërshkueshme nga uji dhe rezistente në flakë.

Të jenë të pajisur me shirit reflektues.

Çizmet duhet të jenë rezistente ndaj ujit, nxehtësisë, vajrave, derivateve, si dhe të jenë antistatike.



DOREZAT PËR MBROJTJE NGA ZJARRI

Duhet të jenë të certifikuara në harmoni me standardet: EN 659:2003.

Struktura/përbërja:

Strukturë e papërshkueshme nga uji–liner, (angl: “*liner construction*”)

Duhet të jenë absolutisht të papërshkueshëm nga uji dhe të kenë aktivitet të lartë të ajrosjes të cilën duhet t’ia ofrojë membrana;

Duhet të jenë të punuara nga materiale të teknologjisë së lartë;

Mbrojtje ekstreme nga konsumimi në pjesën e brendshme të dorës;

Të garantojë mbrojtje nga të nxehtëti dhe të ftohtëti;

Pjesa e pasme e dorës të duhet të jetë e punuar në mënyrë të veçantë që të lejojë punë optimale pa tension;

Duhet të ketë izolim të dyfishtë në zonën e ekspozuar sidomos pjesën e pasme të dorës;

Mbrojtje shtesë të gishtave nga materiali kevlar të përforsuar me materiale shtesë.



LIDHJA NR. 4

FLAMURI

Pjesa valëvitëse e flamurit

Drejtëndësh me përmasa me raport 1:1,4, ngjyrë e bardhë, me stemën e shërbimit të vendosur në mes.



STEMA E SHËRBIMIT “MZSH”: Stema e shërbimit të MZSH-së, vendoset në krahun e majtë të uniformës



Specifikimet e stemës së MZSH-së: Paraqitet me një shqiponjë të zezë në pjesën e sipërme, hidrant në pjesën e djathtë, në qendër paraqet imazhin e flakës, simboli i shkallëve dhe sëpatës, në pjesën poshtë me shkronja kapitale “MZSH”, me ngjyrë të verdhë, në të majtë imazhin e shpëtimit.

SHENJAT DALLUESE

PËRCAKTIMI I MBIEMRIT: vendoset në pjesën e majtë të përparme të uniformës.



SHENJA NË KAPELE: Kjo stemë vendoset në pjesën ballore të kapelës.



LOGO E BASHKISË PËRKATËSE.

SHENJA CEREMONIALE: të cilat vendosen në krahun e majtë të uniformës në raste ceremonish të ndryshme.



Niveli madhor



Niveli lartë



Niveli mesëm



Doreza të bardha për raste ceremonie

**VENDIM****Nr. 1155, datë 24.12.2020****PËR KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE, TË NUMRIT THELBËSOR DHE TË KËRKESËS SË MJAFTUESHME TË PERSONAVE TË PAKICAVE KOMBËTARE PËR T’U ARSIMUAR NË GJUHËN E PAKICËS KOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personat që i përkasin një pakice kombëtare kanë të drejtë të arsimohen në gjuhën e pakicës kombëtare në institucione arsimore të caktuara me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

2. Në institucionet arsimore ekzistuese, ku gjuha e arsimit është gjuha shqipe, nxënësit e një pakice kombëtare kanë të drejtë të arsimohen në gjuhën e pakicës kombëtare që i përkasin, si dhe të studiojnë historinë, traditat dhe kulturën e tyre, sipas kurrikulave e programeve të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, numri thelbësor dhe kërkesa me qëllim sigurimin e së drejtës për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare përcaktohen në bazë të kriterëve të mëposhtme:

a) numri i personave që i përkasin pakicës kombëtare, i cili duhet të jetë jo më pak se 20 (njëzet) për qind e numrit të përgjithshëm të banorëve të njësisë administrative, si nënndarje e bashkisë;

b) periudha e regjistrimit si banor në njësinë e vetëqeverisjes vendore, sipas periudhave të regjistrimit të popullsisë, konfirmuar me vërtetim të lëshuar sipas të dhënave nga regjistrat themeltarë të gjendjes civile dhe/ose Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010;

c) kërkesa shkresore, paraqitur nga prindër apo kujdestarë të fëmijëve që i përkasin pakicës kombëtare, pranë bashkisë/njësisë administrative,

ku shprehet vullneti në mënyrë shkresore dhe bazuar në të drejtën e vetidentifikimit për formimin e klasës.

4. Numri i nxënësve që u përkasin pakicave kombëtare, që kanë të drejtën të arsimohen në gjuhën e pakicës kombëtare së cilës i përkasin, si dhe të studiojnë historinë, traditat dhe kulturën e tyre, duhet të jetë jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) nxënës për klasë, në bazë të kërkesës shkresore nga prindërit apo kujdestarët, sipas përcaktimit në shkronjën “c”, të pikës 3, të këtij vendimi.

5. Administrimi i informacionit për verifikimin e plotësimit të kriterëve të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, bëhet nga prefekti i qarkut. Pas verifikimit të përmbushjes së kriterëve, prefekti përcakton njësitë e vetëqeverisjes vendore, në të cilat personave që i përkasin një pakice kombëtare do t’u sigurohet e drejta të arsimohen në gjuhën e pakicës kombëtare.

6. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat janë përcaktuar sipas pikës 5, të këtij vendimi, kanë të drejtën e nismës për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare, në përputhje me parashikimet ligjore për krijimin e funksionimin e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Brendshme, prefekti i qarkut dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Erion Braçe****VENDIM****Nr. 1163, datë 24.12.2020****PËR NGRITJEN E SEKRETARIATIT NË KUADËR TË VEPRIMTARISË SË MBAJTJES SË SEKRETARIATIT TË “BOLOGNA FOLLOW UP GROUP” NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Ngritjen e sekretariatit në kuadër të veprimtarisë së mbajtjes së sekretariatit të “Bologna Follow Up Group” nga Republika e Shqipërisë (në vijim, Sekretariati), në varësi të ministrit përgjegjës për arsimin.

2. Sekretariati do të funksionojë për periudhën kohore nga data 1.1.2021 deri më 31.12.2024.

3. Ministria përgjegjëse për arsimin siguron mjediset dhe pajisjet e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë për funksionimin e Sekretariatit.

4. Qëllimi parësor i veprimtarisë së Sekretariatit është të sigurojë mbështetjen asnjansë për konsolidimin e mëtejshëm të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (në vijim, ZEAL) nën autoritetin e “Bologna Follow Up Group” (në vijim, BFUG) e të koordinojë veprimet që ndërmerren në rang ndërkombëtar me planin e punës së BFUG-së dhe veprimtarinë e grupit të punës mbështetës të Sekretariatit të BFUG-së gjatë periudhës së mbajtjes së Sekretariatit nga Republika e Shqipërisë.

5. Sekretariati ka për objekt veprimtarie:

a) ofrimin e mbështetjes administrative dhe operative për BFUG-në e bordin e saj, përfshirë planifikimin e takimeve dhe mbajtjen e procesverbaleve përkatëse;

b) ofrimin e ndihmës për BFUG-në dhe bordin e saj në punën pasuese për periudhën 1.1.2021 deri më 31.12.2024, përfshirë planifikimin e aktiviteteve dhe përcjelljen/ndjekjen e vendimeve të BFUG-së;

c) ofrimin e mbështetjes ndaj të gjitha grupeve të punës, grupeve këshilluese e strukturave të tjera dhe, sipas kërkesës, përgatitjen e projektraporteve;

ç) kryerjen edhe të detyrave të veçanta lidhur me zbatimin e programit të punës së ZEAL-së;

d) rishikimin e përditësimit të faqes në internet të ZEAL-së www.ehea.info dhe arkivat e saj;

dh) funksionimin si një pikë e jashtme dhe e brendshme e kontaktit për ZEAL-në;

e) shpërndarjen e njoftimeve të rëndësishme me anëtarë të BFUG-së dhe palët e interesit;

ë) sigurimin e përfaqësimit në takimet e jashtme me kërkesë të organizatorëve;

f) mbështetjen e bordit të BFUG-së për të vendosur bashkëveprim me Zonën Evropiane të Kërkimit (në vijim, ZEK);

g) përgatitjen e Konferencës Ministrore në Shqipëri 2024 dhe Forumin e Politikave të Bolonjës nën mbikëqyrjen e BFUG-së;

gj) kryerjen e çdo veprimtarie tjetër të nevojshme, të caktuar nga BFUG-ja.

6. Sekretariati drejtohet nga kryetari (chair), i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e Sekretariatit. Kryetari asistohet në punën e tij nga një asistent.

7. Sekretariati do të përbëhet nga personel i punësuar me kohë të plotë, ekspertë, dhe personel i punësuar me kohë të pjesshme, ekspertë, që janë njohës shumë të mirë në fushën e arsimit të lartë, si më poshtë vijon:

a) 1 (një) ekspert me kohë të plotë dhe 3 (tre) ekspertë të jashtëm me kohë të pjesshme, në fushën e menaxhimit dhe të implementimit të projekteve, të cilët angazhohen në zhvillimin e aktiviteteve dhe takimeve të ndryshme të BFUG-së, bordit të BFUG-së, grupeve të punës dhe grupeve këshilluese të BFUG-së, si edhe në organizimin e Konferencës Ministrore të ZEAL-së, në vitin 2024;

b) 1 (një) ekspert me kohë të plotë në fushën e medias dhe komunikacionit, i cili do të ndihmojë në zbatimin e strategjisë dhe instrumenteve të mediave sociale, dhe 1 (një) ekspert i jashtëm me kohë të pjesshme në fushën e mirëmbajtjes së faqes ekzistuese të internetit www.ehea.info dhe përditësimit të saj nga grupi i punës mbështetës i Sekretariatit të BFUG-së;

c) 2 (dy) ekspertë teknikë të nivelit të lartë me kohë të plotë dhe 3 (tre) ekspertë të jashtëm me kohë të pjesshme për marrjen e vendimeve strategjike e udhëzimeve për të zbatuar të gjitha aktivitetet e Sekretariatit;

ç) 2 (dy) ekspertë me kohë të plotë dhe 3 (tre) ekspertë të jashtëm me kohë të pjesshme, të cilët do të ndihmojnë në hartimin e përgatitjen e dokumenteve mbështetëse për BFUG-në, menaxhimin e proceseve teknike dhe institucionale, analizimin e të dhënave e dhënien e rekomandimeve dhe të asistencës në takimet e grupeve të punës.

8. Ekspertët e jashtëm, vendas ose të huaj, do të kontraktohen sipas fushës përkatëse, për të dhënë kontributin e tyre, sa herë të konsiderohet e nevojshme, me qëllim bashkërendimin e punës.



9. Sekretariati, në bashkëpunim me bashkëkryetarin dhe nënkryetarin e BFUG-së, kryen këto detyra:

a) harton agjendat e takimeve të BFUG-së;

b) harton përmbajtjen e dokumenteve për diskutim;

c) harton dokumentet përkatëse për BFUG-në dhe bordin e tij, grupet e punës dhe takimet e komisionit të bordit;

ç) harton procesverbalet e mbledhjeve të BFUG-së dhe bordit, për të qartësuar fjalën e kryetarëve;

d) dërgon për komente dhe miratim procesverbalet në takimin pasues të BFUG-së dhe bordit;

dh) ndihmon grupet e punës dhe grupet këshilluese për përmbushjen e detyrave të tyre;

e) mbështet zbatimin e programit të punës të miratuar nga BFUG-ja;

ë) merr pjesë në seminare që zhvillohen në kuadër të procesit të Bolonjës dhe takime të tjera, kur është e nevojshme;

f) rishikon e përditëson faqen e internetit të ZEAL-së, duke siguruar që informacioni të vihet në dispozicion në çdo kohë për BFUG-në dhe publikun;

g) garanton një sistem komunikimi ad hoc, duke përdorur mjete të përditësuara teknologjike dhe propozon një faqe të re website, në mënyrë që të ofrojë një shërbim më efikas;

gj) kryen detyra të tjera specifike, siç është rënë dakord nga nënstrukturat e përmendura në BFUG.

10. Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Sekretariatit miratohet nga ministri përgjegjës për arsimin, me propozimin e kryetarit të Sekretariatit.

11. Kryetari dhe personeli i Sekretariatit emërohen e lirohen nga detyra nga ministri përgjegjës për arsimin, në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës, nëpërmjet thirrjeve për shprehje interesi.

12. Niveli i pagës së kryetarit dhe personelit të Sekretariatit t'u referohet pagave të personelit në institucionet publike të arsimit të lartë, të përcaktuara me vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë", të ndryshuar, si më poshtë vijon:

a) Kryetari i Sekretariatit, sa paga e personelit akademik "Rektor";

b) Ekspertët e nivelit të lartë dhe/ose të huaj, të punësuar me kohë të plotë dhe ose të pjesshme, sa paga e personelit akademik të kategorisë "Profesor";

c) Ekspertët e punësuar me kohë të plotë, sa paga e personelit akademik që zotëron gradën shkencore "Doktor";

ç) Ekspertët e punësuar me kohë të pjesshme, sa paga e personelit akademik "Lektor/kërkues".

Niveli i pagës së asistentit të kryetarit të Sekretariatit është sa paga e sekretarit të rektorit, të përcaktuar në vendimin nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore", të ndryshuar.

13. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, mbulohen nga granti i Komisionit Evropian, buxheti i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ardhura të tjera nga financime të ngjashme.

14. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 1164, datë 30.12.2020

**PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË
MJEKIMIT TË FËMIJËS EDNA ZEINATI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 42, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të fëmijës Edna Zeinati, në masën 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 13, datë 20.1.2021

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Eugena Tomini emërohet zëvendës-ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

VENDIM

Nr. 14, datë 20.1.2021

PËR TRANSFERIMIN, NË PRONËSI TË BASHKISË VAU-DEJËS, TË NJËSISË ADMINISTRATIVE VAU I DEJËS, TË PASURISË 125/35, ZONA KADASTRALE 2015

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin, në pronësi të Bashkisë Vau-Dejës, të njësisë administrative Vau i Dejës, të pasurisë 125/35, zona kadastrale 2015, sipas formularit, gjithsej, 1 (një) fletë, dhe planrilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, me qëllim për t’u përdorur në fushën e bujqësisë.

2. Pasuria e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 1423, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vau i Dejës, të qarkut të Shkodrës”.

3. Ngarkohen Bashkia Vau i Dejës dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe



Bashkia: Vau Dejës

Identifikoi: Esmeraldo Harapi (ing.) Ndue Paloka (p.sek. Asetë dhe Privatizime)

(emri mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: Ana Shurdha (Drejtör Planifikimi Urban)

(emri mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Mark Babani (Kryetari i Bashkise)

Fusha e plotë të përdorimit të pronës

(emri mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma)



Nr: rend.	A Zona kadastrale indeksi i hartës	3 Nr. i pasurisë	4 Emertesa e prones, vendodhja	5 Komponent perberes te prones	6 Adresa, vendodhja	7 Permasat e Prones	8 Funksioni për të cilën përdoret prona	9 Institucioni me përgjegjësi administrative	10 Institucioni/enti Përdorues, statusi juridik i përdorimit	11 Veçanta
1		2								
925	2015 K-34-76 (20-B)	125/35	Tok bujqësorë prodiktivë, Kaçë	Arë	Kaçë. Nj.A. Vau Dëjës	5911 m2	Arë			Zaptuar



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE																																								
PRONARI: SHTET		DATE 26/11.2020		QELIMI KALIM PRONE ME VKM																																				
VENDNDODHJA BASHKIA VAU DEJES DVASHK/ZVASHK SHKODER (FSHATI:KACE) ZONA KADASTRALE 2015 NUMRI I PASURISE 125/35 INDEX HARTE K-34-76-(20-B) TE DHENAT E PASURISE LLOJ I PASURISE ARE SIP. PASURISE = 5911 m² SIPERFAQE E GJURMES NDERTIMIT = _____ m² NUMRI I KATEVE _____ NUMRI I PEMEVE _____																																								
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE																																								
X, Y 46828 392				X, Y 468908.565																																				
46828 392 SH 1: 2500 468908.565																																								
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; font-size: x-small;"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>ORIENTIMI</th> <th>PERDORIMI</th> <th>TIPI I KUFIRIT</th> <th>KUFITARI</th> <th>ID/NIPT</th> <th>SHENIME TE REALIZUESIT</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>VERI</td> <td></td> <td>RRUGE</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>LINDJE</td> <td></td> <td>RRUGE</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>JUG</td> <td></td> <td>PRONE PRIVATE</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>PERENDIM</td> <td></td> <td>RRUGE</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>						Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	1	VERI		RRUGE				2	LINDJE		RRUGE				3	JUG		PRONE PRIVATE				4	PERENDIM		RRUGE			
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT																																		
1	VERI		RRUGE																																					
2	LINDJE		RRUGE																																					
3	JUG		PRONE PRIVATE																																					
4	PERENDIM		RRUGE																																					
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI: HAMID CULIQ LICENCA: NR. 0675/2 DATE 10.04.2018 KOMPANIA: _____ NIPT: _____ NENSHKRIMAVULA: _____ REALIZOI PER ASHK SPECIALISTI: _____ DVASHK: _____ NENSHKRIMI: _____ KONFIRMO! PERGJEGJESI/DREJTORI: _____ NENSHKRIMAVULA: _____			TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T; O Kode per teknologji e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total, D-Matje Distancash; PERCAKTIMI I KUFIRIT: P Kode per percaktimin e kufirit: P-Perfaqesues i Pronarve; K-Kufitaret te Gjithe; KP-Kufitaret Pjeserisht; PB-Perfaqesues Bashkie; HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARDHENIET ME KUFITARE EMRI: _____ NENSHKRIMI: _____																																					
Kode per teknologji e matjeve dhe percaktimi i kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total, D-Matje Distancash; P-Perfaqesues i Pronarve; K-Kufitaret te Gjithe; KP-Kufitaret Pjeserisht; PB-Perfaqesues Bashkie; HK-Harta Kadastrale;																																								

**VENDIM****Nr. 15, datë 20.1.2021**

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË
MENAXHIMIT TË SHPENZIMEVE
PUBLIKE PËR VITIN 2021**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

1. Miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2021, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, njësia përgjegjëse për planifikimin strategjik dhe zhvillimin në Kryeministri dhe të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet nga data 1 janar 2021.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

VENDOSI:

Lidhja nr. 1

KALENDARI PËR MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2021

PERIUDHA	DATA	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	VEPRIMI PËRKATËS
Janar	5	MoFE	Përgatit dhe paraqet në KM Kalendarin e MSHIP
Janar	6	KM	Shqyrton dhe miraton Kalendarin e MSHIP
Janar	13	MoFE	Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2022 - 2024
Janar	20	KM	Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2022 - 2024
Shkurt	15-22	KM	Përgatit dhe miraton projekt dokumentin e prioriteteve të politikave 2022-2024 me ndikim në tavanet buxhetore.
Shkurt	15	MoFE	Paraqet në KM tavanet përgatitore të përgatitjes së PBA 2022-2024, për fazën strategjike
Shkurt	24	KM	Shqyrton dhe miraton tavanet përgatitore të përgatitjes së PBA 2022-2024, për fazën strategjike
Shkurt	26	MoFE	Dërgon Udhëzimin e Përgatitjes së Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme.
Mars	8	KM	Paraqet për informacion në Kuvend Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2022-2024
Mars - prill	1 Mars -23 Prill	Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore
Prill	26 Prill-27 Prill	Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme	Zhvillojnë takime konsultative me shoqërinë civile për PBA 2022-2024
Maj	4	Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme	Paraqesin në MoFE kërkesat e tyre buxhetore
Maj	5 - 20 Maj	MoFE	Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore
Maj	5 - 20 Maj	KM	Analizojnë kërkesat buxhetore bazuar në dokumentin e prioriteteve të politikave 2022-2024.
Maj	21 - 27 Maj	MoFE	Organizon seancat dëgjimore me Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme
Maj	28-31 Maj	MoFE	Prezanton dokumentin e PBA 2022-2024 me shoqërinë civile
Qershor	1	MoFE	Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar (në rast se shihet e nevojshme)
Qershor	2	KM	Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar (në rast se shihet e nevojshme)
Qershor	9	KM	Përgatit dhe miraton dokumentin e rishikuar të prioriteteve të politikave 2022-2024 me ndikim në tavanet buxhetore.
Qershor	10	MoFE	Përgatit dokumentin e PBA 2022-2024 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2022-2024.
Qershor	22	MoFE	Paraqet dokumentin e PBA 2022-2024 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2022-2024, për shqyrtim dhe miratim në KM.
Qershor	30	KM	Miraton dokumentin e PBA 2022-2024 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2022-2024
Korrik	8	MoFE	I paraqet Kuvendit për informacion dokumentin e PBA 2022-2024
Korrik	9	MoFE	Dërgon Udhëzimin Plotësues të Përgatitjes së Buxhetit në fazën teknike, në të gjitha Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme.
Korrik - gusht	12 Korrik - 31 Gusht	Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme	Përgatisin kërkesat buxhetore të rishikuara, në përputhje me tavanet përfundimtare.
Shtator	1	Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme	Paraqesin në MoFE kërkesat e rishikuara buxhetore.
Shtator	2-14	MoFE	Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore
Shtator	2-14	KM	Analizojnë kërkesat buxhetore bazuar në dokumentin e rishikuar të prioriteteve të politikave 2022-2024.
Shtator	15-24	MoFE	Organizon seancat dëgjimore me Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme
Tetor	5-12	MoFE	Përgatit Projektbuxhetin e vitit 2022 si dhe, dokumentin e rishikuar të PBA 2022-2024 dhe i paraqet për shqyrtim në KM.
Tetor	15	KM	Miraton Projektbuxhetin e vitit 2022 si dhe dokumentin e rishikuar të PBA 2022-2024
Tetor	18	MF	Dërgon për informacion në Kuvend një kopje të dokumentit të rishikuar të PBA 2022-2024, të miratuar nga KM
Tetor	18	KM	I paraqet Kuvendit Projektbuxhetin e vitit 2022

**VENDIM****Nr. 16, datë 20.1.2021**

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
PRONËSISË INDUSTRIALE,
PËR VITIN 2021**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 189/c, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e buxhetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, për vitin 2021, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

Tabela nr. 1

**PLANI TË ARDHURA – SHPENZIME, PËR VITIN 2021,
PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE**

000/Lekë

Të ardhurat		Shpenzimet	
Të ardhura nga aktiviteti kryesor	130,000	Shpenzime personeli	50,000
Të trashëguara investime dhe projekte në vazhdim	25,112	Shpenzime operative dhe korrente	19,830
Marrëveshja e Madridit	70,000	Transferta korrente e jashtme	6,607
Marrëveshja e Hagës	1,100	Shpenzime kapitale	14,980
Të ardhura nga marrëveshja e shtrirjes me ZEP	100	Totali i shpenzimeve	91,417
		Teprica derdhje në buxhetin e shtetit	134,895
Totali i të ardhurave	226,312	Totali i shpenzimeve dhe tepricave në buxhetin e shtetit	226,312

VENDIM**Nr. 17, datë 20.1.2021**

**PËR TRANSFERIMIN, NË PRONËSI TË
BASHKISË TIRANË, TË NJËSISË
ADMINISTRATIVE TIRANË, TË
PASURIVE ME NR. 7/619, 7/620, 7/621,
NË ZONËN KADASTRALE 8230**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin, në pronësi të Bashkisë Tiranë, të njësisë administrative Tiranë, të pasurive me numër 7/619, me sipërfaqe truall 600 m² dhe sipërfaqe ndërtese 81 m², 7/620, me sipërfaqe truall 2032 m², sipërfaqe ndërtese 1475 m², 7/621, me sipërfaqe truall 25310 m², sipërfaqe ndërtese 2454,7 m², në zonën kadastrale 8230, sipas hartës treguese bashkëlidhur këtij vendimi, për t'u përdorur në funksion të zbatimit të projektit të rindërtimit.

2. Pronat e përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohen listës përfundimtare të pjesshme të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 219, datë 21.3.2017, të



Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshme (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të njësisë administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, të qarkut të Tiranës”, të ndryshuar.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Tiranë dhe Agjencia

Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUEJTSHME TIRANË REGJISTRUES Valdrin Pjetri REGJISTRIM ZVRPP TIRANË	A. IDENTIFIKIMI I PASURISE ZONA KADASTRALE <u>8230</u> NR. I PASURISE: <u>7/619</u> VOL <u>30</u> FQ <u>90</u> INDEKSI I HARTES: <u>TR-U-0</u> SHKALLA: <u>1:500</u> ADRESA E PASURISE: Rrethi <u>TIRANË</u> Q/F <u>TIRANË</u> Rr/L: <u>K.PEZES</u> P/G SH K <u>Ap</u> B. KUFIZIMET V. <u>7/621</u> L. <u>7/165</u> <u>7/554</u> J. <u>7/140</u> P. <u>7/621</u> <u>7/110</u> C. PRONARI PRODHIM MOBILJE S.H.A. D. Data: <u>07/02/2018</u> Ora: <u>1:52:35PM</u>
X: 396151.808 Y: 4576237.692 1000 km 500 mi X: 396151.808 Y: 4576158.317	X: 396257.72 Y: 4576237.692 7/165 7/619 7/34 X: 396257.72 Y: 4576158.317




HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUEJTSHME TIRANË REGJISTRUES Valdrin Pjetri REGJISTRIMI I PASURIVE TE PALUEJTSHME Z.V.R.P.P. TIRANË <i>Vula/Firma</i>	A. IDENTIFIKIMI I PASURISE ZONA KADASTRALE 8230 NR. I PASURISE: 7/620 VOL 30 FQ 91 INDEKSI I HARTES: TR-U-0 SHKALLA: 1:500 ADRESA E PASURISE: Rrethi TIRANË Q/F TIRANË Rr/L: K.PEZES P/G SH K Ap B. KUFIZIMET V. 7/621 L. 7/621 J. 7/621 P. 7/170 C. PRONARI PRODHIM MOBILJE S.H.A. D. Data: 07/02/2018 Ora: 1:41:26PM
--	---

X: 396085.993
Y: 4576222.348

X: 396181.905
Y: 4576222.348



X: 396085.993
Y: 4576142.973

X: 396181.905
Y: 4576142.973




HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUEJTSHME TIRANË REGJISTRUES Valdrin Pjetri REGJISTRIM TE PASURIVE TE PALUEJTSHME TIRANË Vula e firmës	A. IDENTIFIKIMI I PASURISE ZONA KADASTRALE 8230 NR. I PASURISE: 7/621 VOL 30 FQ 92 INDEKSI I HARTES: TR-U-0 SHKALLA: 1:2500 ADRESA E PASURISE: Rrethi TIRANE Q/F TIRANE Rr/L: K.PEZES P/G SH K Ap B. KUFIZIMET V. - L. 7/130 7/169 J. 7/130 P. 7/168 C. PRONARI PRODHIM MOBILJE S.H.A. D. Data: 09/02/2018 Ora: 8:07:03AM
--	--

X: 395888.032
Y: 4576342.418

X: 396367.59
Y: 4576342.418



X: 395888.032
Y: 4575945.543

X: 396367.59
Y: 4575945.543



VENDIM
Nr. 18, datë 20.1.2021

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2021, TË
MIRATUAR PËR AKADEMINË E
SHKENCAVE TË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936/2016, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i shtohet fondi prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh, në zërin “shpenzime korrente”, për financimin e hartimit e botimit të tri veprave madhore albanologjike dhe enciklopedike, përkatësisht:

- a) Enciklopedia shqiptare;
- b) Fjalori i madh i shqipes;
- c) Historia e shqiptarëve.

2. Efekti financiar, prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2021.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 19, datë 20.1.2021

**PËR MASËN E FONDIT TË VEÇANTË
PËR ZONAT E MBROJTURA
MJEDISORE, PËR BURIMET E
KRIJIMIT DHE RREGULLAT E
PËRDORIMIT TË TIJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 59, të ligjit nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, me propozimin e ministrit të

Turizmit dhe Mjedisit dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rregullave për masën e fondit të veçantë që përdoret në zonat e mbrojtura mjedisore, burimet e krijimit dhe përdorimit të tyre nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), si institucion përgjegjës për administrimin e përdorimit të të gjitha të ardhurave të realizuara nga aktiviteti ekonomik në territorin e zonave të mbrojtura mjedisore, si dhe nga kontributet e donatorëve të institucioneve ndërkombëtare.

2. Fondi i veçantë për zonat e mbrojtura mjedisore (në vijim FVZM-ja) krijohet nga ministria përgjegjëse për financat në bashkëpunim me AKZM-në, në masën 15 (pesëmbëdhjetë) %, nga fondet e krijuara nga të ardhurat, dhe në masën 85%, nga kontributet e donatorëve dhe projektet me mbështetje të institucioneve ndërkombëtare.

3. Për funksionimin e fondit të veçantë për zonat e mbrojtura hapen:

a) llogaria e parë e veçantë në emër të ministrisë përgjegjëse për financat në Bankën e Shqipërisë (llogaria kanalizuese);

b) llogaria e dytë e veçantë në emër të AKZM-së në një bankë të nivelit të dytë në Shqipëri, në euro dhe në lekë.

4. Në fondin e veçantë për zonat e mbrojtura transferohen:

a) fondet nga donatorët për çdo disbursim në llogarinë e parë të veçantë dhe ministria përgjegjëse për financat dërgon fondet në llogarinë e dytë të veçantë;

b) kontributi nga të ardhurat e vetë AKZM-së, nëpërmjet llogarisë së bankës së nivelit të dytë.

5. Fondi i veçantë për zonat e mbrojtura përdoret për rastet e parashikuara në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, mbështetur në manualin e përdorimit më të detajuar të këtij fondi, të miratuar nga ministri përgjegjës për mjedisin, me propozim të AKZM-së. Manuali parashikon edhe procedurat e kontributit nga donatorët që zbatohen sipas marrëveshjeve të veçanta.

6. Kontributet e dhëna nga donatorët përdoren në bazë të marrëveshjeve reciproke që nënshkruhen ndërmjet palëve për rastet e



parashikuara në pikën 1, të nenit 59, të ligjit për zonat e mbrojtura dhe procedohen sipas legjislacionit në fuqi për marrëveshjet.

7. Planifikimi dhe alokimi i mundshëm i fondeve të krijuara nga të ardhurat bëhet në përputhje dhe sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

8. Fondi i veçantë për zonat e mbrojtura përdoret nga AKZM-ja, e cila raporton rregullisht pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin për përdorimin e tij, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për zonat e mbrojtura e aktet nënligjore në fuqi, si edhe për menaxhimin financiar të projekteve, sipas marrëveshjeve të nënshkruara.

9. Ngarkohen ministria përgjegjëse për mjedisin e zonat e mbrojtura, ministria përgjegjëse për financat dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 21, datë 20.1.2021

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E
RIKONSTRUKSIONIT/RIPARIMIT TË
NJËSIVE INDIVIDUALE TË
BANIMIT/NJËSIVE TË BANIMIT NË
NDËRTESE (PALLAT), NË BASHKINË
TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 156 061 269 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëdhjetë e një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë, për financimin e rikonstruksionit ose riparimit të njësive individuale të banimit/njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime në Bashkinë Tiranë.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe i transferohet Bashkisë Tiranë, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rikonstruksionit ose riparimit të njësive individuale të banimit/njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



VENDIM
Nr. 22, datë 20.1.2021

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E
HARTIMIT TË PROJEKTIT TË
NDËRHYRJEVE REHABILITUESE/
PËRSHTATËSE TË NEVOJSHME PËR
KTHIMIN E STRUKTURËS SË
OBJEKTEVE QË JANË KLASIFIKUAR SI
OBJEKTE ME DËMTIME TË MËDHA
STRUKTURE OSE DËMTIME
SHUMË TË RËNDA JOSTRUKTURE,
NË BASHKITË KAMZË DHE KURBIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 10 637 537 (dhjetë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore, në bashkitë Kamzë dhe Kurbin, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi, në masën 5 495 037 (pesë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e tridhjetë e shtatë) lekë, për financimin e hartimit të projekteve të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse, për ndërhyrjet strukturore të nevojshme, për njësitë individuale të banimit, bazuar në rekomandimet e aktekspertizave të thelluara të bëra nga Instituti i Ndërtimit;

b) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi, në masën 5 142 500 (pesë milionë e njëqind e dyzet e

dy mijë e pesëqind) lekë, për financimin e hartimit të projekteve të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse, për ndërhyrjet strukturore të nevojshme, për njësitë individuale të banimit, bazuar në rekomandimet e aktekspertizave të thelluara të bëra nga Instituti i Ndërtimit.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e shtetit për vitin 2021, dhe i transferohet, në formën e transfertës së pakushtëzuar, bashkive Kamzë dhe Kurbin.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Kamzë dhe Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 23, datë 20.1.2021

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË BANESAVE
INDIVIDUALE NË BASHKITË TIRANË,
SHIJAK, VORË DHE KURBIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 2 607 677 890 (dy miliardë e gjashtëqind e shtatë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen



rindërtuar nga e para, në bashkitë Tiranë, Shijak, Vorë dhe Kurbin, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi, në masën 1 009 040 322 (një miliard e nëntë milionë e dyzet mijë e treqind e njëzet e dy) lekë, për rindërtimin e 432 njësive individuale të banimit, për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para;

b) Bashkisë Shijak i transferohet fondi, në masën 137 592 232 (njëqind e tridhjetë e shtatë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind e tridhjetë e dy) lekë, për rindërtimin e 46 njësive individuale të banimit, për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para;

c) Bashkisë Vorë i transferohet fondi, në masën 851 809 204 (tetëqind e pesëdhjetë e një milionë e tetëqind e nëntë mijë e dyqind e katër) lekë, për rindërtimin e 300 njësive individuale të banimit, për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para;

ç) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi, në masën 609 236 132 (gjashtëqind e nëntë milionë e dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tridhjetë e dy) lekë, për rindërtimin e 218 njësive individuale të banimit, për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe u transferohet bashkive Tiranë, Shijak, Vorë dhe Kurbin, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Tiranë, Shijak, Vorë dhe Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 24, datë 20.1.2021

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RIKONSTRUKSIONIT TË NJËSIVE
INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE
NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA
(PALLAT) NË BASHKITË TIRANË
DHE DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nëndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 531 815 000 (pesëqind e tridhjetë e një milionë e tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë, për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, në bashkitë Tiranë dhe Durrës, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi në masën 427 665 000 (katërqind e njëzet e shtatë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë;

b) Bashkisë Durrës i transferohet fondi në masën 104 150 000 (njëqind e katër milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga pjesa e financuar nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe t’u kalojë bashkive Tiranë dhe Durrës në formën e transfertës së pakushtëzuar.



3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Tiranë dhe Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 25, datë 20.1.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 5, DATË 6.1.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE PËR PËRFITIMET NGA PROGRAMI I GRANTEVE TË RINDËRTIMIT DHE PROJEKTET MODEL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 18, 19, 20 e 25, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronja “b”, e pikës 7, të kreut IV, të vendimit nr. 5, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Masa e grantit për punimet që parashikohen në shkronjën “a”, të pikës 7, të këtij kreu, është 100% e vlerës së rikonstruksionit ose riparimit;”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 26, datë 20.1.2021

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT/RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKITË KAMZË DHE KAVAJË DHE ÇAKTIMIN E TYRE SI NJËSI ZBATUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore në bashkitë Kamzë dhe Kavajë, në masën 1 223 429 959 (një miliard e dyqind e njëzet e tre milionë e katërqind e njëzet e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Kamzë, në masën 754 430 842 (shtatëqind e pesëdhjetë e katër milionë e katërqind e tridhjetë mijë e tetëqind e dyzet e dy) lekë pa TVSH, për:

i. rindërtimin e shkollës 9-vjeçare “Niko Hoxha”, në masën 189 845 078 (njëqind e tetëdhjetë e nëntë milionë e tetëqind e dyzet e pesë mijë e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH;

ii. rindërtimin e çerdhes “Kamzë”, në masën 67 638 407 (gjashtëdhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e tetë mijë e katërqind e shtatë) lekë pa TVSH;

iii. rikonstruksionin e shkollës së mesme “Ibrahim Rugova”, në masën 178 500 000 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e pesëqind mijë) lekë pa TVSH;

iv. rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare “Ahmet Zogu”, në masën 163 800 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre milionë e tetëqind mijë) lekë;



v. rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare “Kamza e Re”, në masën 66 780 000 (gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë mijë) lekë;

vi) rikonstruksionin e kopshtit “Kamza e Re”, në masën 30 170 000 (tridhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë;

vii. rikonstruksionin e kopshtit “Ahmet Zogu”, në masën 57 697 357 (pesëdhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e treqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë.

b) Bashkisë Kavajë, në masën 468 999 117 (katërqind e gjashtëdhjetë e tetë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, për:

i. rikonstruksionin e shkollës së mesme “Aleksandër Moisiu”, në masën 153 041 206 (njëqind e pesëdhjetë e tre milionë e dyzet e një mijë e dyqind e gjashtë) lekë pa TVSH;

ii. rikonstruksionin e shkollës “Qamil Xhani”, në masën 139 632 943 (njëqind e tridhjetë e nëntë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e dy mijë e nëntëqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH;

iii. rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare “Razi Leka”, në masën 119 025 106 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milionë e njëzet e pesë mijë e njëqind e gjashtë) lekë pa TVSH;

iv. rikonstruksionin e kopshtit “Hap pas hapi”, në masën 57 299 862 (pesëdhjetë e shtatë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2021, për financimin e rindërtimit/ rikonstruksionit të objekteve arsimore në bashkitë Kamzë dhe Kavajë, në masën 244 685 991 (dyqind e dyzet e katër milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit dhe detajohet, si më poshtë vijon:

a) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi në masën 150 886 168 (njëqind e pesëdhjetë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Kavajë i transferohet fondi në masën 93 799 823 (nëntëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e njëzet e tre) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Caktimin e bashkive Kamzë dhe Kavajë si njësi zbatuese për financimin e rindërtimit/

rikonstruksionit të objekteve arsimore, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Kamzë e Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 27, datë 20.1.2021

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E
RIFORCIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT
NË NDËRTESA (PALLAT), NË
BASHKITË TIRANË DHE KURBIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 1 561 260 803 (një miliard e pesëqind e gjashtëdhjetë e një milion e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e tetëqind e tre) lekë, për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, nga bashkitë Tiranë dhe Kurbin, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi në masën 840 575 731 (tetëqind e dyzet milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e një) lekë;



b) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi në masën 720 685 072 (shtatëqind e njëzet milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëdhjetë e dy) lekë.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, në masën 312 252 160 (treqind e dymbëdhjetë milionë e dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë, për financimin e riorcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, nga bashkitë Tiranë dhe Kurbin, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi në masën 168 115 146 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë milionë e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e gjashtë) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi në masën 144 137 014 (njëqind e dyzet e katër milionë e njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e katërmëdhjetë) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Tiranë dhe Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM

Nr. 28, datë 20.1.2021

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT TË INVESTIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË (PËRFITUESI), DHE KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW), PËR PROGRAMIN E INFRASTRUKTURËS BASHKIAKE V, NË SHUMËN 6 000 000 EURO

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

Miratimin e marrëveshjes së grantit të investimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përfituesi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e infrastrukturës bashkiake V, në shumën 6 000 000 (gjashtë milionë) euro, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**MARRËVESHJA E GRANTIT
TË INVESTIMIT
E DATËS 18.12.2020 NDËRMJET KfW,
FRANKFURT AM MAIN (KfW), DHE
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCAVE DHE EKONOMISË
(PËRFITUESI), PËR SHUMËN
6,000,000.00 EURO**

Programi për Infrastrukturën Bashkiake V -
BMZ-Nr. 2017 68 993

TABELA E LËNDËS

Pikat

1. Shuma dhe qëllimi i Grantit
 2. Kanalizimi i Grantit për investim tek agjencitë e zbatimit të projektit
 3. Disbursimi
 4. Pezullimi i disbursimit dhe shlyerja
 5. Kostot dhe tarifat publike
 6. Deklaratat Kontraktuese dhe Tagrat e Përfaqësimit
 7. Programi
 8. Publikimi dhe transferimi i informacionit të lidhur me programin
 9. Dispozita të ndryshme
- Zotimet e përputhshmërisë të Përfituesit
Zotimet e përputhshmërisë së Agjencisë së Zbatimit të Projektit

Mbi bazën e Marrëveshjes së datës 11 tetor 2019 ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi Bashkëpunimin Financiar



(Marrëveshja Qeveritare), Përfituesi dhe KfW-ja lidhin Marrëveshjen e mëposhtme të Grantit (Marrëveshja e Grantit të Investimit).

Kjo Marrëveshje e Grantit të Investimit është pjesë e Programit të Infrastrukturës Bashkiake V (Programi). Programi do të zbatohet me anë të kësaj Marrëveshjeje të Grantit të Investimit, marrëveshjes së huas “Marrëveshja e Huas”), marrëveshjes së grantit të financuar nga SECO (Marrëveshja e Grantit SECO), marrëveshjes së grantit të financuar nga BE-ja (Marrëveshja e Grantit e BE-së) dhe Marrëveshjes së Grantit për masat shoqëruese (Marrëveshja e Grantit Shoqërues), të gjitha me të njëjtën datë me të kësaj marrëveshjeje:

1. Shuma dhe qëllimi i Grantit

1.1 KfW-ja i ofron Përfituesit një grant që nuk kalon shumën 6,000,000.00 (Granti i Investimit).

Ky Grant nuk është i shlyeshëm, përveç kur përcaktohet ndryshe në nenin 4.2.

1.2 Përfituesi do të përdorë Grantin e Investimit ekskluzivisht për të financuar, në kuadër të Programit, masat e investimit për përmirësimin e sistemeve të ujësjellësit dhe të kanalizimeve në qytetin përkatës (secili “Projekt”, bashkërisht, “Projektet”), përmes kanalizimit të Grantit të Investimit në mënyrë të plotë, për kompanitë e shërbimeve të UK Berat-Kuçovë, UK Elbasan, UK Fier, UK Kamzë, UK Lezhë, UK Shkodër dhe UK Vlorë (bashkërisht “Agjenci të Zbatimit të Projektit” ose “AZP-të”, secila “Agjenci e Zbatimit të Projektit” ose “AZP”), në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 2 dhe kryesisht për të financuar kostot e këmbimit valutor.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve, do të veprojë si njësi e koordinimit të programit (“Njësia e Koordinimit të Programit” ose “NJKP”) për të gjithë drejtimin, koordinimin dhe zbatimin e projektit.

MIE/NJKP-ja, AZP-të dhe KfW-ja përcaktojnë detajet e Programit dhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga Granti i Investimit, me anë të një marrëveshjeje të veçantë (“Marrëveshja e Veçantë”), e cila do të nënshkruhet edhe nga Përfituesi si e pranuar.

1.3 Taksat dhe detyrimet e tjera publike do të mbulohen nga Përfituesi ose ndonjë Agjenci e Zbatimit të Projektit dhe tatimet e importit nuk do të financohen nga Granti i Investimit.

2. Kanalizimi i Grantit të Investimit tek Agjencitë e Zbatimit të Projektit

2.1 Përfituesi kanalizon Grantin e Investimit tek Agjencitë e Zbatimit të Projektit si një grant të pashlyeshëm, sipas një marrëveshjeje të veçantë granti.

2.2 Para disbusimit të parë nga Granti i Investimit, Përfituesi i jep KfW-së një përkthim të vërtetuar të marrëveshjes së përmendur në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i Grantit të Investimit nuk përbën ndonjë detyrim të Agjencisë të Zbatimit të Projekteve ndaj KfW-së, për detyrimet e pagesës, sipas kësaj Marrëveshjeje të Grantit të Investimit.

3. Disbursimi

3.1 KfW-ja e disburson Grantin e Investimit, në përputhje me progresin e Programit dhe me kërkesë të Përfituesit, nëpërmjet MIE/NJKP-së. Me anë të një Marrëveshjeje të Veçantë, MIE/NJKP-ja, Agjencitë e Zbatimit të Projekteve dhe KfW-ja përcaktojnë procedurën e disbursimit, në veçanti provat që vërtetojnë se fondet e disbursuara janë përdorur për qëllimin e përcaktuar, e cila nënshkruhet si e pranuar nga Përfituesi.

3.2 KfW-ja ka të drejtë të refuzojë kryerjen e disbusimeve pas datës 30 qershor 2026.

4. Përzullimi i disbusimeve dhe shlyerja

4.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbusimet, përveç kur:

a) Përfituesi nuk i përmbush detyrimet e tij ndaj KfW-së për pagesat e kërkueshme;

b) janë shkelur detyrimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje të Grantit të Investimit, Marrëveshjen e Huas, Marrëveshjes e Grantit SECO, Marrëveshjen e Grantit të BE-së, Marrëveshjen e Grantit Shoqërues ose në marrëveshjet e veçanta të lidhura me këtë Marrëveshje e Grantit të Investimit;

c) Përfituesi, nëpërmjet MIE/NJKP-së ose ndonjë Agjencie të Zbatimit të Projektit, nuk mund të provojë se shumatat e disbursuara janë përdorur për qëllimin e përcaktuar;

d) përmbushja e detyrimeve të KfW-së, në kuadër të kësaj Marrëveshjeje të Grantit të Investimit shkel ligjin e zbatueshëm; ose

e) lindin rrethana të jashtëzakonshme që përjashtojnë ose rrezikojnë rëndë zbatimin, funksionimin ose qëllimin e Programit;

f) ndodh një ngjarje që e mundëson KfW-në të pezullojë disbusimet, sipas Marrëveshjes së Huas,



Marrëveshjes së Grantit SECO, Marrëveshjes së Grantit të BE-së ose Marrëveshjes së Grantit Shoqërues.

4.2 Nëse ndonjë prej situatave të specifikuara në nenin 3.1(b), (c), d) ose (g) ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, e cila, megjithatë, duhet të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja mund të:

a) në rastin e përcaktuar në nenin 3.1(b) ose (d), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara;

b) në rastin e specifikuar në nenin 3.1(c), mund të kërkojë shlyerje të menjëhershme të atyre shumave që Përfituesi nëpërmjet MIE/NJKP-së ose ndonjë Agjenci e Zbatimit të Projektit, nuk mund të provojë se janë përdorur për qëllimin e caktuar;

5. Kostot dhe detyrimet publike

Përfituesi mbulon të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që shtohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë, për lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje të Grantit të Investimit, si dhe të gjitha kostot e transferimit dhe konvertimit që shtohen, në lidhje me disbursimin e kontributit financiar.

6. Deklaratat kontraktuale dhe tagri i përfaqësimit

6.1 Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe personat e caktuar prej tij ose saj për KfW-në dhe të autorizuar nga nënshkrimet model të vërtetuara prej tij ose saj, përfaqësojnë Përfituesin në të gjitha veprimet e kërkuara për zbatimin e Marrëveshjes së Grantit të Investimit. Prokurat nuk do të skadojnë deri në marrjen nga ana e KfW-së të revokimit të tyre të shprehur nga përfaqësuesi i Përfituesit i autorizuar në atë kohë.

6.2 Ndryshimet ose shtesat e kësaj Marrëveshjeje të Grantit të Investimit, si dhe njoftimet dhe deklaratat e lëshuara nga palët kontraktuese në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje bëhen me shkrim. Ministri i Financave dhe i Ekonomisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim që duhet miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje të Grantit të Investimit që cenojnë vetëm periudhën e disponueshmërisë (neni 2.2) nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave. Çdo njoftim apo deklaratë e tillë konsiderohet e marrë sapo të ketë mbërritur në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese përkatëse ose në atë adresë tjetër të

palës kontraktuese përkatëse, siç i është njoftuar palës tjetër kontraktuese:

Për KfW-në:

KfW

Postfach 11 11 41

60046 Frankfurt am Main

Federal Republic of Germany (Republika Federale e Gjermanisë)

Faks: +49 69 7431-2944

Për Përfituesin:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3

Tiranë, Shqipëri

7. Programi

7.1 Përfituesi, nëpërmjet MIE/NJKP-së, do të marrë masa dhe do të kërkojë, që AZP-të do të:

a) përgatitin, zbatojnë, operojnë dhe mirëmbajnë Projektet, në përputhje me praktikat e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike, sipas standardeve mjedisore dhe sociale dhe, kryesisht, në përputhje me konceptin e dakordësuar të Programit ndërmjet Përfituesit dhe KfW-së;

b) u delegojnë përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të Projekteve inxhinierëve konsulentë të pavarur, të kualifikuar dhe zbatimin e Programit firmave të kualifikuara;

c) zbatojnë në çdo kohë dispozitat e prokurimit të përcaktuara në Marrëveshjen e Veçantë, duke përfshirë planin përkatës të prokurimit;

d) mbajnë ose sigurojnë mbajtjen e librave dhe regjistrave të saktë dhe të rregullt, duke specifikuar qartë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për Projektet dhe që identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga ky Grant i Investimit;

e) u mundësojnë përfaqësuesve të KfW-së që të inspektojnë në çdo kohë librat dhe regjistrat e lartpërmendur, si dhe çdo dokumentacion tjetër që lidhet me zbatimin e Projektit dhe të vizitojnë Projektet dhe të gjitha instalimet lidhur me to;

f) i japin KfW-së, çdo dhe të gjitha informacionet dhe të dhënat për Projektin dhe progresin e tij të mëtejshëm, sipas kërkesës së KfW-së;

7.2 Detajet e lidhura me nenin 7.1 do të përcaktohen nga një Marrëveshje e Veçantë.

7.3 Përfituesi, nëpërmjet MIE/NJKP-së do të marrë masa dhe do të kërkojë, që AZP-të do të:



a) sigurojnë financim të plotë të Projekteve dhe me kërkesë të KfW-së do t'i japin KfW-së dëshmi që provojnë se kostot e papaguara nga ky Grant i Investimit, janë mbuluar;

b) me pëlqimin e tyre, do të informojnë menjëherë KfW-në për çdo dhe të gjitha rrethanat që mund të përjashtojnë ose rrezikojnë rëndë zbatimin, operimin, menaxhimin ose qëllimin e Projekteve.

7.4 Përfutuesi, nëpërmjet MIE/NJKP-së, asiston Agjencitë e Zbatimit të Projektit, në përpunime me praktikantët e qëndrueshëm inxhinierikë dhe financiarë në zbatimin e Projekteve dhe në përmbushjen e detyrimeve të Agjencive të Zbatimit të Projektit, sipas kësaj Marrëveshjeje dhe, në veçanti, u jep Agjencive të Zbatimit të projektit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e Projekteve.

7.5 Për transportin e mallrave që do të financohen nga Granti, do të zbatohen dispozitat e Marrëveshjes së Qeverisë, të cilat i janë njohur Përfutuesit.

8. Publikimi dhe transferimi i informacionit të lidhur me Programin

8.1 Për të përmbushur parimet e pranuar ndërkombëtarisht për arritjen e transparencës dhe efikasitetit në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë rezultatet e vlerësimit dhe kategorizimit mjedisor dhe social, si dhe raportet e vlerësimit *ex post* (pas projektit) për Programin dhe financimin e tij gjatë negociatave parakontraktuale, paralelisht me zbatimin e marrëveshjes/ve të lidhur/a me Programin dhe në fazën paskontraktuale (në vijim e referuar si “Periudha e Plotë”).

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të KfW-së për fushën e tij të biznesit “Banka e Zhvillimit KfW” (<http://transparenz.KfW-entwicklungsbank.de/>).

Publikimi i informacionit (qoftë nga KfW-ja apo palët e treta, në përpunime me nenin 8.3 më poshtë) për Programin dhe mënyrën e tij të financimit nuk përfshin asnjë dokumentacion kontraktual ose informacion të hollësishëm sensitiv financiar apo të lidhur me biznesin rreth palëve të përfshira në Program ose në financimin e tij, të tillë si:

- a) informacion për të dhënat e brendshme financiare;
- b) strategjitë e biznesit;
- c) udhëzime dhe raporte të brendshme të korporatës;

d) të dhëna personale për personat fizikë;

e) vlerësimi i brendshëm i KfW-së për gjendjen financiare të palëve.

8.2 KfW-ja e ndan informacionin e përzgjedhur për Programin dhe mënyrën e tij të financimit gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e përmendura më poshtë, veçanërisht për të siguruar transparencë dhe efikasitet:

a) filialet e KfW-së;

b) Republikën Federale të Gjermanisë dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë ose subjektet e saj kompetente;

c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin gjerman dypalësh për zhvillim, veçanërisht *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH*;

d) organizata ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarët e tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe anëtarët e saj;

e) Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike SECO;

f) Bashkimin Evropian dhe institucionet e tij.

8.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur për Programin dhe financimin e tij gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e mëposhtme, të cilat botojnë seksionet që kanë lidhje me qëllimin:

a) Republika Federale e Gjermanisë, për qëllimet e Nismës së Transparencës së Ndihmës Ndërkombëtare

(http://www.bmz.de/de/was_wir_machen/eege/transparenz-fuer-mehr-Eirksamkeit/index.html);

b) TregudheInvestimiGjerman(GTAI),për qëllimete informacionitpërtregun

(<http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/trade.FOO>);

c) OECD-ja, për qëllimet e raportimit të flukseve financiare, në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim (<http://stats.oecd.org/>);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEval), për qëllimet e vlerësimit të përgjithshëm të bashkëpunimit gjerman për zhvillim, për të garantuar transparencë dhe efikasitet (<http://www.deval.org/de/>);

e) Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike SECO (<http://www.simap.ch>);

f) Bashkimi Evropian dhe institucionet e tij.



8.4 KfW-ja rezervon më tej të drejtën për transferimin (duke përfshirë qëllimet e publikimit) e informacionit për Programin dhe financimin e tij gjatë Periudhës së Plotë të palët e tjera të treta për të mbrojtur interesat e ligjshme.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja te palët e tjera të treta, nëse interesat e ligjshëm të Përfituesit në informacionin që nuk transferohet i tejkalon interesat e KfW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshëm të Përfituesit përfshijnë veçanërisht konfidencialitetin e informacionit sensitiv të përmendur në nenin 8.1, i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtën t'iu transferojë informacion palëve të treta, nëse kjo është e nevojshme, për shkak të kërkesave statutores ose rregullore ose për të ruajtur ose mbrojtur pretendimet ose të drejtat e tjera ligjore në proceset gjyqësore ose administrative.

9. Dispozita të ndryshme

9.1 Përfituesi ndërmerr të përbushë në çdo kohë detyrimet e parashtruara në shtojcën 1a (Zotimet e Përputhshmërisë) dhe të sigurojë se Agjencitë e Zbatimit të Projektit përbushin në çdo kohë detyrimet e parashtruara në shtojcën 1b (Zotimet e Përputhshmërisë së Agjencisë së Zbatimit të Projektit).

9.2 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje të Grantit të Investimit është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara në lidhje me të. Çdo boshllëk ligjor që mund të rrjedhë prej saj plotësohet me një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje të Grantit të Investimit.

9.3 As Përfituesi dhe as ndonjë Agjenci e Zbatimit të Projektit nuk mund të caktojë ose transferojë, premtojë ose hipotekojë ndonjë pretendim që rrjedh nga kjo Marrëveshje e Grantit të Investimit.

9.4 Kjo Marrëveshje e Grantit të Investimit rregullohet nga legjislacioni i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i përbushjes është Frankfurt am Main.

9.5 Marrëdhëniet juridike të vendosura nga kjo Marrëveshje e Grantit të Investimit ndërmjet KfW-së dhe Përfituesit përfundojnë me mbarimin e kohëzgjatjes së dobishme të Programit, por jo më vonë se 15 vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje të Grantit të Investimit.

9.6 Kjo Marrëveshje e Grantit të Investimit do të hyjë në fuqi kur KfW-ja të ketë marrë njoftimin me shkrim të Përfituesit se procedurat e brendshme ligjore që do të përbushen nga Përfituesi, janë përbushur (data e marrjes pranë KfW-së).

Hartuar në 2 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main

sot_____, më

18.12.2020

KfW

Tiranë,

sot_____, më

18.12.2020

Republika e Shqipërisë

Emri:

Funksioni:

Emri:

Funksioni:

Emri:

Funksioni:

Shtojca

1a – Zotimet e Përputhshmërisë të Përfituesit

1b – Zotimet e Përputhshmërisë të Agjencisë së Zbatimit të Projektit

SHTOJCA 1a

ZOTIMET E PËRPUTHSHMËRISË TË
HUAMARRËSIT

1. Përkufizime

“Praktikë shtrënguese”, dëmtimi apo lëndimi ose kërcënim për të dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një person apo pronë të ndonjë personi për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme mbi veprimet e një personi.

“Praktikë e fshehtë” është një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër.

“Praktikë korruptive”, premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, insistimi për të dhënë, marrja, pranimi ose kërkimi, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, i ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çfarëdolloj natyre, për apo nga çdo person, me qëllim ndikimin në veprimet e një personi apo pengimin e atij personi për të vepruar.

“Praktikë mashtruese” nënkupton çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqpërfaqësim që çorienton ose synon të çorientojë, qoftë me ose



pa dashje, një person me qëllim marrjen e një përfitimi financiar ose shmangien e një detyrimi.

“Praktikë penguese”: i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e qëllimshme e provave materiale hetimore ose dhënia e dëshmimeve të rreme për hetuesit, për të penguar materialisht një hetim zyrtar mbi dyshimet e një praktike korruptive, praktike mashtruese, praktike shtrënguese, praktike të fshehtë ose kërcënim, ngacmimi apo frikësimi të një personi, për të mos e lejuar atë që të tregojë gjithçka për çështje që lidhen me hetimin, ose nga kryerja e hetimit; ose ii. çdo akt që synon të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar kontraktualisht lidhur me një hetim zyrtar mbi dyshimet e një praktike korruptive, praktike mashtruese, praktike shtrënguese ose praktike të fshehtë.

“Person”, një person fizik, person juridik, partneritet apo shoqatë e pathemeluar në formën e korporatës.

“Praktikë e sanksionueshme”, çdo praktikë shtrënguese, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktike mashtruese, ose praktike penguese (sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje), që: i. është e paligjshme, sipas legjislacionit gjerman ose ligjeve të tjera të zbatueshme; dhe që ii. ka ose mund të ketë efekt material ligjor ose reputacional mbi këtë Marrëveshje ndërmjet Përfituesit dhe KfW-së apo zbatimin e saj.

“Sanksione”, sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, miratuara apo zbatuara nga Organi Sanksionues.

“Organ sanksionues”, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian ose Republika Federale e Gjermanisë.

“Listë e sanksioneve”, çdo listë e personave, grupeve apo subjekteve të përcaktuara në mënyrë specifike që u nënshtrohen sanksioneve, e lëshuar nga ndonjë organ sanksionues.

2. Sipërmarrja lidhur me informacionin

Përfituesi:

a) i vë në dispozicion KfW-së menjëherë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që lidhet me “njohjen e klientit” apo informacione të ngjashme për Përfituesin që KfW-ja mund të kërkojë;

b) i ofron KfW-së menjëherë, sipas kërkesës, të gjithë informacionin dhe dokumentet e lidhura me

Projektin, dhe palëve të tij (nën)kontraktuese dhe palëve të tjera përkatëse, tek të cilat KfW-ja bazohet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e praktikave të sanksionueshme, pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me Përfituesin, që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) informon KfW-në menjëherë dhe me pëlqimin e tij, sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi të lidhur me Projektin;

d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi Projektin dhe ecurinë e tyre të mëtejshme, siç KfW-ja mund të kërkojë, për qëllimet e kësaj shtojce; dhe

e) u mundëson KfW-së dhe agentëve të saj, në çdo kohë, inspektimin e të gjithë dokumentacionit tjetër të Përfituesit dhe palëve të tij (nën)kontraktuese apo palëve të tjera të lidhura me të mbi Projektin dhe kryerjen e vizitave në Projekt dhe në të gjitha instalimet përkatëse, për qëllimet e kësaj shtojce.

3. PËRFAQËSIMI DHE GARANCIA

3.1 Për sa i përket legjislacionit gjerman apo legjislacionit të vendit të Përfituesit, ky i fundit shprehet se asnjë prej personave që vepron në emër të Përfituesit për Projektin, nuk ka kryer ose nuk është angazhuar në praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi.

3.2 Përfaqësimi dhe garancia e përcaktuar në këtë nen jepen për herë të parë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ato do të konsiderohen të përsëritura me çdo tërheqje të Grantit, duke iu referuar rrethanave mbizotëruese në atë datë.

4. Sipërmarrjet pozitive

Përfituesi ndërmerr të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agentët e saj, sapo Përfituesi apo KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash, apo financim terrorizmi, për të përcaktuar, nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Në veçanti, Përfituesi i përgjigjet menjëherë dhe në detaje të arsyeshme çdo njoftimi të KfW-së dhe ofron mbështetje dokumentuese për këtë përgjigje, me kërkesë të KfW-së.



5. Sipërmarrjet negative

Përfituesi nuk lidh transaksione apo nuk angazhohet në veprimtari të tjera lidhur me Projektin që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

SHTOJCA 1b

ZOTIMET E PËRPUTHSHMËRISË TË AGJENCISË SË ZBATIMIT TË PROJEKTT

1. Përkufizimet

“Praktikë shtrënguese” dëmtimi apo lëndimi ose kërcënimi për të dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ndonjë person apo pronë të personit për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme në veprimet e një personi;

“Praktikë e fshehtë” një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër;

“Praktikë korruptive” premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, insistimi për të dhënë, marrja, pranimi ose kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çfarëdolloj natyre, për apo nga ndonjë person, me qëllim ndikimin në veprimet e një personi apo pengimin e ndonjë personi për të vepruar.

“Kategoritë e përcaktuara të veprave penale” kategoritë e mëposhtme të veprave penale, të përcaktuara sipas rekomandimeve të FATF-së dhe shënimit përkatës interpretues: pjesëmarrja në një grup kriminal të organizuar dhe shantazhim; terrorizmi, duke përfshirë financimin e terrorizmit; trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabandimi i emigrantëve; shfrytëzimi seksual, duke përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve; trafikimi i paligjshëm i lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope; trafikimi i paligjshëm i armëve; trafikimi i paligjshëm i mallrave të vjedhura dhe i mallrave të tjera; korrupsioni dhe mitmarrja/mitdhënia; mashtrimi; falsifikimi i monedhës; falsifikimi dhe pirateria e produkteve; krimi mjedisor; vrasja, lëndimi i rëndë trupor; rrëmbimi; mbajtja e paligjshme me forcë dhe pengmarrja; grabitja ose vjedhja; kontrabandimi (duke përfshirë edhe në lidhje me taksat dhe tarifatat doganore dhe akcizat); krimet tatimore (të lidhura me taksat direkte dhe të tërthorta); zhvatja; falsifikimi, pirateria; manipulimi i tregut dhe tregtimi i brendshëm.

“Rekomandimet e FATF-së”, rekomandime të tilla që përcaktohen herë pas here nga Task-Forca e Veprimeve Financiar (FATF). FATF-ja është organi ndërqeveritar, qëllimi i së cilës është hartimi dhe nxitja e politikave kombëtare dhe ndërkombëtare për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

“Praktikë mashtruese” nënkupton çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqinterpretim, që me qëllim ose nga pakujdesia çorienton ose synon të çorientojë një palë në kuadrin e përfuturit të një përfuturi financiar ose shmangies së një detyrimi;

“Origjinë e paligjshme” origjina e fondeve të përfuturuar me anë të:

- a) ndonjë vepër penale të listuar në kategoritë e caktuara të veprave penale;
- b) ndonjë praktike korruptive;
- c) ndonjë praktike mashtruese; ose
- d) pastrimit të parave.

“Praktikë penguese”: i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e qëllimshme e materialit të provave për hetimin ose dhënia e deklaratave të rreme hetuesve, në mënyrë që të pengohet materialisht një hetim zyrtar për dyshimet për një praktikë korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë, ose kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi i ndonjë pale për ta parandaluar atë nga zbulimi i njohurive të saj për çështje që lidhen me hetimin apo ndjekjen e hetimit; ose ii. çdo veprim i synuar për të penguar materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar kontraktualisht, në lidhje me një hetim zyrtar për dyshimet e një praktike korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë.

“Person”, çdo person fizik, person juridik, partneritet ose shoqatë e pathemeluar.

“Praktikë e sanksionueshme”, çdo praktikë shtrënguese, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktike mashtruese ose praktike penguese (sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje), që: i. është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman ose legjislacioni tjetër të zbatueshëm; dhe që ii. ka ose mund të ketë efekt material ligjor ose reputacional mbi këtë Marrëveshje ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së apo zbatimin e saj.

“Sanksionet”, sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese ekonomike,



financiare ose tregtare, të administruara, miratuara apo zbatuara nga ndonjë organ sanksionues.

“Organ sanksionues”, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

“Lista e sanksioneve”, çdo listë e personave, grupeve apo subjekteve të përcaktuara në mënyrë specifike që u nënshtrohen sanksioneve, e lëshuar nga ndonjë organ sanksionues.

2. Sipërmarrja në lidhje me informacionin

Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) i vë në dispozicion KfW-së menjëherë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që lidhet me “njohjen e klientit” apo informacione të ngjashme për Përfituesin apo ndonjë prej (në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë) aksionarëve, filialeve dhe ndonjë bashkëpunëtori tjetër të tij (nëse ka ndonjë) që KfW-ja mund të kërkojë;

b) i ofron KfW-së menjëherë, sipas kërkesës, të gjithë informacionin dhe dokumentet e lidhura me Projektin, të Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe palëve të saj (nën)kontraktuese dhe palëve të tjera përkatëse, tek të cilat KfW-ja bazohet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e praktikave të sanksionueshme, pastrimit të parave ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me Agjencinë e Zbatimit të Projektit, që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) informon KfW-në menjëherë dhe me pëlqimin e saj, sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi nga Agjencia e Zbatimit të Projektit, anëtarët e organeve të saj të menaxhimit, organeve të tjera qeverisëse apo aksionarëve të saj;

d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet për Projektin dhe ecurinë e tij të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së, për qëllimet e kësaj shtojce;

e) u mundëson KfW-së dhe agentëve të saj inspektimin në çdo kohë të të gjithë dokumentacionit tjetër të lidhur me Projektin, të Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe palëve të saj (nën)kontraktuese apo palëve të tjera të lidhura me të dhe kryerjen e vizitave në Projekt dhe në të gjitha instalimet përkatëse, për qëllimet e kësaj shtojce.

f) informon KfW-në menjëherë dhe me pëlqimin e saj për çdo rast që mund të sjellë

klasifikimin ekzistues ose të mundshëm të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, anëtarëve të organeve të saj të menaxhimit ose organeve të tjera qeverisëse apo aksionarëve të saj, si shtetas me emërtim të veçantë ose personave apo subjekteve të bllokuar, të renditur në ndonjë lloj liste sanksionesh.

3. Përfaqësimet dhe garancitë

3.1 Për sa i përket legjislacionit gjerman ose vendit të themelimit të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, kjo e fundit përfaqëson dhe garanton se janë të vërteta dhe të sakta sa më poshtë:

a) në lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Agjencia e Zbatimit të Projektit vepron në emrin e saj dhe për llogari vet;

b) në dijeni të saj dhe vetëm në lidhje me aksionarët që njihen nga Agjencia e Zbatimit të Projektit, sipas rregulloreve të zbatueshme të bursës, as kapitali i Agjencisë së Zbatimit të Projektit, as fondet e investuara në Projekt nuk kanë Burim të Paligjshëm.

c) Agjencia e Zbatimit të Projektit, bashkëpunëtorët, filialet apo asnjë person tjetër që vepron në emër të saj nuk ka kryer apo nuk është angazhuar në praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi.

d) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk: i. ka lidhur ndonjë marrëdhënie biznesi me shtetas me emërtim të veçantë apo persona dhe subjekte të bllokuar të renditur në ndonjë lloj liste sanksionesh; ose nuk ii. është angazhuar në veprimtari të tjera që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

3.2. Përfaqësimet dhe garancitë e përcaktuara në këtë nen jepen për herë të parë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ato konsiderohen të përsëritura me çdo tërheqje Granti, duke iu referuar rrethanave mbizotëruese në atë datë.

4. Sipërmarrjet pozitive

Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr:

a) të përmbushë plotësisht standardet kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në përputhje me rekomandimet e FATF-së dhe të zbatojë, respektojë dhe përmirësojë, nëse është e nevojshme, standardet dhe udhëzimet e brendshme (duke përfshirë pa kufizim, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve ndaj klientit), të nevojshme për shmangien e praktikave të sanksionueshme, akteve të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit; dhe



b) sapo Agjencia e Zbatimit të Projektit ose KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash apo financim terrorizmi, bashkëpunon plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Agjencia e Zbatimit të Projektit i përgjigjet menjëherë dhe me detaje të arsyeshme çdo njoftimi të KfW-së dhe ofron mbështetje dokumentuese për këtë përgjigje, me kërkesë të KfW-së.

5. Sipërmarrjet negative

Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr:

a) të sigurojë se kapitali apo fondet e tjera që investon nuk kanë Burim të Paligjshëm;

b) të sigurojë se biznesi i saj nuk shkakton praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi; dhe

c) të mos lidhë apo të mos vijoje asnjë marrëdhënie biznesi me shtetas me emërtim të veçantë, persona ose subjekte të bllokuar, të renditur në ndonjë listë sanksionesh ose të mos angazhohet në veprimtari të tjera që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

VENDIM

Nr. 29, datë 20.1.2021

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT TË BASHKIMIT EVROPIAN, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË (PËRFITUESI), DHE KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW), PËR BASHKIMIN EVROPIAN, PËR NJË MJEDIS MË TË PASTËR – MBËSHTETJE PËR TRAJTIMIN E KANALIZIMEVE TË UJËRAVE TË ZEZA, NË SHUMËN 23 300 000 EURO

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit të Bashkimit Evropian, ndërmjet Republikës së Shqipërisë,

përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përfituesi) dhe KfW Frankfurt Am Main (KfW), për Bashkimin Evropian, për një mjedis më të pastër – mbështetje për trajtimin e kanalizimeve të ujërave të zeza, në shumën 23 300 000 (njëzet e tre milionë e treqind mijë) euro, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR

Erion Braçe

MARRËVESHJE GRANTI E BE-SË E DATË 18.12.2020 NDËRMJET KfW, FRANKFURT AM MAIN (“KfW”) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË (“PËRFITUESI”) PËR SHUMËN 23,300,000.00 EURO

- BE për Mjedis më të Pastër – Mbështetje për Trajtimin e Kanalizimeve të Ujërave të Zeza -

ID e Kontratës: IPA 2019/412-150

Projekti nr.: 39692

Në bazë të Marrëveshjes së Kontributit, të datës 13 dhjetor 2019 ndërmjet Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga Komisioni Evropian (“Komisioni Evropian”) dhe KfW-së mbi një shumë maksimale deri 23,300,000 EURO (“Marrëveshja e Kontributit”) dhe që konfirmon se respektimi i të drejtave të njeriut dhe i legjislacionit të zbatueshëm mjedisor, duke përfshirë marrëveshjet shumëpalëshe mjedisore, si edhe standardet themelore të punës të rëna dakord ndërkombëtarisht, përbëjnë një element thelbësor të kësaj Marrëveshjeje, me anë të kësaj Përfituesi dhe KfW-ja lidhin Marrëveshjen e mëposhtme të Grantit (“Marrëveshja e Grantit e BE-së”).

Kjo Marrëveshje Granti e BE-së është pjesë e Programit të Investimeve dhe Performancës së Sektorit të Ujit (WPIP). Programi do të zbatohet me anë të kësaj Marrëveshjeje Granti të BE-së, Marrëveshjes së Huas (“Marrëveshja e Huas”), një Marrëveshjeje Granti (“Marrëveshja e Grantit të Investimit”), një Marrëveshjeje Granti për masat shoqëruuese (“Marrëveshja e Grantit Shoqëruues”) dhe Marrëveshjes së Grantit të financuar nga



SECO (“Marrëveshja e Grantit SECO”), të gjitha të së njëjtës datë me të kësaj.

Neni 1

Shuma dhe qëllimi i Grantit

1.1 KfW-ja i ofron Përfituesit një grant që nuk kalon shumë

23,300,000.00 EURO

(“Granti i BE-së”)

Ky Grant nuk është i shlyeshëm, përveç kur përcaktohet ndryshe në nenin 4.2.

1.2 Në kuadrin e këtij Programi, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës dhe Kanalizimeve, do të veprojë si njësi e koordinimit të programit (“Njësia e Koordinimit të Programit” ose “NJKP”) për drejtimin, koordinimin dhe zbatimin e përgjithshëm të projektit, si dhe për kontraktimin dhe kryerjen e shërbimeve të konsulencës dhe shoqëritë e shërbimeve të ujësjetës UK Berat–Kuçovë, UK Elbasan, UK Fier, UK Kamzë, UK Lezhë, UK Shkodër dhe UK Vlorë do të veprojnë si Agjenci të Zbatimit të Projektit (secila si “AZP”, bashkërisht si “AZP-të”).

Përfituesi, nëpërmjet MIE/NJKP-së, në kuadrin e Programit, do të garantojë që AZP-të të përdorin pjesë të fondeve të Grantit të BE-së ekskluzivisht për financimin e investimeve për përmirësimin e sistemeve të ujësjetës dhe kanalizimeve në qytetin përkatës (secili **“Projekt”**) dhe kryesisht për të financuar kostot e këmbimit valutor. Përfituesi, nëpërmjet NJKP-së, përdor pjesën e mbetur të fondeve të Grantit të BE-së për financimin e shërbimeve të konsulencës në lidhje me: i) zbatimin e Programit; dhe ii) forcimin institucional.

MIE/NJKP-ja, AZP-të dhe KfW-ja përcaktojnë detajet e Programit dhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga Granti i BE-së me anë të një marrëveshjeje të veçantë, e cila do të siglohet si e pranuar nga Përfituesi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (“Marrëveshja e Veçantë”).

1.3 Taksat dhe detyrimet e tjera publike do të mbulohen nga Përfituesi ose ndonjë Agjenci e Zbatimit të Projektit dhe tatimet e importit nuk do të financohen nga Granti i BE-së.

Neni 2

Kanalizimi i Grantit të BE-së për agjencitë e zbatimit të projektit të Grantit të BE-së

2.1 Përfituesi kanalizon Grantin e BE-së (në masën e kërkuar për financimin e masave të investimit të përcaktuar anë nenin 1.2) tek AZP-të si një grant të pashlyeshëm sipas një marrëveshjeje të veçantë granti.

2.2 Para disbusimit të parë nga Granti i BE-së i shumave të kërkuara për financimin e masave të investimit të përcaktuara në nenin 1.2, Përfituesi i jep KfW-së një përkthim të vërtetuar në gjuhën angleze ose gjermane të marrëveshjes së përmendur në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i Grantit të BE-së nuk përbën ndonjë detyrim të agjencive të zbatimit të projekteve ndaj KfW-së për detyrimet e pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje Granti të BE-së.

Neni 3

Disbursimi

3.1 KfW-ja e disburson Grantin e BE-së në përputhje me progresin e Programit dhe me kërkesë të Përfituesit, nëpërmjet MIE/NJKP-së. Me anë të Marrëveshjes së Veçantë që do të siglohet nga Përfituesi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, NJKP-ja, Agjencitë e Zbatimit të Projekteve dhe KfW-ja përcaktojnë procedurën e disbusimit, në veçanti dëshmit që vërtetojnë se fondet e disbursuara janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

3.2 Në bazë të nenit 4, KfW-ja do të jetë e detyruar të kryejë disbursime sipas kësaj Marrëveshjeje Granti të BE-së vetëm nëse dhe në masën, që: i) KfW-ja ka marrë fondet korresponduese nga Komisioni Evropian sipas Marrëveshjes së Kontributit; ii) Marrëveshja e Veçantë është lidhur ndërmjet palëve; dhe iii) është përmbushur kushti i përcaktuar sipas nenit 2.2.

3.3 KfW-ja ka të drejtë të refuzojë kryerjen e disbusimeve pas datës **30 qershor 2025**.

Neni 4

Pezullimi i disbursimeve dhe shlyerja

4.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet përveçse nëse:



a) Përfituesi nuk i përmbush detyrimet e tij ndaj KfW-së për pagesat kur kërkohet kryerja e tyre;

b) detyrimet në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Granti të BE-së, Marrëveshjes së Huas, Marrëveshjes së Grantit SECO, Marrëveshjes së Grantit të Investimit, Marrëveshjes së Grantit Shoqërues ose sipas marrëveshjeve të veçanta të lidhura me këtë Marrëveshje, janë shkelur,

c) Përfituesi, nëpërmjet MIE/NJKP-së ose ndonjë Agjencie të Zbatimit të Projektit, nuk mund të provojë se Granti i BE-së është përdorur për qëllimin e përcaktuar,

d) përmbushja e detyrimeve të KfW-së në kuadër të kësaj Marrëveshjeje Granti të BE-së shkel ligjin e zbatueshëm,

e) lindin rrethana të jashtëzakonshme që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, funksionimin ose qëllimin e Programit;

f) Komisioni Evropian pezullon disbursime, plotësisht ose pjesërisht, ose i kërkon KfW-së pezullimin e disbursimeve në bazë të Marrëveshjes së Kontributit, duke përfshirë rastin kur e kërkojnë rrethanat e jashtëzakonshme, në veçanti: i) kur një vendim përkatës i BE-së që identifikon një shkelje të të drejtave të njeriut është miratuar; dhe/ose ii) në rastet kur një krizë përfshin një ndryshim të politikës së BE-së;

g) Komisioni Evropian dërgon një urdhër rikuperimit/kompensimi ndaj KfW-së në bazë të Marrëveshjes së Kontributit ose Marrëveshja e Kontributit nuk është më e vlefshme, e efektshme, e zbatueshme ose ka përfunduar ose

h) Një rast që e mundëson KfW-në që të pezullojë disbursimet, ndodh sipas Marrëveshjes së Huas, Marrëveshjes së Grantit SECO, Marrëveshjes së Grantit të Investimit ose Marrëveshjes së Grantit Shoqërues.

4.2 Nëse ndonjë prej situatave të specifikuara në nenin 4.1 b), c), d) ose g) ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, e cila, megjithatë, duhet të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja,

a) në rastin e përcaktuar në nenin 4.1 b) ose d), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara;

b) në rastin e specifikuar në nenin 4.1 c), mund të kërkojë shlyerje të menjëhershme të atyre shumave që Përfituesi, nëpërmjet MIE/NJKP-së ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit, nuk mund të provojë se janë përdorur për qëllimin e caktuar;

c) në rastin e nenit 4.1 g), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara që Përfituesi ose Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk ka kryer në mirëbesim ose nuk ia ka transferuar një përfituesi të ligjshëm në mënyrë ligjërisht detyruese. Përfituesi nëpërmjet MIE/NJKP kryen ose garanton që Agjencia e Zbatimit të Projektit, në këmbim, do të përfshijë në të gjitha kontratat që do të financohen ose mbështeten me fondet nga provizionet e Grantit të BE-së, duke garantuar që fondet që nuk janë përdorur ose shpenzuar ende në mirëbesim për qëllimet e Programit, do t'i transferohen mbrapsht përfituesit për kthim te KfW-ja.

4.3 Në rast përfundimi të Marrëveshjes së Kontributit, KfW-ja do të konsultohet me Përfituesin dhe nëse sipas opinionit të KfW-së, qëllimi i kësaj Marrëveshjeje Granti të BE-së nuk mund të përmbushet më në mënyrë të efektshme ose të përshtatshme, KfW-ja ka të drejtën e përfundimit të kësaj Marrëveshjeje Granti të BE-së me efekt të menjëhershëm.

4.4 Komisioni Evropian ka të drejtën e vet për masa të drejtpërdrejta rikuperimi ndaj Përfituesit, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme të Bashkimit Evropian, e konfirmuar në këtë mënyrë nga Përfituesi.

Neni 5

Kostot dhe detyrimet publike

Përfituesi mbulon të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që shtohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë për lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Granti të BE-së, si dhe të gjitha kostot e transferimit dhe konvertimit që shtohen në lidhje me disbursimin e Grantit të BE-së.

Neni 6

Deklaratat kontraktuale dhe fuqia e përfaqësimit

6.1 Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe personat e caktuar prej tij ose saj për KfW-në dhe të autorizuar nga nënshkrimet model të vërtetuar prej tij ose saj, përfaqësojnë Përfituesin në të gjitha veprimet e kërkuara për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Granti të BE-së. Prokurat nuk do të skadojnë deri në marrjen nga ana e KfW-së të revokimit të tyre të shprehur nga përfaqësuesi i autorizuar në atë kohë.



6.2 Ndryshimet ose shtesat e kësaj Marrëveshjeje Granti të BE-së, si dhe njoftimet dhe deklaratat e lëshuara nga palët kontraktuese në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Granti të BE-së bëhen me shkrim. Ministri i Financave është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim që duhet miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje Granti të BE-së që cenojnë vetëm periudhën e disponueshmërisë (neni 2.2) nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave. Çdo njoftim apo deklaratë e tillë konsiderohet e marrë sapo të ketë mbërritur në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese përkatëse ose në atë adresë tjetër të palës kontraktuese përkatëse, siç i është njoftuar palës tjetër kontraktuese:

Për KfW-në: KfW

Postfach 11 11 41

60046 Frankfurt am Main

Federal Republic of Germany (Republika Federale e Gjermanisë)

Faks: +49 69 7431-2944

Për Përfituesin: Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3

Tiranë, Shqipëri

Neni 7
Programi

7.1 Përfituesi, nëpërmjet MIE/NJKP-së, do të marrë masa dhe do të kërkojë që AZP-të do të:

a) përgatisin, zbatojnë, operojnë dhe mirëmbajnë Programin në përputhje me praktikat e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike, sipas standardeve mjedisore dhe sociale, dhe kryesisht në përputhje me konceptin e dakordësuar të Programit ndërmjet NJKP-së, AZP-ve dhe KfW-së;

b) i delegojnë përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të Programit inxhinierëve konsulentë të pavarur, të kualifikuar dhe zbatimin e Programit firmave të kualifikuara;

c) realizojnë në çdo kohë masat e prokurimit të përcaktuara në Marrëveshjen e Veçantë, duke përfshirë planin përkatës të prokurimit;

d) mbajnë ose sigurojnë mbajtjen e librave, regjistrave dhe llogarive të sakta dhe të rregullta të zbatimit të Programit, duke specifikuar qartë të

gjitha kostot mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për Programin dhe që identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga ky Grant i BE-së në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtarisht;

e) i mundësojnë përfaqësuesve të KfW-së, Komisionit Evropian, Zyrës Evropiane Antimashtrim (“OLAF”), Gjykatës Evropiane të Audituesve dhe ndonjë organizmi tjetër kompetent evropian që të inspektojnë në çdo kohë librat dhe regjistrat e lartpërmendur, si dhe çdo dokumentacion tjetër që lidhet me zbatimin e Programit;

f) i japin KfW-së brenda dy javësh nga paraqitja e kërkesës, çdo dhe të gjitha informacionet dhe të dhënat për Programin dhe progresin e tij të mëtejshëm, sipas kërkesës së KfW-së ose Komisionit Evropian;

g) marrin masat e përshtatshme për të publikuar faktin se Programi ka marrë financim nga Bashkimi Evropian. Informacioni i dhënë shtypit, si dhe të gjitha materialet e ngjashme publicitare, njoftimet, raportet dhe botimet zyrtare duhet të konfirmojnë se Programi u krye “me financim nga Bashkimi Evropian” dhe duhet të shfaqin logon e BE-së (dymbëdhjetë yje të verdhë në një sfond bojë qielli) në një mënyrë të përshtatshme. Publikimet nga Përfituesi, NJKP-ja ose AZP-të që lidhen me Programin, në çfarëdolloj forme dhe çfarëdolloj mediumi, duke përfshirë internetin, duhet të mbajnë njoftimin e mëposhtëm për mohimin e përgjegjësisë: “Ky dokument u përgatit me asistencën financiare të Bashkimit Evropian. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se reflektojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian”.

7.2 MIE/NJKP-ja, AZP-të dhe KfW-ja përcaktojnë detajet e lidhura me nenin 7.1 nga Marrëveshja e Veçantë, e cila do të siglohet si e pranuar nga Përfituesi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

7.3 Përfituesi, nëpërmjet MIE/NJKP-së, do të marrë masa dhe do të kërkojë që AZP-të do të:

a) sigurojnë financim të plotë të Programit dhe me kërkesë, do t'i japin KfW-së dëshmi që provojnë se kostot e papaguara nga ky Grant i BE-së, janë mbuluar;

b) zbatojnë Programin dhe menaxhojnë Grantin e BE-së me shkallën e duhur profesionale të kujdesit dhe zellit;



c) me pëlqimin e tyre, do të informojnë menjëherë KfW-në për çdo dhe të gjitha rrethanat që mund të përjashtojnë, vonojnë, rrezikojnë ose ndryshe cenojnë zbatimin, operimin, menaxhimin ose qëllimin e Programit;

d) japin dhe veprojnë për të garantuar që ndonjë palë e tretë e interesuar t'i japë KfW-së dhe Komisionit Evropian të drejtën për të përdorur pa pagesë rezultatet e Programit, duke përfshirë raportet dhe dokumentet e tjera të lidhura me të, të cilat u nënshtrohen të drejtave të pronësisë intelektuale ose industriale;

e) lejojnë Komisionin Evropian dhe Gjykatën Evropiane të Audituesve ose përfaqësues të autorizuar që të kryejnë rishikime analizuese dhe kontrole në vend për përdorimin e Grantit të BE-së mbi bazën e dokumenteve mbështetëse të kontabilitetit dhe ndonjë dokumenti tjetër të lidhur me financimin e Programit dhe pjesëmarrjen, sipas kërkesës, në ndonjë mision monitorimi ose vlerësimi ose takim koordinues;

f) bien dakord që OLAF mund të kryejë hetime, duke përfshirë kontrollet dhe inspektimet në vend, në pajtim me dispozitat e përcaktuara nga legjislacioni i BE-së për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së kundër mashtrimit, korrupsionit dhe ndonjë aktiviteti tjetër të paligjshëm;

g) promovojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe respektojnë legjislacionin e zbatueshëm mjedisor, duke përfshirë marrëveshje shumëpalëshe mjedisore, si dhe standarde themelore të punës rëna dakord ndërkombëtarisht;

h) përmbahen nga ndonjë veprim që mund të shkaktojë konflikt interesi. Një konflikt interesi ekziston kur cenohet ushtrimi i paanshëm dhe objektiv i funksioneve të ndonjë personi që zbaton këtë Marrëveshje Granti të BE-së;

i) marrin përsipër të ofrojnë përfaqësues të KfW-së, zyrtarë të Komisionit Evropian, OLAF-it dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve dhe përfaqësuesve të tyre të autorizuar, sipas kërkesës, informacion dhe akses në çdo dokument dhe të dhëna të kompjuterizuara në lidhje me menaxhimin teknik dhe financiar të operacioneve të financuara në bazë të kësaj Marrëveshjeje Granti të BE-së, si dhe t'u japë atyre akses në vende dhe mjedise në të cilat kryhen operacione të tilla. Ata do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar këto kontrole. Dokumentet dhe të

dhënat e kompjuterizuara mund të përfshijnë informacione të cilat Përfituesi ose AZP-të i konsiderojnë konfidenciale, siç rregullohen nga marrëveshja kontraktuale. Një informacion i tillë, pasi i jepet Komisionit Evropian, OLAF-it, Gjykatës Evropiane të Audituesve, ose ndonjë përfaqësuesi tjetër të autorizuar, do të trajtohet në përputhje me rregullat dhe legjislacionin e konfidencialitetit të BE-së. Dokumentet duhet të jenë të aksesueshme dhe të paraqiten në atë mënyrë që lejojnë kontrole, ndërsa Përfituesi dhe AZP-të janë të detyruar ligjërisht të informojnë KfW-në, Komisionin Evropian, OLAF-in ose Gjykatën Evropiane të Audituesve për vendndodhjen e saktë në të cilën mbahen

j) për një periudhë pesë vjeçare nga përfundimi i Programit dhe në çdo rast deri në ndonjë auditim, verifikim, apel, çështje gjyqësore ose ndjekje padie ose hetimi nga OLAF-i në vazhdim, nëse i njoftohet Përfituesit dhe AZP-së përkatëse, është disponuar, mbajtur dhe vënë në dispozicion KfW-së dhe OLAF-it sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje Granti të BE-së i gjithë informacioni përkatës financiar (origjinale ose kopje) i lidhur me Marrëveshjen e Grantit të BE-së dhe ndonjë kontratë të financuar nga Granti i BE-së;

k) garantojnë një mbrojtje të duhur të të dhënave personale. Të dhënat personale:

aa) përpunohen në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente në lidhje me subjektin e të dhënave;

bb) mblidhen për qëllime të specifikuar, të qarta dhe të ligjshme dhe nuk përpunohen më tej në një mënyrë që është e papajtueshme me ato qëllime;

cc) të mjaftueshme, të rëndësishme dhe të kufizuara tekçka është e nevojshme në lidhje me qëllimet për të cilat janë përpunuar;

dd) të sakta dhe kur është e nevojshme, të përditësuara;

ee) të ruajtura në një formë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave për jo më gjatë sesa është e nevojshme për qëllimet për të cilat përpunohen të dhënat personale; dhe

ff) të përpunuara në një mënyrë që garanton sigurinë e duhur të të dhënave personale;

l) informojnë KfW-në nëse, në lidhje me zbatimin e Programit, ndonjë prej tyre ka zbuluar një situatë përjashtimi të përmendur më poshtë ose nëse ka zbuluar një mashtrim dhe/ose parregullsi.



KfW-ja do t'i transmetojë një informacion të tillë Komisionit Evropian, i cili mund ta përdorë këtë informacion për qëllim të Sistemit të Zbulimit të Hershëm dhe Përfshirjes. Përfutuesi dhe AZP-të do të informojnë KfW-në kur ndonjë prej tyre vihet në dijeni se informacioni i transmetuar duhet të korrigjohet, përditësohet ose hiqet. Përfutuesi dhe AZP-të garantojnë që subjekti në fjalë është informuar se të dhënat e tij i janë transmetuar Komisionit Evropian dhe mund të përfshihen në Sistemin e Zbulimit të Hershëm dhe Përfshirjes dhe të publikohen në faqen e internetit të Komisionit Evropian. Ky nen 7.3 l) zbatohet nëse Përfutuesi vihet në dijeni se këto subjekte

aa) ose persona që kanë fuqi përfaqësimi, vendimmarrje ose kontroll mbi to, i janë nënshtruar një vendimi të formës së prerë ose një vendimi administrativ të formës së prerë për mashtrim, korrupsion, përfshirje në një organizatë kriminale, pastrim parash ose vepra penale të lidhura me terrorizmin, punën e fëmijëve ose trafikimin e qenieve njerëzore;

bb) ose persona që kanë fuqi përfaqësimi, vendimmarrje ose kontroll mbi to, i janë nënshtruar një vendimi të formës së prerë ose një vendimi administrativ të formës së prerë për parregullsi që cenon interesin financiar të BE-së;

cc) janë fajtorë për keqpërfaqësim në dhënien e informacionit të kërkuar si kusht pjesëmarrjeje në procedurë ose nëse nuk mund të japin këtë informacion;

dd) i janë nënshtruar një vendimi të formës së prerë ose një vendimi administrativ të formës së prerë që përcakton se subjektet kanë krijuar një subjekt nën një juridiksion të ndryshëm, me synimin e shmangies së detyrimeve fiskale, sociale ose detyrimeve të tjera ligjore të zbatimit të detyrueshëm në juridiksionin e zyrës së tij të regjistruar, administratës qendrore ose vendit kryesor të biznesit; ose

ee) është krijuar me synimin e përshkruar në pikën “dd” më lart, siç përcaktohet nga një vendim i formës së prerë ose një vendim administrativ i formës së prerë; dhe

m) nuk mbështet aktivitete që kontribuojnë në pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, shmangien e taksave, mashtrimin tatimor ose evazionin fiskal.

7.4 Përfutuesi, nëpërmjet MIE/NJKP-së, asiston agjencitë e zbatimit të projektit në përputhje me

praktikat e qëndrueshme inxhinierike dhe financiare në zbatimin e projekteve dhe në përmbushjen e detyrimeve të agjencive të zbatimit të projektit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe në veçanti, i jep agjencive të zbatimit të projektit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e Projekteve.

7.5 Nëse Komisioni Evropian kërkon në mënyrë të arsyeshme performancë, masa ose pajtueshmëri shtesë nga KfW-ja sipas Marrëveshjes së Kontributit, e cila mund të nënkuptojë përshtatjen e Marrëveshjes së Grantit të BE-së dhe/ose Marrëveshjen e Veçantë (duke përfshirë, por pa u kufizuar te reduktimi i Grantit të BE-së), KfW-ja dhe përfutuesi dhe-nëse është e zbatueshme- AZP-të do të negociojnë në mirëbesim ndryshimet e Marrëveshjes së Grantit të BE-së dhe/ose marrëveshjes së veçantë.

7.6 Përfutuesi, nëpërmjet MIE/NJKP-së, ndërmerr dhe do të kërkojë që AZP-të të ndërmarrin për të garantuar se të gjitha detyrimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje Granti të BE-së sipas neneve 7.1 a), d)-g), 7.3 b)-m) dhe 7.5 zbatohen *mutatis mutandis* për të gjitha palët e treta me të cilat ndonjë prej tyre lidh marrëveshje që do të financohen ose mbështeten me fonde nga Granti i BE-së. Përfutuesi do të marrë masa dhe do të kërkojë që AZP-të, si rrjedhojë, do të përfshijnë në të gjitha kontratat e tyre që do të financohen ose mbështeten me fonde nga provizionet e Grantit të BE-së, duke garantuar pajtueshmëri me nenet e lartpërmendura 7.1 a), d)-g), 7.3 b)-m) dhe 7.5 edhe nga ndonjë palë e tillë e tretë.

7.7 Përfutuesi do të marrë masa dhe do të kërkojë që AZP-të do të konfirmojnë se:

a) në asnjë rrethanë ose për asnjë lloj shkak, Komisioni Evropian nuk do të jetë përgjegjës për dëmin ose lëndimin e pësuar nga personeli ose prona e Përfutuesit dhe AZP-ve, ndërsa Programi është duke u realizuar ose si pasojë e Programit. Si rrjedhojë, Komisioni Evropian nuk do të pranojë ndonjë pretendim për kompensim ose rritje në pagesë në lidhje me një dëm ose lëndim të tillë;

b) në asnjë rrethanë ose për asnjë lloj shkak, Komisioni Evropian nuk do të jetë përgjegjës ndaj palëve të treta, duke përfshirë përgjegjësinë për dëmin ose lëndimin e ndonjë lloji, të pësuar prej tyre në lidhje me ose që lindin nga zbatimi i Programit;

c) Përfutuesi dhe AZP-të e çlirojnë Komisionin Evropian nga e të gjithë përgjegjësia e lidhur me



ndonjë pretendim ose padi të ngritur për ose në lidhje me Programin, e kryer nga punonjës të tyre ose individë për të cilët ata punonjës janë përgjegjës, ose si rezultat i një shkeljeje të të drejtave të një pale të tretë në kontekstin e zbatimit të Programit.

Neni 8

Publikimi dhe transferimi i informacionit të lidhur me Programin

8.1 Për të përmbushur parimet e pranuar ndërkombëtarisht për arritjen e transparencës dhe efikasitetit maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë rezultatet e vlerësimit dhe kategorizimit mjedisor dhe social, si dhe raportet e vlerësimit *ex post* (pas Projektit) për Programin dhe financimin e tij gjatë negociatave parakontraktuale, paralelisht me zbatimin e marrëveshjes/ve të lidhur/a me Programin dhe në fazën paskontraktuale (në vijim e referuar si “**Periudha e plotë**”).

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të KfW-së për fushën e tij të biznesit “Banka e Zhvillimit KfW” (<http://transparenz.KfW-entwicklungsbank.de/>).

Publikimi i informacionit (qoftë nga KfW-ja apo palët e treta në përputhje me nenin 8.3 më poshtë) për Programin dhe mënyrën e tij të financimit nuk përfshin asnjë dokumentacion kontraktual ose informacion të hollësishëm sensitiv financiar apo të lidhur me biznesin rreth palëve të përfshira në Program ose në financimin e tij, të tillë si:

- a) informacion për të dhënat e brendshme financiare;
- b) strategjitë e biznesit
- c) udhëzime dhe raporte të brendshme të korporatës;
- d) të dhëna personale për personat fizikë;
- e) vlerësimi i brendshëm i KfW-së për gjendjen financiare të palëve.

8.2 KfW-ja e ndan informacionin e përzgjedhur për Programin dhe mënyrën e tij të financimit gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e përmendura më poshtë, veçanërisht për të siguruar transparencë dhe efikasitet:

- a) filialet e KfW-së;

b) Republikën Federale të Gjermanisë dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë ose subjektet e saj kompetente;

c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin gjerman dypalësh për zhvillim, veçanërisht Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH;

d) organizata ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarët e tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe anëtarët e saj;

e) Komisioni Evropian, OLAF, Gjykata Evropiane e Audituesve dhe çdo organizëm tjetër kompetent evropian;

f) Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike SECO

8.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur për programin dhe financimin e tij gjatë periudhës së plotë me subjektet e mëposhtme, të cilat botojnë seksionet që kanë lidhje me qëllimin:

a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllimet e Nismës së Transparencës së Ndihmës Ndërkombëtare

http://www.bmz.de/de/was_wir_machen/wege/transparenz-fuer-mehr-Wirksamkeit/index.html;

b) Tregu & Investimi Gjerman (GTAI) për qëllimet e informacionit për tregun (<http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/trade.FOO>);

c) OECD-ja për qëllimet e raportimit të flukseve financiare në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim (<http://stats.oecd.org/>);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEval) për qëllimet e vlerësimit të përgjithshëm të bashkëpunimit gjerman për zhvillim, për të garantuar transparencë dhe efikasitet (<http://www.deval.org/de/>);

e) Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike SECO (<http://www.simap.ch>).

8.4 KfW-ja rezervon më tej të drejtën për transferimin (duke përfshirë qëllimet e publikimit) e informacionit për Programin dhe financimin e tij gjatë periudhës së plotë të palët e tjera të treta për të mbrojtur interesat e ligjshme.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja te palët e tjera të treta, nëse interesat e ligjshme të Përfituesit në informacionin që nuk transferohet i tejkalon interesat e KfW-së për transferimin e këtij



informacioni. Interesat e ligjshme të Përfituesit përfshijnë veçanërisht konfidencialitetin e informacionit sensitiv të përmendur në nenin 8.1, i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtën t'iu transferojë informacion palëve të treta, nëse kjo është e nevojshme për shkak të kërkesave statutorë ose rregullatore ose për të ruajtur ose mbrojtur pretendimet ose të drejtat e tjera ligjore në proceset gjyqësore ose administrative.

Neni 9

Dispozita të ndryshme

9.1 Përfituesi ndërmerr të përmbushë në çdo kohë detyrimet e parashtruara në shtojcën 1 a (zotimet e përputhshmërisë së Përfituesit) dhe për të garantuar nëpërmjet MIE/NJKP se agjencitë e zbatimit të projektit angazhohen të përmbushin në çdo kohë detyrimet e parashtruara në shtojcën 1 b (zotimet e përputhshmërisë së Agjencisë së Zbatimit të Projektit).

9.2 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje Granti të BE-së është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara në lidhje me të. Çdo boshllëk ligjor që mund të rrjedhë prej saj plotësohet me një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje Granti të BE-së.

9.3 KfW-ja mund të mos caktojë ose transferojë asnjë pretendim sipas kësaj Marrëveshjeje Granti të BE-së ndaj Komisionit Evropian ose ndonjë pale tjetër të tretë. Përfituesi nuk mund të caktojë, transferojë, premtojë ose hipotekojë pretendime nga kjo Marrëveshje.

9.4 Të gjitha pretendimet e KfW-së sipas kësaj Marrëveshjeje Granti të BE-së do të skadojnë pas njëzet vitesh nga fundi i vitit në të cilin ka lindur ky pretendim dhe në të cilin KfW-ja ka marrë dijeni për rrethanat që përbëjnë një pretendim të tillë ose që mund të kishin marrë dijeni për to pa neglizhencë flagrante.

9.5 Kjo Marrëveshjeje Granti e BE-së rregullohet nga legjislacioni i Republikës Federale të Gjermanisë, me përjashtim të nenit 4.4, i cili rregullohet nga legjislacioni evropian i plotësuar, nëse është e nevojshme nga dispozitat përkatëse të legjislacionit belg. Vendi i përmbushjes është Frankfurt am Main.

9.6 Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshjeje Granti të BE-së do të zgjidhen ekskluzivisht dhe në formë përfundimtare nga një gjykatë arbitrazhi. Në këtë kuadër, do të zbatohen sa më poshtë:

a) Gjykata e arbitrazhit do të përbëhet nga një ose tre arbitra, të cilët do të emërohen dhe do të veprojnë në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), të zbatueshme herë pas here.

b) Procedura e arbitrazhit do të kryhet në Frankfurt am Main. Gjuha e procedurës do të jetë gjuha angleze.

9.7 Kjo Marrëveshjeje Granti e BE-së do të hyjë në fuqi kur KfW-ja të ketë marrë njoftimin me shkrim të Përfituesit se procedurat e brendshme ligjore që do të përmbushen nga Përfituesi, janë përmbushur (data e marrjes pranë KfW-së).

Hartuar në 2 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main,
Sot, më 18.12.2020
KfW

Tiranë,
sot, më 18.12.2020
Republika e Shqipërisë

Emri: ARNE GOOSS
Pozicioni: Përgjegjës
Sektor

Emri: JOCHEN REIK
Pozicioni: Manaxher
Portofoli Senior

Emri: ANILA DENAJ
Pozicioni: Ministër i
Financave dhe
Ekonomisë

Shtojca:

1a – Zotimet e Përfituesit në lidhje me përputhshmërinë

1b – Zotimet e Agjencisë së Zbatimit të Projektit në lidhje me përputhshmërinë

SHTOJCA 1 A ZOTIME PËRPUTHSHMËRIE TË PËRFITUESIT

PËRKUFIZIME

Praktikë shtrënguese: dëmtimi apo lëndimi ose kërcërimi për dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një person apo pronë të ndonjë personi për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme mbi veprimet e një personi;

Praktikë e fshehtë: është një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim



arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër;

Praktikë korruptive: premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, insistimi për të dhënë, marrja, pranimi ose kërkimi, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, i ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çfarëdolloj natyre, për apo nga çdo person, me qëllim ndikimin në veprimet e një personi apo pengimin e atij personi për të vepruar.

Kategoritë e përcaktuara të shkeljeve: kategoritë e mëposhtme të shkeljeve, të përcaktuara sipas rekomandimeve të FATF-së dhe shënimeve përkatëse interpretuese: pjesëmarrja në një grup kriminal të organizuar dhe shantazhim; terrorizmi, duke përfshirë financimin e terrorizmit; trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabandimi i emigrantëve; shfrytëzimi seksual, duke përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve; trafikimi i paligjshëm i lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope; trafikimi i paligjshëm i armëve; trafikimi i paligjshëm i mallrave të vjedhur dhe mallrave të tjerë; korrupsioni dhe mitmarrja/mitdhënia; mashtrimi; falsifikimi i parave; falsifikimi dhe pirateria e produkteve; krimi mjedisor; vrasja, lëndimi i rëndë trupor; rrëmbimi; mbajtja me forcë dhe pengmarrja; grabitja dhe vjedhja; kontrabandimi (duke përfshirë edhe në lidhje me taksat e tarifave doganore dhe akcizat); krimet tatimore (lidhur me taksat direkte dhe indirekte); zhvatja; falsifikimi, pirateria; manipulimi i tregut dhe tregtimi i brendshëm.

Praktikë mashtruese: nënkupton çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqpërfaqësim që çorienton ose synon të çorientojë, qoftë me ose pa dashje, një person me qëllim marrjen e një përfitimi financiar ose shmangien e një detyrimi;

Praktikë penguese: i) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e qëllimshme e provave materiale hetimore ose dhënia e dëshmive të rreme për hetuesit, për të penguar materialisht një hetim zyrtar mbi dyshimet e një praktike korruptive, praktike mashtruese, praktike shtrënguese, praktike të fshehtë ose kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi të një personi për të mos e lejuar atë që të tregojë gjithçka për çështje që lidhen me hetimin, ose nga kryerja e hetimit; ose ii) çdo akt që synon të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar kontraktualisht lidhur

me një hetim zyrtar mbi dyshimet e një praktike korruptive, praktike mashtruese, praktike shtrënguese ose praktike të fshehtë.

Person: një person fizik, person juridik, partneritet apo shoqatë e pathemeluar në formën e korporatës.

Praktikë e sanksionueshme: çdo praktikë shtrënguese, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktike mashtruese, ose praktike penguese (sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje), që: i) është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman ose ligjeve të tjera të zbatueshme; dhe që ii) ka ose mund të ketë efekt material ligjor ose reputacional mbi këtë Marrëveshje ndërmjet Përfituesit dhe KfW-së apo zbatimin e saj.

Sanksione: sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, miratuara apo zbatuara nga organi sanksionues.

Organ sanksionues: Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian ose Republika Federale e Gjermanisë.

Listë e sanksioneve: çdo listë e personave, grupeve apo subjekteve të përcaktuara në mënyrë specifike që i nënshtrohen sanksioneve, e lëshuar nga ndonjë organ sanksionues.

SIPËRMARRJA LIDHUR ME INFORMACIONIN

Përfituesi nëpërmjet MIE/NJKP

a) i vë në dispozicion KfW-së menjëherë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që lidhet me “njohjen e klientit” apo informacione të ngjashme për Përfituesin që KfW-ja mund të kërkojë;

b) i ofron KfW-së menjëherë, sipas kërkesës, të gjithë informacionin dhe dokumentet e lidhura me Projektin, të Përfituesit dhe palëve të tij (nën)kontraktuese dhe palëve të tjera përkatëse, të cilat KfW-ja bazohet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e praktikave të sanksionueshme, pastrimin e parave, ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me Përfituesin që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) informon KfW-në menjëherë dhe me pëlqimin e tij, sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi të lidhur me Projektin;



d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi Projektin dhe ecurinë e tyre të mëtejshme, siç KfW-ja mund të kërkojë, për qëllimet e kësaj shtojce; dhe

e) i mundëson KfW-së dhe agjentëve të saj, në çdo kohë, inspektimin e të gjithë dokumentacionit tjetër të Përfituesit dhe palëve të tij (nën) kontraktuese apo palëve të tjera të lidhura me të mbi Projektin dhe kryerjen e vizitave në Projekt dhe në të gjitha instalimet përkatëse, për qëllimet e kësaj shtojce.

PËRFAQËSIMI DHE GARANCIA

Për sa i përket legjislacionit gjerman apo legjislacionit të vendit të Përfituesit, ky i fundit shprehet se asnjë prej personave që vepron në emër të Përfituesit për Projektin, nuk ka kryer ose nuk është angazhuar në praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi.

Përfaqësimi dhe garancia e përcaktuar në këtë nen jepen për herë të parë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ato do të konsiderohen të përsëritura me çdo tërheqje të Grantit, duke iu referuar rrethanave mbizotëruese në atë datë.

SIPËRMARRJET POZITIVE

Përfituesi ndërmerr të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj sapo Përfituesi apo KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash, apo financim terrorizmi, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Në veçanti, Përfituesi i përgjigjet menjëherë dhe në detaje të arsyeshme çdo njoftimi të KfW-së dhe ofron mbështetje dokumentuese për këtë përgjigje, me kërkesë të KfW-së.

SIPËRMARRJET NEGATIVE

Përfituesi nuk lidh transaksione apo nuk angazhohet në veprimtari të tjera lidhur me Projektin që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

SHTOJCA 1 B

AKTET E PËRPUTHSHMËRISË SË AGJENCISË SË ZBATIMIT TË PROJEKTT

PËRKUFIZIMET

Praktikë shtrënguese: dëmtimi apo lëndimi ose kërcënim i për dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ndonjë person apo pronë të personit për të ndikuar në mënyrë të

papërshtatshme në veprimet e një personi;

Praktikë e fshehtë: një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër;

Praktikë korruptive: premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, insistimi për të dhënë, marrja, pranimi ose kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çfarëdolloj natyre, për apo nga ndonjë person, me qëllim ndikimin në veprimet e një personi apo pengimin e ndonjë personi për të vepruar.

Kategoritë e përcaktuara të veprave penale: kategoritë e mëposhtme të veprave penale, të përcaktuara sipas rekomandimeve të FATF-së dhe shënimit përkatës interpretues: pjesëmarrja në një grup kriminal të organizuar dhe shantazhim; terrorizmi, duke përfshirë financimin e terrorizmit; trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabandimi i emigrantëve; shfrytëzimi seksual, duke përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve; trafikimi i paligjshëm i lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope; trafikimi i paligjshëm i armëve; trafikimi i paligjshëm i mallrave të vjedhur dhe mallrave të tjerë; korrupsioni dhe mitmarrja/mitdhënia; mashtrimi; falsifikimi i monedhës; falsifikimi dhe pirateria e produkteve; krimi mjedisor; vrasja, lëndimi i rëndë trupor; rrëmbimi; mbajtja e paligjshme me forcë dhe pengmarrja; grabitja ose vjedhja; kontrabandimi (duke përfshirë edhe në lidhje me taksat dhe tarifatat doganore dhe akcizat); krimet tatimore (të lidhura me taksat direkte dhe të tërthorta); zhvatja; falsifikimi, pirateria; manipulimi i tregut dhe tregtimi i brendshëm.

Rekomandimet e FATF-së: rekomandime të tilla që përcaktohen herë pas here nga Task Forca e Veprimit Financiar (FATF). FATF është organi ndërqeveritar, qëllimi i të cilës është hartimi dhe nxitja e politikave kombëtare dhe ndërkombëtare për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Praktikë mashtruese: nënkupton çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqinterpretim që me qëllim ose nga pakujdesia çorienton ose synon të çorientojë një palë në kuadrin e përfuturit



të një përfitimi financiar ose shmangies së një detyrimi;

Origjinë e paligjshme: origjina e fondeve të përftuara me anë të

- a) ndonjë vepër penale të listuar në kategoritë e caktuara të veprave penale;
- b) ndonjë praktike korruptive;
- c) ndonjë praktike mashtruese; ose
- d) pastrimit të parave.

Praktikë penguese: i) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e qëllimshme e materialit të provave për hetimin ose dhënia e deklaratave të rreme hetuesve, në mënyrë që të pengohet materialisht një hetim zyrtar për dyshimet për një Praktikë Korruptive, Mashtruese, Shtrenguese ose të Fshehtë, ose kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi i ndonjë pale për ta parandaluar atë nga zbulimi i njohurive të saj për çështje që lidhen me hetimin apo ndjekjen e hetimit, ose ii) çdo veprim i synuar për të penguar materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar kontraktualisht në lidhje me një hetim zyrtar për dyshimet e një praktike korruptive, mashtruese, shtrenguese ose të fshehtë.

Person: çdo person fizik, person juridik, partneritet ose shoqatë e pathemeluar.

Praktikë e sanksionueshme: çdo praktikë shtrenguese, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktike mashtruese ose praktike penguese (sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje), që: i) është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman ose legjislacioni tjetër të zbatueshëm; dhe që ii) ka ose mund të ketë efekt material ligjor ose reputacional mbi këtë Marrëveshje ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së apo zbatimin e saj.

Sanksionet: sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot apo masat shtrenguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, miratuara apo zbatuara nga ndonjë organ sanksionues.

Organ sanksionues: Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

Lista e sanksioneve: çdo listë e personave, grupeve apo subjekteve të përcaktuara në mënyrë specifike që i nënshtrohen Sanksioneve, e lëshuar nga ndonjë organ sanksionues.

SIPËRMARRJA NË LIDHJE ME INFORMACIONIN

Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) i vë në dispozicion KfW-së menjëherë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që lidhet me “njohjen e klientit” apo informacione të ngjashme për Agjencinë e Zbatimit të Projektit [ndonjë prej filialeve të saj] [Grupit] që KfW-ja mund të kërkojë;

b) i ofron KfW-së menjëherë, sipas kërkesës, të gjithë informacionin dhe dokumentet e lidhura me Projektin, të Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe palëve të saj (nën)kontraktuese dhe palëve të tjera përkatëse, të cilat KfW-ja bazohet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e praktikave të sanksionueshme, pastrimit të parave ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me Agjencinë e Zbatimit të Projektit që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) informon KfW-në menjëherë dhe me pëlqimin e saj, sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi nga Agjencia e Zbatimit të Projektit, anëtarët e organeve të saj të menaxhimit, organeve të tjera qeverisëse apo aksionerëve të saj;

d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet për Projektin dhe ecurinë e tij të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së, për qëllimet e kësaj Shtojce;

e) i mundëson KfW-së dhe agentëve të saj inspektimin në çdo kohë të të gjithë dokumentacionit tjetër të lidhur me Projektin, të Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe palëve të saj (nën)kontraktuese apo palëve të tjera të lidhura me të dhe kryerjen e vizitave në Projekt dhe në të gjitha instalimet përkatëse, për qëllimet e kësaj Shtojce.

f) informon KfW-në menjëherë dhe me pëlqimin e saj për çdo rast që mund të sjellë klasifikimin ekzistues ose të mundshëm të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, anëtarëve të organeve të saj të menaxhimit ose organeve të tjera qeverisëse apo aksionerëve të saj, si shtetas me emërtim të veçantë, ose personave apo subjekteve të bllokuar, të renditur në ndonjë lloj liste sanksionesh.

**PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË**

Për sa i përket legjislacionit gjerman ose vendit të themelimit të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, kjo e fundit përfaqëson dhe garanton se janë të vërteta dhe të sakta sa më poshtë:

a) Në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Agjencia e Zbatimit të Projektit vepron në emrin e saj dhe për llogari vet.

b) Në dijeni të saj dhe vetëm në lidhje me aksionerët që njihen nga Agjencia e Zbatimit të Projektit sipas rregulloreve të zbatueshme të bursës, as kapitali i Agjencisë së Zbatimit të Projektit, as fondet e investuara në projekt nuk kanë burim të paligjshëm.

c) Agjencia e Zbatimit të Projektit, bashkëpunëtorët, filialet apo asnjë person tjetër që vepron në emër të saj nuk ka kryer apo nuk është angazhuar në praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi.

d) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk: i) ka lidhur ndonjë marrëdhënie biznesi me shtetas me emërtim të veçantë apo persona dhe subjekte të bllokuar të renditur në ndonjë lloj liste sanksionesh; ose nuk: ii) është angazhuar në veprimtari të tjera që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

Përfaqësimet dhe garancitë e përcaktuara në këtë nen jepen për herë të parë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ato konsiderohen të përsëritura me çdo tërheqje Granti, duke iu referuar rrethanave mbizëtoruese në atë datë.

SIPËRMARRJET POZITIVE

Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr të:

a) përmbushë plotësisht standardet kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në përputhje me rekomandimet e FATF-së dhe të zbatojë, respektojë dhe përmirësojë, nëse është e nevojshme, standardet dhe udhëzimet e brendshme (duke përfshirë pa kufizim, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve ndaj klientit), të nevojshme për shmangien e praktikave të sanksionueshme, akteve të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit; dhe

b) sapo Agjencia e Zbatimit të Projektit ose KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash apo financim terrorizmi, bashkëpunon plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Agjencia e Zbatimit të Projektit i përgjigjet

menjëherë dhe me detaje të arsyeshme çdo njoftimi të KfW-së dhe ofron mbështetje dokumentuese për këtë përgjigje, me kërkesë të KfW-së.

SIPËRMARRJET NEGATIVE

Agjencia e Zbatimit të Projektit, ndërmerr të:

a) sigurojë se kapitali apo fondet e tjera që investon nuk kanë burim të paligjshëm;

b) sigurojë se biznesi i saj nuk shkakton praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi; dhe

c) mos lidhë apo të mos vijojë asnjë marrëdhënie biznesi me shtetas me emërtim të veçantë, persona ose subjekte të bllokuar, të renditur në ndonjë listë sanksionesh ose të mos angazhohet në veprimtari të tjera që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

VENDIM

Nr. 30, datë 20.1.2021

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
GRANTIT SHOQËRUES NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE EKONOMISË
(PËRFITUESI), DHE KfW FRANKFURT
AM MAIN (KfW), PËR MASAT
SHOQËRUESE PËR PROGRAMIN E
INFRASTRUKTURËS BASHKIAKE V, NË
SHUMËN 3 000 000 EURO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

Miratimin e marrëveshjes së grantit shoqërues ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përfituesi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për masat shoqëruese për programin e infrastrukturës bashkiake V, në shumën 3 000 000 (tre milionë) euro, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**



**MARRËVESHJE E GRANTIT
SHOQËRUES,
E DATËS 18.12.2020, NDËRMJET KFW,
FRANKFURT AM MAIN (KFW) DHE
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE (PËRFITUESI), PËR
SHUMËN 3,000,000.00 EURO**

Masat Shoqëruese për Programin për
Infrastrukturën Bashkiakë V - BMZ-Nr. 2013 70
352

Pikat

1. Shuma dhe qëllimi i Grantit
2. Disbursimi
3. Pezullimi i disbursimit dhe shlyerja
4. Kostot dhe tarifat publike
5. Deklaratat kontraktuale dhe tagrat e përfaqësimit
6. Shërbimet e Ekspertit
7. Publikimi dhe transferimi i informacionit të lidhur me shërbimet e Ekspertit
8. Dispozita të ndryshme

Zotimet e përputhshmërisë

Mbi bazën e Marrëveshjes të datës 11 tetor 2019 ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi Bashkëpunimin Financiar (Marrëveshja Qeveritare), Përfituesi dhe KfW-ja lidhin Marrëveshjen e mëposhtme të grantit (Marrëveshja e Grantit Shoqërues).

Kjo Marrëveshje është pjesë e Programit të Infrastrukturës Bashkiakë V (Programi). Programi do të zbatohet me anë të kësaj Marrëveshjeje të Grantit Shoqërues, marrëveshjes së huas (Marrëveshja e Huas), marrëveshjes së grantit (Marrëveshja e Grantit të Investimit), marrëveshjes së grantit të financuar nga SECO (Marrëveshja e Grantit SECO), marrëveshjes së grantit të financuar nga BE-ja (Marrëveshja e Grantit të BE-së), të gjitha të së njëjtës datë me këtë.

1. Shuma dhe qëllimi i Grantit

1.1 KfW-ja i ofron Përfituesit një grant që nuk kalon shumën 3,000,000.00 (Granti Shoqërues).

Ky Grant nuk është i shlyeshëm, përveç kur përcaktohet ndryshe në nenin 3.2.

1.2 Në kuadrin e këtij Programi, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës dhe të Kanalizimeve ("Njësia e Koordinimit të

Programit" ose "NJKP"), do të veprojë si njësia e koordinimit të programit dhe shoqëritë e shërbimeve të ujësjetës UK Berat-Kuçovë, UK Elbasan, UK Fier, UK Kamzë, UK Lezhë, UK Shkodër dhe UK Vlorë do të veprojnë si Agjenci të Zbatimit të Projektit (secila si "AZP", bashkërisht si "AZP-të").

Përfituesi, nëpërmjet MIE/NJKP-së, do të përdorë Grantin Shoqërues ekskluzivisht për shërbimet e konsulencës për forcimin institucional të Programit (Shërbimet e Ekspertit) dhe kryesisht për të financuar kostot e këmbimit valutor. Këto shërbime do të kryhen nga "Konsulentë institucionale" për NJKP-në.

MIE/NJKP-ja, AZP-të dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet dhe objektin e shërbimeve që do të financohen nga Granti Shoqërues me anë të një marrëveshjeje të veçantë, e cila do të siglohet si e pranuar nga Përfituesi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrëveshja e Veçantë).

1.3 Kontributet plotësuese që do të jepen nga Përfituesi do të përcaktohen në mënyrë të detajuar në një Marrëveshje të Veçantë. Përfituesi do të japë kontributet e tij plotësuese plotësisht dhe në kohën e duhur. Përfituesi do t'i paraqesë KfW-së, me kërkesë të kësaj të fundit, prova që dëshmojnë masat e marra për këtë qëllim.

1.4 Taksat dhe detyrimet e tjera publike do të mbulohen nga Përfituesi ose ndonjë Agjenci e Zbatimit të Projektit dhe tatimet e importit nuk do të financohen nga Granti Shoqërues.

2. Disbursimi

2.1 KfW-ja e disburson Grantin Shoqërues, në përputhje me progresin e Shërbimeve të Ekspertit dhe me kërkesë të Përfituesit. Me anë të një Marrëveshjeje të Veçantë, Përfituesi dhe KfW-ja përcaktojnë procedurën e disbursimit, në veçanti, dëshmitë që vërtetojnë se fondet e disbursuara janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

2.2 KfW-ja ka të drejtë të refuzojë kryerjen e disbusimeve pas datës 30 qershor 2026.

3. Pezullimi i disbursimeve dhe shlyerja

3.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimit, përveç kur:

a) Përfituesi nuk i përmbush detyrimet e tij ndaj KfW-së për pagesat kur kërkohet kryerja e tyre;

b) janë shkelur detyrimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje të Grantit Shoqërues, Marrëveshjen e Huas, Marrëveshjen e Grantit të Investimit,



Marrëveshjen e Grantit SECO, Marrëveshjen e Grantit të BE-së ose në marrëveshjet e veçanta të lidhura me këtë Marrëveshje të Grantit Shoqërues;

c) Përfituesi, MIE/NJKP-ja, nuk mund të provojë se Granti Shoqërues është përdorur për qëllimin e përcaktuar;

d) përmbushja e detyrimeve të KfW-së, në kuadër të kësaj Marrëveshjeje të Grantit Shoqërues shkel ligjin e zbatueshëm;

e) lindin rrethana të jashtëzakonshme që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin ose qëllimin e Shërbimeve të Ekspertit; ose

f) një ngjarje ka ndodhur që i lejon KfW-së të pezullojë disbursimit, në përputhje me Marrëveshjen e Huas, Marrëveshjen e Grantit të Investimit, Marrëveshjen e Grantit SECO ose Marrëveshjen e Grantit të BE-së.

3.2 KfW-ja mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të Grantit Shoqërues, nëse ndonjë prej situatave të përcaktuara në nenin 3.1(b), (c) dhe (d) ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të caktuar nga KfW-ja, e cila, megjithatë, do të jetë së paku 30 ditë. Në rastin e specifikuar në nenin 3.1(c), shlyerja do të kufizohet në sasi të tilla që Përfituesi nuk është në gjendje të dëshmojë se është përdorur për qëllimin e përcaktuar.

4. Kostot dhe detyrimet publike

Përfituesi mbulon të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që shtohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë për lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje të Grantit Shoqërues, si dhe të gjitha kostot e transferimit dhe konvertimit që shtohen në lidhje me disbursimin e Grantit Shoqërues.

5. Deklaratat kontraktuale dhe tagrat e përfaqësimit

5.1 Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe personat e caktuar prej tij ose saj për KfW-në dhe të autorizuar nga nënshkrimet model të vërtetuara prej tij ose saj, përfaqësojnë Përfituesin në të gjitha veprimet e kërkuara për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Granti Shoqërues. Prokurat nuk do të skadojnë deri në marrjen nga ana e KfW-së të revokimit të tyre të shprehur nga përfaqësuesi i autorizuar në atë kohë.

5.2 Ndryshimet ose shtesat e kësaj Marrëveshjeje të Grantit Shoqërues dhe njoftimet dhe deklaratat e lëshuara nga palët kontraktuese, në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje të Grantit Shoqërues

bëhen me shkrim. Ministri i Financave dhe i Ekonomisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim që duhet miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje të Grantit Shoqërues, që cenojnë vetëm periudhën e disponueshmërisë (neni 2.2) nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave. Çdo njoftim apo deklaratë e tillë konsiderohet e marrë sapo të ketë mbërritur në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese përkatëse ose në atë adresë tjetër të palës kontraktuese përkatëse, siç i është njoftuar palës tjetër kontraktuese:

Për KfW-në:

KfW

Postfach 11 11 41

60046 Frankfurt am Main

Federal Republic of Germany (Republika Federale e Gjermanisë)

Faks: +49 69 7431-2944

Për Përfituesin: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3

Tiranë, Shqipëri

6. Shërbimet e Ekspertit

6.1 Përfituesi, përmes MIE/NJKP-së:

a) përgatit dhe kryen Shërbimet e Ekspertit, në përputhje me praktikën e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike, sipas standardeve mjedisore dhe sociale dhe, kryesisht, në përputhje me konceptin e dakordësuar ndërmjet Përfituesit dhe KfW-së për Shërbimet e Ekspertëve, dhe për këtë qëllim do të përfitojë nga shërbimet e inxhinierëve konsulentë të pavarur, të kualifikuar;

b) zbaton në çdo kohë dispozitat e prokurimit të përcaktuara në Marrëveshjen e Veçantë, duke përfshirë planin përkatës të prokurimit;

c) siguron financimin e plotë të Shërbimeve të Ekspertit dhe pajis KfW-në sipas kërkesës së kësaj të fundit me dëshmi që tregojnë se të gjitha kostot që nuk paguhen nga Granti Shoqërues janë të mbuluara;

d) mban ose siguron mbajtjen e librave dhe regjistrave të saktë dhe të rregullt, duke specifikuar qartë të gjitha kostot lidhur me Shërbimet e Ekspertit dhe që identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga ky Grant Shoqërues;



e) u mundësojnë përfaqësuesve të KfW-së që të inspektojnë në çdo kohë librat dhe regjistrat e lartpërmendur, si dhe çdo dokumentacion tjetër që lidhet me zbatimin e Shërbimeve të Ekspertit;

f) i japin KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe të dhënat për Shërbimet e Ekspertit dhe progresin e tyre të mëtejshëm, sipas kërkesës së KfW-së;

g) me miratimin e tij të shpejtë informon KfW-në për çdo dhe të gjitha rrethanat që parandalojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin e Shërbimeve të Ekspertit ose qëllimin e tyre.

6.2. Detajet e lidhura me nenin 6.1 do të përcaktohen në Marrëveshjen e Veçantë.

7. Publikimi dhe transferimi i informacionit të lidhur me shërbimet e Ekspertit

7.1 Për të përmbushur parimet e pranuar ndërkombëtarisht për arritjen e transparencës dhe të efikasitetit maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë rezultatet e vlerësimit dhe kategorizimit mjedisor dhe social, si dhe raportet e vlerësimit *ex post* (pas projektit) për Shërbimet e Ekspertit dhe financimin e tyre gjatë negociatave parakontraktuale, paralelisht me zbatimin e marrëveshjes/ve të lidhur/a me shërbimet e ekspertit dhe në fazën paskontraktuale (në vijim e referuar si “Periudha e Plotë”).

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të KfW-së për fushën e tij të biznesit “Banka e Zhvillimit KfW” (<http://transparenz.KfW-entwicklungsbank.de/>).

Publikimi i informacionit (qoftë nga KfW-ja apo palët e treta, në përputhje me nenin 7.3 më poshtë) për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën e tij të financimit nuk përfshin asnjë dokumentacion kontraktual ose informacion të hollësishëm sensitiv financiar apo të lidhur me biznesin rreth palëve të përfshira në Program ose në financimin e tij, të tillë si:

- a) informacion për të dhënat e brendshme financiare;
- b) strategjitë e biznesit;
- c) udhëzime dhe raporte të brendshme të korporatës;
- d) të dhëna personale për personat fizikë;
- e) vlerësimi i brendshëm i KfW-së për gjendjen financiare të palëve.

7.2 KfW-ja e ndan informacionin e përzgjedhur për Shërbimet e Ekspertit dhe mënyrën e tyre të

financimit gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e përmendura më poshtë, veçanërisht për të siguruar transparencë dhe efikasitet:

a) filialet e KfW-së;

b) Republikën Federale të Gjermanisë dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë ose subjektet e saj kompetente;

c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin gjerman dypalësh për zhvillim, veçanërisht *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH*;

d) organizata ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarët e tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe anëtarët e saj;

e) Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike SECO;

f) Bashkimin Evropian dhe Institucionet e tij.

7.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur për Programin dhe financimin e tij gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e mëposhtme, të cilat botojnë seksionet që kanë lidhje me qëllimin:

a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllimet e Nismës së Transparencës së Ndihmës Ndërkombëtare

(http://www.bmz.de/de/was_wir_machen/wege/transparenz-fuer-mehr-Wirksamkeit/index.html);

b) Tregu dhe Investimi Gjerman (GTAI) për qëllimet e informacionit për tregun (<http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/trade.FOO>);

c) OECD-ja për qëllimet e raportimit të flukseve financiare, në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim (<http://stats.oecd.org/>);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEVal), për qëllimet e vlerësimit të përgjithshëm të bashkëpunimit gjerman për zhvillim, për të garantuar transparencë dhe efikasitet (<http://www.deval.org/de/>);

e) Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike SECO (<http://www.simap.ch>);

f) Bashkimi Evropian dhe Institucionet e tij.

7.4 KfW-ja rezervon më tej të drejtën për transferimin (duke përfshirë qëllimet e publikimit) e informacionit për Shërbimet e Ekspertit dhe financimin e tyre gjatë Periudhës së Plotë te palët e tjera të treta për të mbrojtur interesat e ligjshëm.



Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja tek palët e tjera të treta, nëse interesat e ligjshëm të Përfituesit në informacionin që nuk transferohet i tejkalon interesat e KfW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshëm të Përfituesit përfshijnë veçanërisht konfidencialitetin e informacionit sensitiv të përmendur në nenin 7.1, i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtën t'iu transferojë informacion palëve të treta, nëse kjo është e nevojshme, për shkak të kërkesave statutores ose rregullatore ose për të ruajtur ose për të mbrojtur pretendimet ose të drejtat e tjera ligjore në proceset gjyqësore ose administrative.

8. Dispozita të ndryshme

8.1 Përfituesi ndërmerr të përbushë në çdo kohë detyrimet e parashtruara në shtojcën (Zotimet e përputhshmërisë).

8.2 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje të Grantit Shoqërues është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara në lidhje me të. Çdo boshllëk ligjor që mund të rrjedhë prej saj plotësohet me një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje të Grantit Shoqërues.

8.3 Përfituesi mund të mos caktojë ose transferojë asnjë pretendim sipas kësaj Marrëveshjeje të Grantit Shoqërues.

8.4 Kjo Marrëveshje e Grantit Shoqërues rregullohet nga legjislacioni i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i përbushjes është Frankfurt am Main.

8.5 Marrëdhëniet juridike midis KfW-së dhe Përfituesit të krijuar nga kjo Marrëveshje e Grantit Shoqërues përfundojnë gjashtë vjet pas disbursimit përfundimtar.

8.6 Kjo Marrëveshje e Grantit Shoqërues hyn në fuqi kur KfW-ja të ketë marrë njoftimin me shkrim të Përfituesit se procedurat e brendshme ligjore që do të përbushen nga Përfituesi, janë përfunduar.

Hartuar në 2 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main,
Sot, më 18.12.2020
KfW

Emri: ARNE GOOS
Funksioni: PËRGJEGJËS
SEKTORI

Emri: JOCHEN REIK
Funksioni: MENAXHER
PORTOFOLI SENIOR

Shtojca
Zotimet në lidhje me Përputhshmërinë

SHTOJCA ZOTIMET E PËRPUTHSHMËRISË

1. Përkufizime

“Praktikë Shtrënguese”, dëmtimi apo lëndimi ose kërcënimi për të dëmtuar apo për të lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një person apo pronë të ndonjë personi për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme mbi veprimet e një personi.

“Praktikë e fshehtë” është një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër.

“Praktikë korruptive”, premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, insistimi për të dhënë, marrja, pranimi ose kërkimi, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, i ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çfarëdolloj natyre, për apo nga çdo person, me qëllim ndikimin në veprimet e një personi apo pengimin e atij personi për të vepruar.

“Praktikë mashtruese” nënkupton çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqpërfaqësim që çorienton ose synon të çorientojë, qoftë me ose pa dashje, një person me qëllim marrjen e një përfitimi financiar ose shmangien e një detyrimi.

“Praktikë penguese”: i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e qëllimshme e provave materiale hetimore ose dhënia e dëshmive të rreme për hetuesit, për të penguar materialisht një hetim zyrtar mbi dyshimet e një praktike korruptive, praktike mashtruese, praktike shtrënguese, praktike të fshehtë ose kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi të një personi për të mos



e lejuar atë që të tregojë gjithçka për çështje që lidhen me hetimin ose nga kryerja e hetimit; ose ii. çdo akt që synon të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar kontraktualisht lidhur me një hetim zyrtar mbi dyshimet e një praktike korruptive, praktike mashtruese, praktike shtrënguese ose praktike të fshehtë.

“Person”, një person fizik, person juridik, partneritet apo shoqatë e pathemeluar në formën e korporatës.

“Praktikë e sanksionueshme”, çdo praktikë shtrënguese, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktike mashtruese, ose praktike penguese (sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje), që: i. është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman ose ligjeve të tjera të zbatueshme; dhe që ii. ka ose mund të ketë efekt material ligjor ose reputacional mbi këtë Marrëveshje ndërmjet Përfituesit dhe KfW-së apo zbatimin e saj.

“Sanksione”, sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, miratuara apo zbatuara nga organi sanksionues.

“Organ sanksionues”, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian ose Republika Federale e Gjermanisë.

“Listë e sanksioneve”, çdo listë e personave, grupeve apo subjekteve të përcaktuara në mënyrë specifike që u nënshtrohen sanksioneve, e lëshuar nga ndonjë organ sanksionues.

2. Sipërmarrja lidhur me informacionin

Përfituesi, nëpërmjet MIE/NJKP-së:

a) i vë në dispozicion KfW-së menjëherë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që lidhet me “njohjen e klientit” apo informacione të ngjashme për Përfituesin që KfW-ja mund të kërkojë;

b) i ofron KfW-së menjëherë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin dhe dokumentet e lidhura me Projektin, të Përfituesit dhe palëve të tij (nën)kontraktuese dhe palëve të tjera përkatëse, tek të cilat KfW-ja bazohet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e praktikave të sanksionueshme, pastrimin e parave, ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me Përfituesin që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) informon KfW-në menjëherë dhe me pëlqimin e tij, sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi të lidhur me Projektin;

d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi Projektin dhe ecurinë e tyre të mëtejshme, siç KfW-ja mund të kërkojë, për qëllimet e kësaj shtojce; dhe

e) i mundëson KfW-së dhe agentëve të saj, në çdo kohë, inspektimin e të gjithë dokumentacionit tjetër të Përfituesit dhe palëve të tij (nën)kontraktuese apo palëve të tjera të lidhura me të mbi Projektin dhe kryerjen e vizitave në Projekt dhe në të gjitha instalimet përkatëse, për qëllimet e kësaj shtojce.

3. Përfaqësimi dhe garancia

3.1 Për sa i përket legjislacionit gjerman apo legjislacionit të vendit të Përfituesit, ky i fundit shprehet se asnjë prej personave që vepron në emër të Përfituesit për Projektin, nuk ka kryer ose nuk është angazhuar në praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi.

3.2 Përfaqësimi dhe garancia e përcaktuar në këtë nen jepen për herë të parë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ato do të konsiderohen të përsëritura me çdo tërheqje të Grantit, duke iu referuar rrethanave mbizotëruese në atë datë.

4. Sipërmarrjet pozitive

Përfituesi ndërmerr të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agentët e saj sapo Përfituesi apo KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash apo financim terrorizmi, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Në veçanti, Përfituesi i përgjigjet menjëherë dhe në detaje të arsyeshme çdo njoftimi të KfW-së dhe ofron mbështetje dokumentuese për këtë përgjigje, me kërkesë të KfW-së.

5. Sipërmarrjet negative

Përfituesi nuk lidh transaksione apo nuk angazhohet në veprimtari të tjera lidhur me Projektin që përbëjnë shkelje të sanksioneve.



VENDIM
Nr. 31, datë 20.1.2021

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
GRANTIT SECO NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE EKONOMISË
(PËRFITUESI), DHE KfW FRANKFURT
AM MAIN (KfW), PËR PROGRAMIN E
INFRASTRUKTURËS BASHKIAKE V, NË
SHUMËN 13 300 000 EURO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së Grantit SECO ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Përfituesi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e infrastrukturës bashkiake V, me një grant në shumën 13 300 000 (trembëdhjetë milionë e treqind mijë) euro, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**MARRËVESHJA E GRANTIT SECO,
E DATËS 18.12.2020, NDËRMJET KfW,
FRANKFURT AM MAIN (KfW) DHE
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE EKONOMISË
(PËRFITUESI), PËR SHUMËN
13,300,000.00 EURO
- PROGRAMI PËR INFRASTRUKTURËN
BASHKIAKE V**

Parathënie

Programi “Programi për Infrastrukturën Bashkiake V” (Programi) do të bashkëfinancohet nga Konfederata Zvicerane (Kontributi Zviceran)

dhe Republika Federale e Gjermanisë (Kontributi Gjerman).

Kontributi Zviceran do t’i vihet në dispozicion Përfituesit përmes KfW-së me anë të kësaj Marrëveshjeje Granti (Marrëveshja e Grantit SECO).

Kontributi gjerman do t’i vihet në dispozicion Përfituesit përmes KfW-së me anë të një marrëveshjeje huaje e datës _____ (Marrëveshja e Huas), marrëveshjes së grantit të datës _____ (Marrëveshja e Grantit të Investimit), si dhe një marrëveshjeje granti për masat shoqëruese të datës _____ (Marrëveshja e Grantit shoqërues), dhe bazohet në marrëveshjen e datës 11 tetor 2019 ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin Financiar (Marrëveshja Qeveritare).

Programi financohet më tej me anë të një marrëveshjeje granti të financuar nga BE-ja të datës _____ (Marrëveshja e Grantit të BE-së).

Baza e kësaj Marrëveshjeje e Grantit SECO është marrëveshja e lidhur ndërmjet Konfederatës Zvicerane, e përfaqësuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe KfW-së, të datës 10 dhjetor 2019 (Marrëveshja e Delegimit).

Bazuar në sa më sipër, Marrësi dhe KfW-ja nënshkruajnë këtë Marrëveshjeje.

Neni 1

Shuma dhe qëllimi i Grantit Zviceran

1.1 KfW-ja i ofron Përfituesit një grant që nuk kalon shumën 13,300,000.00 euro (Granti Zviceran).

Çdo shumë e mundshme e interesit nga Granti Zviceran, i krijuar nga fakti se KfW-ja mban Grantin Zviceran në një llogari të caktuar për SECO-n, mund t’i jepet Përfituesit përveç Grantit Zviceran, në bazë të pëlqimit të SECO-s. Në këtë rast, KfW-ja do ta informojë Përfituesin për ndonjë fond të tillë shtesë në dispozicion të Përfituesit.

Ky Grant Zviceran nuk është i shlyeshëm, përveç kur përcaktohet ndryshe në nenin 3.2.

1.2 Në kuadrin e këtij Programi, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësjellësit dhe të Kanalizimeve (“Njësia e Koordinimit të Programit” ose “NJKP”), do të veprojë si njësia



e koordinimit të programit për drejtimin, koordinimin dhe zbatimin e përgjithshëm të projektit, si dhe për kontraktimin dhe kryerjen e shërbimeve të konsulencës dhe shoqëritë e shërbimeve të ujësjellësit UK Berat-Kuçovë, UK Elbasan, UK Fier, UK Kamzë, UK Lezhë, UK Shkodër dhe UK Vlorë do të vepronjë si agjenci të zbatimit të Projektit (secila si “AZP”, bashkërisht si “AZP-të”).

Përfituesi, nëpërmjet MIE/NJKP-së, në kuadrin e Programit, do të garantojë që AZP-të të përdorin pjesë të fondeve të Grantit Zviceran ekskluzivisht për financimin e investimeve për përmirësimin e sistemeve të ujësjellësit dhe të kanalizimeve në qytetin përkatës (secili “Projekt”) dhe kryesisht për të financuar kostot e këmbimit valutor. Përfituesi, nëpërmjet NJKP-së, përdor pjesën e mbetur të fondeve të Grantit Zviceran për financimin e shërbimeve të konsulencës, në lidhje me: i. zbatimin e Programit; dhe ii. forcimin institucional.

MIE/NJKP-ja, AZP-të dhe KfW-ja përcaktojnë detajet e Programit dhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga Granti Zviceran me anë të një marrëveshjeje të veçantë (Marrëveshja e Veçantë), e cila do të siglohet si e pranuar nga Përfituesi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

1.3 Taksat dhe detyrimet e tjera publike do të mbulohen nga Përfituesi ose ndonjë agjenci e zbatimit të Projektit dhe tatimet e importit nuk do të financohen nga Granti Zviceran.

Neni 2

Kanalizimi i Grantit për agjencitë e zbatimit të Projektit

2.1 Përfituesi kanalizon Grantin Zviceran (në masën e kërkuar për financimin e masave të investimit të përcaktuar në nenin 1.2 tek AZP-të si një grant të pashlyeshëm, sipas një marrëveshjeje të veçantë granti.

2.2 Para disbusimit të parë nga Granti Zviceran i shumave të kërkuara për financimin e masave të investimit të përcaktuara në nenin 1.2, Përfituesi i jep KfW-së një përkthim të vërtetuar në gjuhën angleze ose gjermane të marrëveshjes së përmendur në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i Grantit Zviceran nuk përbën ndonjë detyrim të agjencive të zbatimit të

projekteve ndaj KfW-së për detyrimet e pagesës, sipas kësaj Marrëveshjeje të Grantit SECO.

Neni 3

Disbursimi

3.1 KfW-ja e disburson Grantin Zviceran, në përputhje me progresin e Programit dhe me kërkesë të Përfituesit. Me anë të Marrëveshjes së Veçantë që do të siglohet nga Përfituesi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, NJKP-ja, Agjencitë e Zbatimit të Projekteve dhe KfW-ja përcaktojnë procedurën e disbusimit, në veçanti dëshmitë që vërtetojnë se fondet e disbursuara janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

3.2 KfW-ja ka të drejtë të refuzojë kryerjen e disbusimeve pas datës 30 nëntor 2027.

Neni 4

Pezullimi i disbusimeve dhe shlyerja

4.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbusimit, përveç kur:

a) Përfituesi nuk i përmbush detyrimet e tij ndaj KfW-së për pagesat kur kërkohet kryerja e tyre;

b) detyrimet, në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje të Grantit SECO, Marrëveshjes së Huas, Marrëveshjes së Grantit të Investimit, Marrëveshjes së Grantit të BE-së, Marrëveshjes së Grantit Shoqërues ose sipas marrëveshjeve të veçanta të lidhura me këtë Marrëveshje, janë shkelur,

c) Përfituesi, nëpërmjet MIE/NJKP-së ose ndonjë agjencie të zbatimit të Projektit, nuk mund të provojë se Granti i BE-së është përdorur për qëllimin e përcaktuar;

d) përmbushja e detyrimeve të KfW-së, në kuadër të kësaj Marrëveshjeje shkel ligjin e zbatueshëm;

e) lindin rrethana të jashtëzakonshme që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, funksionimin ose qëllimin e Programit;

f) disbusimet nga SECO në KfW janë pezulluar ose vonuar ose Marrëveshja e Delegimit është përfunduar ose pushon të ketë ndonjë efekt detyrues;

g) Marrëveshja e Huas, Marrëveshja e Grantit të Investimit, Marrëveshja e Grantit të BE-së ose Marrëveshja e Grantit Shoqërues nuk ka hyrë në fuqi, ose ka ndodhur një ngjarje që lejon KfW-në të



pezullojë disbursimit, në përputhje me ndonjë nga marrëveshjet e mësipërme; ose

h) kjo Marrëveshje e Grantit SECO është përfunduar në përputhje me nenin 9.

4.2 Nëse ndonjë prej situatave të specifikuara në nenin 3.1(b), (c), (d) ose (g) ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, e cila, megjithatë, duhet të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja:

a) në rastin e përcaktuar në nenin 3.1(b) ose (d), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara; dhe ii. shlyerje të menjëhershme të shumave të pagueshme në lidhje me këtë Marrëveshje të Grantit SECO;

b) në rastin e specifikuar në nenin 3.1(c), kërkon shlyerjen e menjëhershme të shumave të tilla që Marrësi ose ndonjë PEA nuk është në gjendje të dëshmojë se janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

Neni 5

Kostot dhe detyrimet publike

Përfituesi mbulon të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që shtohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë, për lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje të Grantit SECO, si dhe të gjitha kostot e transferimit dhe konvertimit që shtohen në lidhje me disbursimin e Grantit Zviceran.

Neni 6

Deklaratat kontraktuale dhe tagrat e përfaqësimit

6.1 Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe personat e caktuar prej tij ose saj për KfW-në dhe të autorizuar nga nënshkrimet model të vërtetuara prej tij ose saj, përfaqësojnë Përfituesin në të gjitha veprimet e kërkuara për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje të Grantit SECO. Prokurat nuk do të skadojnë deri në marrjen nga ana e KfW-së të revokimit të tyre të shprehur nga përfaqësuesi i Përfituesit i autorizuar në atë kohë.

6.2 Ndryshimet ose shtesat e kësaj Marrëveshjeje të Grantit SECO, si dhe njoftimet dhe deklaratat e lëshuara nga palët kontraktuese, në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje të Grantit SECO bëhen me shkrim. Ministri i Financave dhe i Ekonomisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim që duhet miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje të

Grantit SECO, që cenojnë vetëm periudhën e disponueshmërisë (neni 3.2) nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave. Çdo njoftim apo deklaratë e tillë konsiderohet e marrë sapo të ketë mbërritur në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese përkatëse ose në atë adresë tjetër të palës kontraktuese përkatëse, siç i është njoftuar palës tjetër kontraktuese.

Për KfW-në: KfW

Postfach 11 11 41

60046 Frankfurt am Main

Federal Republic of Germany (Republika Federale e Gjermanisë)

Për Përfituesin: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3

Tiranë, Shqipëri

Neni 7

Programi

7.1 Përfituesi, nëpërmjet MIE/NJKP-së do të marrë masa dhe do të kërkojë që AZP-të do të:

a) përgatisin dhe zbatojnë Projektet, në përputhje me praktikën e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike, sipas standardeve mjedisore dhe sociale dhe, kryesisht, në përputhje me konceptin e dakordësuar të Programit ndërmjet Përfituesit dhe KfW-së;

b) u delegojnë përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të Programit inxhinierëve konsulentë të pavarur, të kualifikuar dhe zbatimin e Projekteve firmave të kualifikuara;

c) zbatojnë në çdo kohë dispozitat e prokurimit të përcaktuara në Marrëveshjen e Veçantë, duke përfshirë planin përkatës të prokurimit;

d) mbajnë ose sigurojnë mbajtjen e librave, regjistrave dhe llogarive të saktë dhe të rregullt, duke specifikuar qartë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për Programin dhe që identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga ky Grant Zviceran;

e) u mundësojnë përfaqësuesve të KfW-së që të inspektojnë në çdo kohë librat dhe regjistrat e lartpërmendur, si dhe çdo dokumentacion tjetër që lidhet me zbatimin e Programit;



f) lejojnë përfaqësuesit e KfW dhe/ose SECO të vizitojnë Projektet dhe të gjitha instalimet që lidhen me të;

g) i japin KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe të dhënat për Programin dhe progresin e tij të mëtejshëm, sipas kërkesës së KfW-së;

j) në rast të krijimit të një komiteti drejtues ose një organi të ngjashëm, në lidhje me Programin, informojnë KfW-në dhe SECO për një krijim të tillë dhe sigurojnë që KfW-ja dhe SECO do të kenë të drejtë të emërojnë së paku një anëtar në një organ të tillë;

k) lejojnë vlerësime të mëtejshme të Programit dhe rezultateve të Programit nga përfaqësuesit e KfW-së dhe SECO, agjentë të jashtëm ose një auditor (i jashtëm) i porositur nga KfW-ja dhe/ose SECO; dhe

l) sigurojnë vizibilitetin e Kontributit Zviceran për Projektin, p.sh., që i gjithë materiali për marrëdhëniet me publikun dhe të gjitha dokumentet e prodhuara në bazë të Programit përfshijnë një referencë për faktin se Programi bashkëfinancohet nga Qeveria Zvicerane dhe logoja e Qeverisë Zvicerane shfaqet, veçanërisht në tabelat e vendosura në kantieret e ndërtimit.

7.2 Detajet e lidhura me nenin 7.1 do të përcaktohen nga Marrëveshja e Veçantë.

7.3 Përfituesi, nëpërmjet MIE/NJKP-së do të marrë masa dhe do të kërkojë që AZP-të do të:

a) sigurojnë financim të plotë të Programit dhe kur e kërkon KfW-ja do t'i japë KfW-së dëshmi që provojnë se kostot e papaguara nga ky Grant Zviceran, janë mbuluar;

b) me pëlqimin e tyre, do të informojnë menjëherë KfW-në për çdo dhe të gjitha rrethanat që përjashtojnë ose rrezikojnë rëndë zbatimin, operimin, menaxhimin ose qëllimin e Programit;

7.4 Përfituesi nëpërmjet MIE/NJKP asiston Agjencitë e Zbatimit të Projektit, në përputhje me praktikën e qëndrueshme inxhinierike dhe financiare në zbatimin e Projekteve dhe në përmbushjen e detyrimeve të Agjencive të Zbatimit të Projektit, sipas kësaj Marrëveshjeje dhe në veçanti, u jep Agjencive të Zbatimit të Projektit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e Projekteve.

7.5 Për transportin e mallrave, që do të financohen nga Kontributi Financiar, do të zbatohen dispozitat e Marrëveshjes Qeveritare, të cilat i janë njohur Përfituesit.

Neni 8

Publikimi dhe transferimi i informacionit të lidhur me projektin

8.1 Për të përmbushur parimet e pranuar ndërkombëtarisht për arritjen e transparencës dhe të efikasitetit maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë rezultatet e vlerësimit dhe kategorizimit mjedisor dhe social, si dhe raportet e vlerësimit *ex post* (pas projektit) për Programin dhe financimin e tij gjatë negociatave parakontraktuale, paralelisht me zbatimin e marrëveshjes/ve të lidhur/a me Programin dhe në fazën paskontraktuale (në vijim e referuar si “Periudha e Plotë”).

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të KfW-së për fushën e tij të biznesit “Banka e Zhvillimit KfW” (<http://transparenz.KfW-entwicklungsbank.de/>).

Publikimi i informacionit (qoftë nga KfW-ja apo palët e treta në përputhje me nenin 8.3 më poshtë) për Programin dhe mënyrën e tij të financimit nuk përfshin asnjë dokumentacion kontraktual ose informacion të hollësishëm sensitiv financiar apo të lidhur me biznesin rreth palëve të përfshira në Program ose në financimin e tij, të tillë si:

a) informacion për të dhënat e brendshme financiare;

b) strategjitë e biznesit;

c) udhëzime dhe raporte të brendshme të korporatës;

d) të dhëna personale për personat fizikë;

e) vlerësimi i brendshëm i KfW-së për gjendjen financiare të palëve.

8.2 KfW-ja e ndan informacionin e përzgjedhur për Programin dhe mënyrën e tij të financimit gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e përmendura më poshtë, veçanërisht për të siguruar transparencë dhe efikasitet:

a) filialet e KfW-së;

b) Republikën Federale të Gjermanisë dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë ose subjektet e saj kompetente;

c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin gjerman dypalësh për zhvillim, veçanërisht *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH*;



d) organizata ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarët e tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe anëtarët e saj;

e) Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike SECO, e cila nga ana e tij mund të publikojë këtë informacion të ndarë;

f) Bashkimin Evropian dhe institucionet e tij.

8.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur për Programin dhe financimin e tij gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e mëposhtme, të cilat botojnë seksionet që kanë lidhje me qëllimin:

a) Republika Federale e Gjermanisë, për qëllimet e Nismës së Transparencës së Ndihmës Ndërkombëtare

http://www.bmz.de/de/was_wir_machen/wege/transparenz-fuer-mehr-Wirksamkeit/index.html);

b) Tregu dhe Investimi Gjerman (GTAI), për qëllimet e informacionit për tregun (<http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/trade.FOO>);

c) OECD-ja, për qëllimet e raportimit të flukseve financiare, në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim (<http://stats.oecd.org/>);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEVal), për qëllimet e vlerësimit të përgjithshëm të bashkëpunimit gjerman për zhvillim, për të garantuar transparencë dhe efikasitet (<http://www.deval.org/de/>);

e) Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike SECO (<http://www.simap.ch>);

g) Bashkimi Evropian dhe institucionet e tij.

8.4 KfW-ja rezervon më tej të drejtën për transferimin (duke përfshirë qëllimet e publikimit) e informacionit për Programin dhe financimin e tij gjatë Periudhës së Plotë të palët e tjera të treta për të mbrojtur interesat e ligjshëm.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja tek palët e tjera të treta, nëse interesat e ligjshëm të Përfituesit në informacionin që nuk transferohet i tejkalon interesat e KfW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshëm të Përfituesit përfshijnë veçanërisht konfidencialitetin e informacionit sensitiv të përmendur në nenin 8.1, i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtën t'iu transferojë informacion palëve të treta, nëse kjo është e

nevojshme, për shkak të kërkesave statutores ose rregullatore ose për të ruajtur ose mbrojtur pretendimet ose të drejtat e tjera ligjore në proceset gjyqësore ose administrative.

Neni 9

Përfundimi i Marrëveshjes së Grantit SECO

Nëse Marrëveshja e Delegimit është përfunduar ose pushon të ketë ndonjë efekt detyrues për ndonjë arsye tjetër, KfW mund të përfundojë këtë Marrëveshje të Grantit SECO me efekt të menjëhershëm, duke sjellë kështu pasojat e mëposhtme:

a) detyrimet e KfW-së, sipas kësaj Marrëveshjeje të Grantit SECO, do të anulohen tërësisht;

b) pa cenuar të drejtat e KfW-së, sipas nenit 3.2, KfW-ja do të ketë të drejtë të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të shumave të disbursuara të Grantit Zviceran, në atë masë, që shumat të tilla nuk janë kryer akoma ose shpenzuar nga Përfituesi në një mënyrë të detyrueshme ligjore, në përputhje me këtë Marrëveshje të Grantit SECO.

Neni 10

Dispozita të ndryshme

10.1 Përfituesi ndërmerr të përbushë në çdo kohë detyrimet e parashtruara në shtojcën 1a (Zotimet e përputhshmërisë së Përfituesit) dhe të sigurojë nëpërmjet MIE/NJKP-së, që agjencitë e zbatimit të Projektit ndërmarrin të përbushin në çdo kohë detyrimet e parashtruara në shtojcën 1b (Zotimet e përputhshmërisë së agjencisë së zbatimit të Projektit).

10.2 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje të Grantit SECO është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara në lidhje me të. Çdo boshllëk ligjor që mund të rrjedhë prej saj plotësohet me një dispozitë, në pajtim me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje të Grantit SECO.

10.3 Përfituesi nuk mund të caktojë ose transferojë, pengojë ose hipotekojë ndonjë pretendim nga kjo Marrëveshje e Grantit SECO.

10.4 Kjo Marrëveshje e Grantit SECO rregullohet nga legjislacioni i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i përbushjes është Frankfurt am Main.

10.5 Marrëdhëniet juridike të vendosura nga



kjo Marrëveshje e Grantit SECO midis KfW-së dhe Përfituesit do të përfundojnë me përfundimin e kohëzgjatjes së dobishme të Projektit, por jo më vonë se 15 vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje të Grantit SECO.

10.6 Kjo Marrëveshje e Grantit SECO do të hyjë në fuqi kur KfW-ja të ketë marrë njoftimin me shkrim të Përfituesit se procedurat e brendshme ligjore që do të përmbushen nga Përfituesi janë përmbushur (data e marrjes pranë KfW-së).

Hartuar në 2 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main
Sot, më 18.12. 2020
KfW

Emri: Arne Goos
Pozicioni: Përgjegjës
Sektori

Emri: JOCHEN BEIK
Pozicioni: Menaxher
Portofoli Senior

Shtojca

1a – Zotimet e Përputhshmërisë të Përfituesit

1b – Zotimet e Përputhshmërisë të Agjencisë së Zbatimit të Projektit

SHTOJCA 1a

ZOTIMET E PËRPUTHSHMËRISË TË PËRFTUESIT

1. Përkufizime

“Praktikë shtrënguese” dëmtimi apo lëndimi ose kërcërimi për të dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një person apo pronë të ndonjë personi për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme mbi veprimet e një personi.

“Praktikë e fshehtë” është një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër.

“Praktikë korruptive”, premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, insistimi për të dhënë, marrja, pranimi ose kërkimi, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, i ndonjë pagese të jashtëligjshme ose

avantazhi të papërshtatshëm të çfarëdolloj natyre, për apo nga çdo person, me qëllim ndikimin në veprimet e një personi apo pengimin e atij personi për të vepruar.

“Praktikë mashtruese” nënkupton çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqpërfaqësim që çorienton ose synon të çorientojë, qoftë me ose pa dashje, një person me qëllim marrjen e një përfitimi financiar ose shmangien e një detyrimi.

“Praktikë penguese”: i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e qëllimshme e provave materiale hetimore ose dhënia e dëshmive të rreme për hetuesit, për të penguar materialisht një hetim zyrtar mbi dyshimet e një praktike korruptive, praktike mashtruese, praktike shtrënguese, praktike të fshehtë ose kërcërimi, ngacmimi apo frikësimi të një personi për të mos e lejuar atë që të tregojë gjithçka, për çështje që lidhen me hetimin ose nga kryerja e hetimit; ose ii. çdo akt që synon të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar kontraktualisht, lidhur me një hetim zyrtar mbi dyshimet e një praktike korruptive, praktike mashtruese, praktike shtrënguese ose praktike të fshehtë.

“Person”, një person fizik, person juridik, partneritet apo shoqatë e pathemeluar në formën e korporatës.

“Praktikë e sanksionueshme” çdo praktikë shtrënguese, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktike mashtruese, ose praktike penguese (sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje), që: i. është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman ose ligjeve të tjera të zbatueshme; dhe që ii. ka ose mund të ketë efekt material ligjor ose reputacional mbi këtë Marrëveshje ndërmjet Përfituesit dhe KfW-së apo zbatimit të saj.

“Sanksione”, sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, miratuara apo zbatuara nga organi sanksionues.

“Organ sanksionues”, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian ose Republika Federale e Gjermanisë.

“Listë e sanksioneve”, çdo listë e personave, grupeve apo subjekteve të përcaktuara në mënyrë specifike që u nënshtrohen sanksioneve, e lëshuar nga ndonjë organ sanksionues.



2. Sipërmarrja lidhur me informacionin

Përfituesi, nëpërmjet MIE/NJKP-së:

a) i vë në dispozicion KfW-së menjëherë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që lidhet me “njohjen e klientit” apo informacione të ngjashme për Përfituesin që KfW-ja mund të kërkojë;

b) i ofron KfW-së menjëherë, sipas kërkesës, të gjithë informacionin dhe dokumentet e lidhura me Projektin, të Përfituesit dhe palëve të tij (nën)kontraktuese dhe palëve të tjera përkatëse, tek të cilat KfW-ja bazohet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e praktikave të sanksionueshme, pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me Përfituesin që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) informon KfW-në menjëherë dhe me pëlqimin e tij, sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi të lidhur me Projektin;

d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi Projektin dhe ecurinë e tyre të mëtejshme, siç KfW-ja mund të kërkojë, për qëllimet e kësaj shtojce; dhe

e) u mundëson KfW-së dhe agjentëve të saj, në çdo kohë, inspektimin e të gjithë dokumentacionit tjetër të Përfituesit dhe palëve të tij (nën)kontraktuese apo palëve të tjera të lidhura me të mbi Projektin dhe kryerjen e vizitave në Projekt dhe në të gjitha instalimet përkatëse, për qëllimet e kësaj shtojce.

3. Përfaqësimi dhe garancia

3.1 Për sa i përket legjislacionit gjerman apo legjislacionit të vendit të Përfituesit, ky i fundit shprehet se asnjë prej personave që vepron në emër të Përfituesit për Projektin, nuk ka kryer ose nuk është angazhuar në praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi.

3.2 Përfaqësimi dhe garancia e përcaktuar në këtë nen jepen për herë të parë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ato do të konsiderohen të përsëritura me çdo tërheqje të Grantit, duke iu referuar rrethanave mbizotëruese në atë datë.

4. Sipërmarrjet pozitive

Përfituesi ndërmerr të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj sapo Përfituesi apo KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë

praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash apo financim terrorizmi, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Në veçanti, Përfituesi i përgjigjet menjëherë dhe në detaje të arsyeshme çdo njoftimi të KfW-së dhe ofron mbështetje dokumentuese për këtë përgjigje, me kërkesë të KfW-së.

5. Sipërmarrjet negative

Përfituesi nuk lidh transaksione apo nuk angazhohet në veprimtari të tjera lidhur me Projektin që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

SHTOJCA 1b

ZOTIMET E PËRPUTHSHMËRISË TË AGJENCISË SË ZBATIMIT TË PROJEKTTIT

1. Përkufizimet

“Praktikë shtrënguese”, dëmtimi apo lëndimi ose kërcënim për të dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ndonjë person apo pronë të personit për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme në veprimet e një personi.

“Praktikë e fshehtë”, një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër.

“Praktikë korruptive”, premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, insistimi për të dhënë, marrja, pranimi ose kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çfarëdolloj natyre, për apo nga ndonjë person, me qëllim ndikimin në veprimet e një personi apo pengimin e ndonjë personi për të vepruar.

“Kategoritë e përcaktuara të veprave penale”, kategoritë e mëposhtme të veprave penale, të përcaktuara sipas rekomandimeve të FATF-së dhe shënimit përkatës interpretues: pjesëmarrja në një grup kriminal të organizuar dhe shantazhim; terrorizmi, duke përfshirë financimin e terrorizmit; trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabandimi i emigrantëve; shfrytëzimi seksual, duke përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve; trafikimi i paligjshëm i lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope; trafikimi i paligjshëm i armëve; trafikimi i paligjshëm i mallrave të vjedhur dhe mallrave të tjerë; korrupsioni dhe mitmarrja/mitdhënia; mashtrimi; falsifikimi i monedhës; falsifikimi dhe



pirateria e produkteve; krimi mjedisor; vrasja, lëndimi i rëndë trupor; rrëmbimi; mbajtja e paligjshme me forcë dhe pengmarrja; grabitja ose vjedhja; kontrabandimi (duke përfshirë edhe në lidhje me taksat dhe tarifatat doganore dhe akcizat); krimet tatimore (të lidhura me taksat direkte dhe të tërthorta); zhvatja; falsifikimi, pirateria; manipulimi i tregut dhe tregtimi i brendshëm.

“Rekomandimet e FATF-së”, rekomandime të tilla që përcaktohen herë pas here nga Task-Forca e Veprimit Financiar (FATF). FATF-ja është organi ndërqeveritar, qëllimi i të cilës është hartimi dhe nxitja e politikave kombëtare dhe ndërkombëtare për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

“Praktikë mashtruese” nënkupton çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqinterpretim që me qëllim ose nga pakujdesia çorienton ose synon të çorientojë një palë në kuadrin e përfuturit të një përfitimi financiar ose shmangies së një detyrimi.

“Origjinë e paligjshme” origjina e fondeve të përfutur me anë të:

- a) ndonjë vepër penale të listuar në Kategoritë e Caktuara të Veprave Penale;
- b) ndonjë Praktike Korruptive;
- c) ndonjë Praktike Mashtruese; ose
- d) pastrimit të parave.

“Praktikë penguese”: i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e qëllimshme e materialit të provave për hetimin ose dhënia e deklaratave të rreme hetuesve, në mënyrë që të pengohet materialisht një hetim zyrtar për dyshimet për një praktikë korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë, ose kërcërimi, ngacmimi apo frikësimi i ndonjë pale për ta parandaluar atë nga zbulimi i njohurive të saj për çështje që lidhen me hetimin apo ndjekjen e hetimit; ose ii. çdo veprim i synuar për të penguar materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar kontraktualisht, në lidhje me një hetim zyrtar për dyshimet e një praktike korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë.

“Person”, çdo person fizik, person juridik, partneritet ose shoqatë e pathemeluar.

“Praktikë e sanksionueshme” çdo praktikë shtrënguese, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktike mashtruese ose praktike

penguese (sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje); që i. është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman ose legjislacioni tjetër të zbatueshëm; dhe që ii. ka ose mund të ketë efekt material ligjor ose reputacional mbi këtë Marrëveshje ndërmjet agjencisë së zbatimit të projektit dhe KfW-së apo zbatimin e saj.

“Sanksionet”, sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, miratuara apo zbatuara nga ndonjë organ sanksionues.

“Organ sanksionues”, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

“Lista e sanksioneve”, çdo listë e personave, grupeve apo subjekteve të përcaktuara në mënyrë specifike, që u nënshtrohen sanksioneve, e lëshuar nga ndonjë organ sanksionues.

Sipërmarrja në lidhje me informacionin Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) i vë në dispozicion KfW-së menjëherë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që lidhet me “njohjen e klientit” apo informacione të ngjashme për Përfutuesin dhe apo ndonjë filial tjetër (nëse ka ndonjë), që KfW-ja mund të kërkojë;

b) i ofron KfW-së menjëherë, sipas kërkesës, të gjithë informacionin dhe dokumentet e lidhura me Projektin, të Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe palëve të saj (nën)kontraktuese dhe palëve të tjera përkatëse, tek të cilat KfW-ja bazohet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e praktikave të sanksionueshme, pastrimit të parave ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me Agjencinë e Zbatimit të Projektit që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) informon KfW-në menjëherë dhe me pëlqimin e saj, sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi nga Agjencia e Zbatimit të Projektit, anëtarët e organeve të saj të menaxhimit, organeve të tjera qeverisëse apo aksionarëve të saj;

d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet për Projektin dhe ecurinë e tij të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së, për qëllimet e kësaj shtojce;



e) u mundëson KfW-së dhe agentëve të saj inspektimin në çdo kohë të të gjithë dokumentacionit tjetër të lidhur me Projektin, të Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe palëve të saj (nën)kontraktuese apo palëve të tjera të lidhura me të dhe kryerjen e vizitave në Projekt dhe në të gjitha instalimet përkatëse, për qëllimet e kësaj shtojce;

f) informon KfW-në menjëherë dhe me pëlqimin e saj për çdo rast që mund të sjellë klasifikimin ekzistues ose të mundshëm të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, anëtarëve të organeve të saj të menaxhimit ose organeve të tjera qeverisëse apo aksionarëve të saj, si shtetas me emërtim të veçantë ose personave apo subjekteve të bllokuar, të renditur në ndonjë lloj liste sanksionesh.

3. Përfaqësimet dhe garancitë

3.1 Për sa i përket legjislacionit gjerman ose vendit të themelimit të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, kjo e fundit përfaqëson dhe garanton se janë të vërteta dhe të sakta sa më poshtë:

a) në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Agjencia e Zbatimit të Projektit vepron në emrin e saj dhe për llogari vet;

b) në dijeni të saj dhe vetëm në lidhje me aksionarët që njihen nga Agjencia e Zbatimit të Projektit, sipas rregulloreve të zbatueshme të bursës, as kapitali i Agjencisë së Zbatimit të Projektit, as fondet e investuara në Projekt nuk kanë Burim të Paligjshëm;

c) Agjencia e Zbatimit të Projektit, bashkëpunëtorët, filialet apo asnjë person tjetër që vepron në emër të saj nuk ka kryer apo nuk është angazhuar në praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi;

d) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk: i. ka lidhur ndonjë marrëdhënie biznesi me shtetas me emërtim të veçantë apo persona dhe subjekte të bllokuar të renditur në ndonjë lloj liste sanksionesh; ose nuk ii. është angazhuar në veprimtari të tjera që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

3.2. Përfaqësimet dhe garancitë e përcaktuara në këtë nen jepen për herë të parë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ato konsiderohen të përsëritura me çdo tërheqje Granti, duke iu referuar rrethanave mbizëtoruese në atë datë.

4. Sipërmarrjet pozitive

Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr të:

a) përmbushë plotësisht standardet kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në përputhje me rekomandimet e FATF-së dhe të zbatojë, respektojë dhe përmirësojë, nëse është e nevojshme, standardet dhe udhëzimet e brendshme (duke përfshirë pa kufizim, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve ndaj klientit), të nevojshme për shmangien e praktikave të sanksionueshme, akteve të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit; dhe

b) sapo Agjencia e Zbatimit të Projektit ose KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash apo financim terrorizmi, bashkëpunon plotësisht me KfW-në dhe agentët e saj, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Agjencia e Zbatimit të Projektit i përgjigjet menjëherë dhe me detaje të arsyeshme çdo njoftimi të KfW-së dhe ofron mbështetje dokumentuese për këtë përgjigje, me kërkesë të KfW-së.

5. Sipërmarrjet negative

Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr, të:

a) sigurojë se kapitali apo fondet e tjera që investon nuk kanë Burim të Paligjshëm;

b) sigurojë se biznesi i saj nuk shkakton praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi; dhe

c) mos lidhë apo të mos vijojë asnjë marrëdhënie biznesi me shtetas me emërtim të veçantë, persona ose subjekte të bllokuar, të renditur në ndonjë listë sanksionesh ose të mos angazhohet në veprimtari të tjera që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

UDHËZIM

Nr. 1, datë 19.1.2021

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 30, DATË 12.9.2018, “PËR NUMRIN E NXËNËSVE PËR KLASË DHE NORMAT E PUNËS MËSIMORE NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës “d”, të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën së Shqipërisë”, të ndryshuar,



UDHËZOJ:

I. Në udhëzimin nr. 30, datë 12.9.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Në kreun IV bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Pas pikës 2, të shkronjës “C”, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1 Mësuesi i specialitetit: 22 orë në javë.”.

b) Pika 3, e shkronjës “C”, ndryshon si më poshtë:

“3. Mësues i lëndëve të tjera: 22 orë në javë.”.

c) Pika 8, e shkronjës “E”, shfuqizohet.

d) Pas shkronjës “E” shtohet shkronja “F”, me këtë përmbajtje:

“F. Organizimi i mësimin në shkollat sportive:

1. Orët teorike në lëndët: “Formim teorik profesional” (FTP) të specialiteteve “Futboll” dhe “Atletikë” zhvillohen me të gjithë klasën.

2. Orët teorike në lëndët: “Formim teorik profesional” (FTP) të specialiteteve “Volejbol” dhe “Basketbol” zhvillohen në grupe, të cilat formohen me jo më pak se 7 nxënës.

3. Orët e lëndës “Formim praktik profesional” (FPP) për specialitetin “Futboll” zhvillohen me të gjithë klasën.

4. Orët e lëndës “Formim praktik profesional” (FPP) zhvillohen me grupe, sipas të specialiteteve “Volejbol” dhe “Basketbol”, sipas klasave.

5. Në specialitetin e “Peshëngritjes” dhe të “Atletikës”, sipas disiplinave, mësimi zhvillohet në grupe me jo më pak se 6 nxënës.

6. Lënda “Sport ndihmës” zhvillohet në grupe të ndara, sipas gjinisë djem dhe vajza, sipas klasave.”.

2. Në kreun V bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) pas pikës 15 shtohet pika 15/1, me këtë përmbajtje:

“15/1 Mësuesit të specialitetit në shkollat sportive, kur stërvit grupet/ekipet sportive të shkollës për pjesëmarrje në takimet sportive (kampionate rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare), sipas kalendarëve sportivë të federatave shqiptare respektive, në përmbushje të veprimtarive sportive të parashikuara në kurrikulën sportive, i llogariten si ngarkesë mësimore 3 orë në javë.”.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, si dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi

URDHËR
Nr. 24, datë 14.1.2021

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETET E POLONISË, SLOVAKISË,
HUNGARISË, GJERMANISË,
UKRAINËS, IZRAELIT, ÇEKISË,
RUMANISË, BULLGARISË, BELGJIKËS,
KROACISË, DANIMARKËS, FRANCËS,
HOLANDËS DHE LITUANISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; në informacionin e marrë nga faqja zyrtare e Organizatës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Shëndetit të Kafshëve (OIE), si dhe bazuar në zbatimin e rregullores nr. 2020/352, datë 3.3.2020, në kapitullin 10.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës dhe Ujit të OIE-së,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit, për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër;
- b) zogjve 24 orësh;
- c) shpendëve dekorativ;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve;
- e) nënprodukteve të shpendëve.

Nga shtetet e mëposhtme:

Nga shteti i Polonisë: përkatësisht provinca



Wielkopolskie, rajoni Ostrowski, nënrajonit Przygodzice; përkatësisht provinca Zachodnio-Pomorskie, rajoni Mysliborsk, nënrajonit Mysliborz; përkatësisht provinca Wielkopolskie, rajoni Kolski, nënrajonit Dabie; përkatësisht provinca Wielkopolskie, rajoni Ostrowski, nënrajonit Ostrow; përkatësisht provinca Dolnoslaskie, rajoni Legnicki, nënrajonit Chojnow; përkatësisht provinca Wielkopolskie, rajoni szamotulski, nënrajonit Ostrorog; përkatësisht provinca Wielkopolskie, rajoni Ostrowski, nënrajonit Raszkow; përkatësisht provinca Wielkopolskie, rajoni Wolsztynski, nënrajonit Wolsztyn; përkatësisht provinca Slaskie, rajoni Raciborski, nënrajonit Kuznia Raciborska; përkatësisht provinca Warminsko-Mazurskie, rajoni Llawski, nënrajonit Zalewo; përkatësisht provinca Warminsko-Mazurskie, rajoni Ostrodzki, nënrajonit Grunwald; përkatësisht provinca Opolskie, rajoni Kedzierzynsko-Kozielski, nënrajonit Kedzierzyn-Kozle; përkatësisht provinca Lodzkie, rajoni sieradzki, nënrajonit Blaszk; përkatësisht provinca Slaskie, rajoni Gliwicki, nënrajonit Wielowies; përkatësisht provinca Lodzkie, rajoni Lodzki Wschodni, nënrajonit Koluszki; përkatësisht provinca Lodzkie, rajoni Lowicki, nënrajonit Domaniewice; përkatësisht provinca Lodzkie, rajoni Poddebicki, nënrajonit Wartkowice; përkatësisht provinca Lodzkie, rajoni Zgierski, nënrajonit Aleksandrow Lodzki; përkatësisht provinca Wielkopolskie, rajoni Koninski, nënrajonit Grodziec; përkatësisht provinca Slaskie, rajoni Gliwicki, nënrajonit Wielowies; përkatësisht provinca Dolnoslaskie, rajoni Wroclawski, nënrajonit Dlugoleka; përkatësisht provinca Lubuskie, rajoni Sulecinski, nënrajonit Krzeszyce; përkatësisht provinca Lubelskie, rajoni Lubartowski, nënrajonit Uscimow; përkatësisht provinca Lubelskie, rajoni Krasnostawski, nënrajonit Izbica dhe Zolkiewka; përkatësisht provinca Wielkopolskie, rajoni Wolsztynski, rrethi Wolsztyn dhe Siedlec, rajoni Grodziski, rrethi Rakoniewice dhe Wielichowo, rajoni Szamotulski, rrethi Pniewy, rajoni Klodzki, rrethi Klodzko; përkatësisht provinca Mazowieckie, rajoni Siedlecki, rrethi Suchozdebry, rajoni Gostyninski, rrethi Gostynin; përkatësisht provinca Warminsko-Mazurskie, rajoni Nowomiejski, rrethi Grodziczno, rajoni Piski, rrethi Pisz; përkatësisht provinca Lubelskie, rajoni Leczynski, rrethi Ludwin, rajoni Radzynski, rrethi Wohyn;

përkatësisht provinca Pomorskie, rajoni Slupski, rrethi Kobylnica; përkatësisht provinca Zachodnio-Pomorskie, rajoni Koszalinski, rrethi Mielno.

Nga shteti i Sllovakisë: përkatësisht provinca Nitra, rrethi Nitra; fshati Zbehy, provinca Trnava, rrethi Trnava, fshati Cifer; provinca Trencin, rrethi Prievidza, Qyteti Bojnice; provinca Zilina, rrethi Cadca, fshati Stará Bystrica.

Nga shteti i Hungarisë: përkatësisht nga rajoni Bacs-Kiskun, fshati Csólyospálos, Szank, Kiskunfélegyháza, Kiskunmajsa, Kömpöc, Jászszenlászóló, Nyárlőrinc, Mélykút, Bócsa, Soltvadkert, Bugac, Császártöltés, Kunfehértó, Orgovány, Kelebia, Jánoshalma, Kiskunhalas, Harkakötöny, Kiskunfélegyháza, Tázlár, Rem, Szank, Kisszállás, Petofiszállás; përkatësisht rajoni Komárom-Esztergom, fshati Ács, përkatësisht rajoni Csongrad, fshati Ruzsa, Forráskút, Zsombó, Pusztaszer, Csengele; përkatësisht rajoni Hajdu-Bihar, fshati Letavertes, rajoni Bekes, fshati Battonya, Nagykamarás, Kondoros, Kisdombegyház, Battonya.

Nga shteti i Gjermanisë: përkatësisht provinca Baden-Württemberg, rrethi Hohenlohekreis, fshati Bretzfeld; provinca Niedersachsen, rrethi Aurich, fshati Dornum; provinca Sachsen-Anhalt, rrethi Börde, fshati Bülstringen; provinca Baden-Württemberg, rrethi Hohenlohekreis, Bashkia Bretzfeld; provinca Niedersachsen, rrethi Aurich, Bashkia Dornum; provinca Sachsen-Anhalt, rrethi Börde, Bashkia Bülstringen, provinca Schleswig-Holstein, rrethi Nordfriesland, Bashkia Langeneß, Emmelsbüll-Horsbüll, Pellworm, rrethi Segeberg, Bashkia Heidmühlen, rrethi Dithmarschen, Bashkia Neufelderkoog dhe Gudendorf; provinca Mecklenburg-Vorpommern, rrethi Vorpommern-Rügen, Bashkia Zingst; provinca Mecklenburg-Vorpommern, rrethi Vorpommern-Rügen, Bashkia Rambin, rrethi Rostock, Bashkia Neubukow, rrethi Mecklenburgische Seenplatte, Bashkia Lärz, rrethi Nordwestmecklenburg, Bashkia Gadebusch, rrethi Vorpommern-Greifswald, Bashkia Wusterhusen; provinca Niedersachsen, rrethi Aurich, Bashkia Großheide, rrethi Cloppenburg, Bashkia Cloppenburg, Garrel, Bösel, rrethi Oldenburg, Bashkia Prinzhöfte; provinca Sachsen, rrethi Leipzig, Bashkia Grimma;



provinca Brandenburg, rrethi Spree–Neiße, Bashkia Schenkendöbern.

Nga shteti i Ukrainës: përkatësisht nga rajoni Vinnitssa, fshati Berezivka, Bratslav, Budky, Bugakiv, Chervone, Chukiv, Danylky, Dovzhok, Horodnytsia, Hrabovets, Hranitne, Karolina, Korovayna, Korzhiv, Korzhivka, Kryklivtsi, Maryanivka, Melnykivtsi, Monastyrrok, Monastyrsk, Qyteti Nemyriv, fshati Novi Obyhody, Ostapkiivtsi, Ozero, Perepelychcha, Rachky, Salyntsi, Samchyntsi, Sazhky, Selevintsi, Sholudky, Slobidka, Sorokoduby, Sorokotiazhyntsi, Velyka Bushynka, Vovchok, Vyhnanka, Yosypenky, Zarudyntsi dhe Zelenianka; përkatësisht nga Qyteti Nikolayev, rrethi Nova Odesa, fshati Kandybyne dhe Novomatviivske, rrethi Ochakiv, fshati Yaselka, rrethi Mykolaiv, fshati Trykhaty, rrethi Arbutynka, fshati Ivanivka; përkatësisht nga Qyteti Kiev, rrethi Ivankiv, fshati Leonivka, rrethi Borodianka, fshati Borodianka; përkatësisht nga Qyteti Kherson, rrethi Kakhovka, fshati Zaozerne.

Nga shteti i Izraelit: përkatësisht provinca Hazafon, rrethi Yizreel, fshati Ma'ale Gilboa.

Nga shteti i Çekisë: përkatësisht provinca Vysocina, rrethi Zdar nad Sazavou, fshati Stepanov nad Svratkou; provinca Pardubický, rrethi Pardubice, fshati Slepotic.

Nga shteti i Rumanisë: përkatësisht rajoni Maramures, provinca Seini.

Nga shteti i Bullgarisë: përkatësisht provinca Plovdiv, Kardzali, fshati Perperek dhe Trilistnik.

Nga shteti i Belgjikës: përkatësisht provinca West–Vlaanderen, Bashkia Menen.

Nga shteti i Kroacisë: përkatësisht Qyteti Koprivnicko–Križevacka, Bashkia Novigrad Podravski, fshati Delovi.

Nga shteti i Danimarkës: përkatësisht rajoni West, Bashkia Randers, fshati Tustrup.

Nga shteti i Francës: përkatësisht në ndarjen Yvelines, komuna Saint Cyr l'Ecole; ndarja Corse–Du–Sud, komuna Ajaccio; ndarja Haute–Corse, komuna Biguglia, Focicchia, Muro, Aregno, Bisinghi; ndarja Landes, komuna Benesse–Maremne, Saint Geours de Maremne, Angresse, Sort en Chalosse, Bergouey, st Maurice des Noues, Pouillon, Horsarrieux, Gaujacq, Myalis, Horsarieux, Saint–Cricq–Chalosse dhe Hinx; ndarja Vendée, komuna St Maurice des Noues;

ndarja Deux–Sèvres, komuna St Sauveur; ndarja Hautes–Pyrénées, komuna Labatut–Rivière.

Nga shteti i Holandës: përkatësisht provinca Gelderland, fshati Altforst, Puiflijk, Terwolde; provinca Groningen, fshati Lutjegast; provinca Friesland, fshati Witmarsum, Sint Annaparochie, Buitenpost; provinca Utrecht, fshati Hekendorp; provinca Zuid–Holland, fshati Maasland; provinca Noord–Brabant, fshati Moergestel.

Nga shteti i Lituaniës: përkatësisht rrethi Kaunas, Qyteti Kunas;

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër, zogjve 24 orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri i ministrit nr. 169, datë 30.4.2020, “Për disa masa ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, Sllovakisë, Hungarisë, Gjermanisë, Ukrainës, Izraelit, Çekisë, Rumanisë dhe Bullgarisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Agjencitë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Milva Ekonomi



URDHËR
Nr. 25, datë 18.1.2021

PËR DELEGIMIN DHE DISA
RREGULLA TË PËRFAQËSIMIT LIGJOR
TË MINISTRISË SË BRENDSHME

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 28, 29 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Brendshme, në proceset gjyqësore kur thirret si palë në një gjykim, lëshohen për aparatin nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Brendshme kur thirret si palë në gjykim, në proceset gjyqësore, në të cilat institucioni i varësisë ka lidhje me objektin e padisë, lëshohen në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë, nga drejtuesi i institucionit qendror ose i varësisë, sipas vendit ku është ngritur kërkesëpadi.

3. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proceset gjyqësore të jetë, sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij urdhri, si pjesë përbërëse e tij.

4. Përfaqësimi për çdo proces gjyqësor bëhet nga juristë dhe specialistë të fushës, sipas objektit të kërkesëpadiës, nëpërmjet autorizimit të lëshuar nga autoritetet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij urdhri.

5. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Brendshme në proceset gjyqësore, sipas këtij urdhri, i jep të drejtë, përfaqësuesit të autorizuar të kryejë çdo veprim procedural, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjykimit, si dhe të drejtën për të hartuar, për të dorëzuar dhe për të nënshkruar kërkesëpadi.

6. Përfaqësuesit e autorizuar të ndjekin me korrektësi seancat gjyqësore, për sa i takon pjesëmarrjes së tyre e, veçanërisht, kontributit provues, paraqitjes së kërkesave, prapësimeve, pretendimeve, ankimeve, rekurseve, si dhe dokumenteve të tjera, që do të ndihmonin

mbrojtjen e përpiktë të interesave të institucionit të Ministrisë së Brendshme.

7. Në përfundim të proceseve gjyqësore, në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda një afati 5-ditor nga shpallja/njoftimi i vendimit, të paraqitet informacion i detajuar, i shoqëruar (aty ky është e mundur) me vendimet përkatëse në Ministrinë e Brendshme.

8. Ngarkohen të gjitha institucionet e varësisë të Ministrisë së Brendshme, qendrore dhe vendore, të caktojnë një person përgjegjës, si pikë kontakti për të shkëmbyer çdo njoftim për ecurinë dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore.

9. Për autorizimet e lëshuara nga Sekretari i Përgjithshëm deri në miratimin e këtij urdhri, të cilat janë përdorur ose përdoren për përfaqësim në proceset gjyqësore, efektet e urdhrit nr. 646, datë 6.12.2018, “Për delegim dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Brendshme”, do të shtrihen edhe pas miratimit të këtij urdhri, deri në përfundimin e procesit gjyqësor.

10. Ngarkohen institucionet e varësisë së Ministrisë së Brendshme, drejtoria që mbulon çështjet gjyqësore për aparatin dhe Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhri.

11. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri institucioneve të varësisë së Ministrisë së Brendshme.

12. Urdhri nr. 646, datë 6.12.2018, “Për delegim dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Brendshme”, si dhe çdo dispozitë e përcaktuar në urdhra të tjerë që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 368 lekë